

20100490909

L I G J PËR BUJQESI DHE ZHVILLIM RURAL

I. DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Permbajtja e ligjit

Neni 1

Me kete ligj rregullohen planifikimi i zhvillimit të bujqesise dhe zhvillimit rural, qellimet e politikës nacionale bujqesore, planifikimi, percjellja dhe vleresimi i politikës nacionale bujqesore, partneriteti me partnere sociale dhe ekonomike nga sfera e bujqesise, masat për rregullimin dhe mbeshtetjen e tregjeve bujqesore, pagesat e drejtperdrejta dhe zhvillimi rural, ndihma shtetere për bujqesi dhe zhvillim rural, format e organizimit dhe bashkimit në bujqesi dhe kontrolli i zbatimit të masave dhe mbikeqyrja e zbatimit.

Kuptimi i nocioneve

Neni 2

Nocione të vecanta të perdorura në kete ligj e kane kuptimin si vijon:

1. **Lloje autoktone të bimeve bujqesore dhe raca autoktone të kafsheve** jane resurset gjenetike bimore dhe shtazore të vendit si pjese e llojlojshmerise biologjike të Republikës së Maqedonisë qofte nese jane sjelle dhe adaptuar historikisht në kushtet në të cilat kultivohen ose nese jane tipa ose lloje lokale të cilat në menyre origjinale u takojne zonave ku jane gjetur dhe të njejtat shfrytezohen në prodhimtarine bujqesore. Resurse gjenetike bimore të bimeve bujqesore jane hardhite, bimet e tagjise, bimet e kopshtarise duke perfshire edhe lulet dhe bimet zburuese, bimet mjekesore dhe aromatike, pemet, drunjte pyjore, kerpudhat, mikro-organizmat dhe flora e eger e cila mund të perdoret ose perdoret për prodhimtari bujqesore. Resurse gjenetike shtazore të kafsheve jane kafshet shtepiake për prodhimtari bujqesore (kurrizore dhe pakurrizore), mikro-organizmat dhe fauna e eger e cila mund të perdoret ose perdoret për prodhimtari bujqesore;

2. **Llojlojshmeri biologjike në bujqesi** eshte llojlojshmeria e cila ekziston ndermjet organizmave të gjalle dhe bimeve dhe brenda llojeve të organizmave të gjalle dhe bimeve të cilat shfrytezohen në prodhimtarine bujqesore ose mund të shfrytezohen në funksion të bujqesise (bime bujqesore, kafshe dhe mikroorganizma) dhe të cilat jane nën mbrojtjen e vecante të shtetit;

3. **Fuqi madhore ose raste të vecanta**, në kuptimin e ketij ligji domethene vdekje e bartesit të ekonomise bujqesore, paaftesim i vazhdueshem profesional i bartesit të ekonomise bujqesore, fatkeqesi natyrore me ndikim serioz në token bujqesore të ekonomise, fatkeqesi me efekt të shkaterrimit të objekteve të kafsheve, episode të cilat ndikojne te një pjese ose te të gjitha kafshet e ekonomise bujqesore;

4. **Politike bujqesore nacionale** eshte sistemi i politikave komplementare për rregullimin dhe mbeshtetjen e tregjeve bujqesore, pagesat e drejtperdrejta për mbeshtetjen e të ardhurave nga ekonomite bujqesore dhe zhvillimi rural me zbatimin e të ciles rregullohet zhvillimi dhe dinamika e prodhimtarise bujqesore dhe mjediset rurale në pajtim me kushtet materiale teknike, ekonomike, ekologjike dhe sociale në Republikën e Maqedonisë dhe në pajtim me kontratat dhe marreveshjet nderkombetare;

5. **Bujqesi** (sektor bujqesor) eshte dega industriale e ekonomise nacionale e cila perfshin prodhimtarine bujqesore dhe perpunimin primar të produkteve bujqesore. Perpunim primar i produktit bujqesor eshte procesi i perpunimit dhe ruajtjes së produkteve primare me prejardhje bimore ose prejardhje shtazore deri në leshimin e tyre në qarkullim në menyre e cila kontribuon në ruajtjen e kualitetit dhe konsistences mekanike dhe kimike;

6. **Prodhimtari bujqesore** (veprimtari bujqesore) eshte veprimtaria ekonomike e cila perfshin kultivimin e bimeve njevjecare, kultivimin e bimeve shumevjecare, kultivimin e bimeve për material faror dhe mbjelles, kultivimin e kafsheve dhe shpezeve shtepiake, veprimtarine e perzier bujqesore, dhe veprimtarite ndihmese të bujqesise dhe aktivitetet pas-vjelese pervec sherbimeve veterinare dhe fitosanitare në pajtim me rregullat për Klasifikimin statistikor të veprimtarive ekonomike të Republikës së Maqedonise;

7. **Perpunim i produktit bujqesor** eshte veprimtaria ekonomike e cila perfshin operacionet industriale për shnderrimin e produktit bujqesor primar i cili si produkt final i dedikohet drejtperdrejt konsumit perfundimtar ose si lende e pare për prodhimin e produkteve ushqimore;

8. **Produkt bujqesor** eshte rezultati fizik i prodhimtarise bujqesore (produkt bujqesor primar). Në produkte bujqesore sipas ketij ligji hyjne produktet nga Aneksi 1 i Marreveshjes për formim të Unionit Evropian pervec peshqve dhe produkteve të peshqve;

9. **Produkt i perpunuar bujqesor** eshte rezultati fizik i operacioneve industriale për perpunimin e produktit bujqesor. Në produkte të perpunuara bujqesore, sipas ketij ligji, hyjne perpunime të qumeshtit dhe krema qumeshti (Shenja tarifore 0403, 0405 20), perime të ngrira (Shenja tarifore 0710), produkte të perpunuara ushqimore të pergatitura me shtojce të sheqerit (Shenja tarifore 1704, 1806, 1905), produkte të llojllojshme për ushqim dhe salca, duke perfshire brumerat, akulloret, supat dhe të tjera (Shenja tarifore 1901, 1902, 1904, 2103, 2104, 2105), pije alkoolike dhe joalkoolike duke perfshire edhe uthullen (Shenja tarifore 22), produkte të duhanit (Shenja tarifore 2402, 2403) dhe perpunime të nishestes (Shenja tarifore 2905, 3501, 3809);

10. **Prodhues bujqesor** eshte bartesi i ekonomise bujqesore ose anetari i ekonomise bujqesore familjare ose personi i cili eshte me punesim të perhershem ose të perkohshem në ekonomine bujqesore dhe i cili merret me veprimtari bujqesore;

11. **Ekonomi bujqesore** eshte njesia ekonomike nën udheheqje të vetme (nga një ose më shume persona pa marre parasysh pronesine, formen juridike, madhesine ose lokacionin) në pronen bujqesore të të cilit (të cilen e posedon dhe/ose ka në dispozicion) kryhet veprimtari bujqesore dhe për të cilen mbahet evidence në Ministrine e Bujqesise, Pyltjarise dhe Ekonomise së Ujerave (në tekstin e metejme: Ministria). Ekonomia bujqesore perfshin një ose më shume njesi prodhuese. Ekonomia bujqesore mund të organizohet juridikisht si shoqeri tregtare ose person tjetër juridik i percaktuar me ligj ose ekonomi bujqesore familjare;

12. **Ekonomi bujqesore familjare** eshte njesia e mevetesishme ekonomike dhe sociale e cila bazohet në kombinimin e udheheqjes dhe pronesise dhe/ose shfrytezimin e prones bujqesore nga anetaret e familjes;

13. **Bartes i ekonomise bujqesore familjare** eshte personi i moshes madhore i cili eshte pergjegjes për udheheqjen e ekonomise bujqesore dhe i cili vepron në emer dhe në llogari të ekonomise bujqesore familjare dhe si i tille eshte regjistruar në Regjistrin unik të ekonomive bujqesore në Ministri. Bartes i ekonomise bujqesore familjare i cili juridikisht eshte i organizuar si shoqeri tregtare ose person tjetër juridik i percaktuar me ligj eshte vet personi juridik, ndersa personi pergjegjes te personi juridik vepron në emer dhe në llogari të asaj ekonomie bujqesore;

14. **Anetar i ekonomise bujqesore familjare** eshte personi fizik i moshes madhore, i cili kryen veprimtari bujqesore në pronen bujqesore, dhe për të cilin mbahet evidence në Ministri;

15. **Bujk i ri** eshte bartesi i ekonomise bujqesore në moshen prej 18 deri 40 vjet;

16. **Prone bujqesore** eshte toka bujqesore, objektet bujqesore dhe objektet për banim ose qendrim të prodhuesve bujqesore, mekanizimi bujqesor, pajisjet bujqesore, kafshet dhe shpezet shtepiake, mbeltime shumevjecare dhe mjetet tjera të prodhimtarise bujqesore, me perjashtim të mbjelljeve njevjecare, rezervave të produkteve bujqesore dhe plehrave, mjeteve për mbrojtjen e bimeve dhe farave;

17. **Toke bujqesore** eshte toka e punueshme bujqesore (fushat, pemishtet, ullishtat dhe mbeltime e harrdhise), livadhet dhe kullosat;

18. **Objekte bujqesore** jane ndertimet që i dedikohen kultivimit të bimeve dhe kafsheve, ruajtjes së mekanizimit bujqesor dhe pajisjeve bujqesore, ruajtjes së të vjelave, ruajtjes së ushqimit të kafsheve, dhe objektet shoqeruese që i dedikohen veprimtarise bujqesore;

19. **Pajisje bujqesore** jane pjeset shoqeruese të mekanizimit bujqesor ose njesite e mevetesishme, të cilat i dedikohen pergatitjes së truallit dhe perpunimit të truallit, kultivimit të mbjelljeve/mbeltimeve në periudhen e vegetacionit, vjeljes, pajisjet për ujitje, pajisjet për ngarkimin dhe transportin e plehrave, pajisjet për ngarkimin dhe transportin e ushqimit të kafsheve dhe pajisjet në objekte për kultivimin e kafsheve dhe shpezeve.

20. **Mekanizim bujqesor** jane automjetet bujqesore të cilat i dedikohen pergatitjes së truallit dhe kultivimit të truallit, vjeljes, mirembajtjes së pajisjeve për ujitje, ngarkimit, manipulimit dhe transportit të fryteve, ngarkimit dhe transportit të plehrave, ngarkimit, manipulimit dhe transportit të ushqimit të kafsheve, mirembajtjes së rrugeve bujqesore, duke perfshire edhe automjetet që i dedikohen ekskluzivisht veprimtarise bujqesore, me perjashtim të objekteve për banim ose qendrim të prodhuesve bujqesore;

21. **Kapacitete prodhuese** jane të gjitha kapacitetet teknike, personale, teknologjike, infrastrukurore, ndertimore në dispozicion dhe të gjitha kapacitetet tjera të cilat jane në funksion të prodhimit;

22. **Subjekt** eshte personi juridik ose fizik, shoqeria, institucioni arsimor dhe/ose shkencor, ndermarrjet publike të cilat shfrytezojne ose zbatojne masa në pajtim me kete ligj;

23. **Subjekt shteteror** eshte ndermarrja publike ose personi juridik themelues i të cilit eshte Qeveria e Republikes së Maqedonise ose eshte pjesemarrrese në investimin baze së paku prej 25% të vleres së investimit baze të kapitalit ose të të drejtave për votim të një shoqerie;

24. **Mikro ndermarrje** eshte shoqeria tregtare e cila ka më pak se dhjete të punesuar dhe ka qarkullim vjetor i cili nuk tejkalon 0,5 milion euro, ose bilanc të pergjithshem të gjendjes i cili nuk tejkalon 0,3 milion euro;

25. **Ndermarrje e vogel** eshte shoqeria tregtare e cila ka më pak se 50 të punesuar dhe ka qarkullim vjetor i cili nuk tejkalon 7 milion euro, ose bilanc të pergjithshem të gjendjes i cili nuk tejkalon 5 milion euro;

26. **Ndermarrje e mesme** eshte shoqeria tregtare e cila ka më pak se 250 të punesuar dhe ka qarkullim vjetor i cili nuk tejkalon 40 milion euro, ose bilanc të pergjithshem të gjendjes i cili nuk tejkalon 27 milion euro, dhe të cilat nuk jane në pronesi prej 25% ose më shume të kapitalit ose të drejtave votuese të një shoqerie, ose të bashkuar nga më shume shoqeri, të cilat jane jashte definicionit për ndermarrje të vogla dhe të mesme;

27. **Ndermarrje e madhe** eshte shoqeria tregtare e cila ka më pak se 250 të punesuar dhe ka qarkullim vjetor i cili nuk tejkalon 40 milion euro, ose bilanc të pergjithshem të gjendjes i cili tejkalon 27 milion euro;

28. **Shoqate nacionale e prodhuesve bujqesore** eshte shoqata e qytetareve në të cilen bejne pjese prodhues bujqesore së paku prej 28 komunave në Republikën e Maqedonise;

29. **Parcelle referente** eshte toka bujqesore me siperfaqe të caktuar e cila paraqet baze për perlllogaritjen e mbeshtetjes financiare në pajtim me kete ligj;

30. **Koke kafshe e kushtezuar** eshte koke kafshe e fituar me perlllogaritje matematikore të kokes së kafshes të shumezuar me koeficient të caktuar;

31. **Interpretim fotografik** eshte metoda e kontrollit të parcelave të tokes me shfrytezimin e fotografive dhe incizimeve satelitore ose ajrore;

32. **Vit i prodhimit** eshte periudha nga njera deri në tjetren rekolte për produkt të caktuar bujqesor;

33. **Sezon prodhues** eshte kohezgjatja e ciklit prodhues të produktit të caktuar bujqesor dhe

34. **Rajon rural** eshte teresia gjeografike e cila perbehet nga mjedisi rural dhe resurset natyrore rreth tij.

Qellimet e politikës bujqësore nacionale

Neni 3

(1) Qellimet e politikës bujqësore nacionale të Republikës së Maqedonisë janë të orientuara në:

- sigurimin e prodhimit të qendrueshme të ushqimit cilesor dhe më të lire dhe sigurimin e popullatës me sasi të mjaftueshme të ushqimit,
- rritjen e aftësisë konkurrense të bujqësisë,
- sigurimin e nivelit të qendrueshëm të të ardhurave të ekonomisë bujqësore,
- zhvillimin e qendrueshëm të zonave rurale dhe
- shfrytëzimin optimal të resurseve natyrore me respektimin e parimeve për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe jetësor.

(2) Qellimet nga paragrafi (1) i këtij neni realizohen nepermjet masave dhe instrumenteve të politikave për:

- 1) rregullim dhe mbështetje të tregjeve bujqësore;
- 2) pagesa të drejtperdrejta dhe
- 3) zhvillim rural.

Organi kompetent

Neni 4

(1) Organ kompetent për planifikimin, percjelljen e zbatimit dhe vleresimit të ndikimit të masave dhe instrumenteve të politikave nga neni 3, paragrafi (2) të këtij ligji është Ministria.

(2) Organ kompetent për zbatimin e masave dhe instrumenteve të politikave nga neni 3, paragrafi (2) të këtij ligji, duke përfshirë edhe kontrollin është Agjencia për Mbeshtetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e metejme: Agjencia) në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për themelimin e Agjencisë për Mbeshtetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Financimi

Neni 5

Financimi i politikës bujqësore nacionale behet nga:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë,
- Buxheti i Unionit Evropian,
- donacionet dhe
- burime tjera në pajtim me ligjin.

II. PLANIFIKIMI, PERCJELLJA DHE VLERESIMI I POLITIKES BUJQESORE NACIONALE

Strategjia nacionale për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Neni 6

(1) Strategjia nacionale për bujqësinë dhe zhvillimin rural (në tekstin e metejme: strategjia nacionale) është dokument themelor strategjik për realizimin e qellimeve nga neni 3, paragrafi (1) i këtij ligji.

(2) Strategjia nacionale vecanerisht përmban analiza të gjendjeve në sferën e bujqësisë, përpunimin e produkteve bujqësore dhe mjediseve rurale, kahtë afatmesme për zhvillim dhe aktivitetet për realizimin e tyre, efektet e pritura dhe mjetet e nevojshme financiare për zbatimin e politikës bujqësore nacionale.

(3) Strategjia nacionale e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e metejme: Qeveria) me propozim të ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (në tekstin e metejme: ministri) për periudhë prej shtatë vitesh.

Programet nacionale

Neni 7

(1) Qeveria miraton Program nacional për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural, për periudhe trevjecare.

(2) Programi nacional nga paragrafi (1) i ketij neni vecanerisht perfshin:

- instrumentet dhe masat dhe aktivitetet për zbatimin e masave,
- orarin kohor dhe afatet e zbatimit dhe
- kornizen financiare indikative për zbatimin e tyre.

(3) Qeveria me propozim të ministrit miraton program vjetor për mbeshtetje financiare në bujqesi dhe program vjetor për mbeshtetje financiare të zhvillimit rural për zbatimin e Programit nacional nga paragrafi (1) i ketij neni.

(4) Objekt i rregullimit të programeve nga paragrafi (3) i ketij neni eshte edhe ndarja e ndihmes shteterore, nese nuk eshte rregulluar ndryshe me dispozitat e neneve 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109 dhe 110 të ketij ligji.

(5) Programi nacional nga paragrafi (1) i ketij neni miratohet më së voni deri më 30 qershor të vitit para fillimit të periudhes për të cilën eshte hartuar.

Aktet për shfrytezimin e ndihmes financiare nga UE-ja

Neni 8

Qeveria me propozim të ministrit miraton program shumevjecar për shfrytezimin e mjeteve financiare nga instrumenti për ndihme paraaderuese për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural nga Unioni Evropian në pajtim me marreveshjet dhe kontratat e lidhura me Unionin Evropian për shfrytezimin e instrumenteve për ndihme paraaderuese financiare dhe dokumentet e planeve të Unionit Evropian.

Analiza

Neni 9

(1) Për planifikimin, percjelljen e zbatimit dhe vleresimin e ndikimit të masave dhe instrumenteve të qellimeve nga neni 3, paragrafi (2) të ketij ligji, Ministria zbaton analiza.

(2) Për nevojat e analizave nga paragrafi (1) i ketij neni, Ministria:

- grumbullon dhe perpunon të dhena vecanerisht për prodhimtarine bujqesore, strukturen e ekonomive bujqesore dhe të dhena tjera nga sfera e bujqesise dhe zhvillimit rural,
- vendos baza të të dhenave dhe mban regjistra,
- vendos sistem informativ tregtar bujqesor dhe
- vendos rrjet të të dhenave të kontabilitetit të ekonomive bujqesore për percjelljen e rezultateve prodhuese ekonomike të ekonomive bujqesore.

(3) Metodologjine për grumbullimin dhe perpunimin e të dhenave nga paragrafi (2), alineja 1, e ketij neni e percakton ministri.

(4) Rrjeti për të dhena të kontabilitetit të ekonomive bujqesore nga paragrafi (2), alineja 4, e ketij neni rregullohet me ligj të vecante.

(5) Për nevojat e analizave nga paragrafi (1) i ketij neni, shfrytezohen edhe të dhena nga Agjencia.

(6) Llojin e të dhenave nga paragrafet (2) dhe (5) të ketij neni, afatin dhe menyren e dorezimit dhe grumbullimit të tyre i percakton ministri.

Regjistrat dhe bazat e të dhenave

Neni 10

(1) Ministria vendos dhe mban të dhena të organizuara në regjistra dhe baza të të dhenave në pajtim me dispozitat e ketij ligji.

(2) Regjistrat dhe bazat e të dhenave të cilat mbahen në Ministri doemos duhet të jene kompatible për shkak të lidhjes dhe kembimit të ndersjelle të të dhenave.

Marrja dhe shfrytezimi i të dhenave

Neni 11

(1) Për mbajtjen dhe mirembajtjen e regjistrave Ministria merr dhe shfrytëzon të dhëna të cilat në kuader të regjistrave dhe evidencave të caktuara i mbajnë organet e administratës shtetërore, institucionet publike, agjencite, koncesioneret, njesite e vetadministrimit lokal dhe institucionet tjera të autorizuar.

(2) Të dhënat, hartat dhe planet ortofotografike digjitale me kërkesë të ministrit, institucionet perkatese nga paragrafi (1) i këtij neni i dorëzojnë në formë të shkruar dhe elektronike nëse ekzistojnë.

(3) Menyren e lidhjes me regjistra dhe evidenca tjera dhe menyren e marrjes së të dhënave nga regjistrat dhe evidencat tjera, i përcakton ministri.

Dorezimi i të dhenave

Neni 12

(1) Të dhënat nga regjistrat në pajtim me këtë ligj janë publike, përveç të dhënave të cilat kanë karakter të të dhënave personale dhe të dhënat të cilat konsiderohen sekret i punës.

(2) Të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohen në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dispozitat për informatat e klasifikuara.

(3) Të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni mund të shfrytëzohen vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë dhe nuk guxojnë të nderohen ose tu dorëzohen personave tjere.

Sistemi informativ tregtar bujqësor

Neni 13

(1) Për udhëheqjen e politikës për rregullimin dhe mbështetjen e tregjeve bujqësore Ministria vendos sistem informativ tregtar bujqësor.

(2) Ministria grumbullon, përpunon dhe publikon të dhëna për sasi dhe cmime të produkteve të caktuara bujqësore në tregje reprezentative.

(3) Ministri i cakton tregjet reprezentative dhe i përcakton llojin, vëllimin, afatet dhe subjektet të cilat i dorëzojnë të dhënat.

(4) Mjetet për udhëheqjen e sistemit tregtar informativ bujqësor sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Shfrytëzuesit e mjeteve

Neni 14

(1) Të drejte për shfrytëzimin e mjeteve në pajtim me këtë ligj kanë ekonomitë bujqësore të regjistruara në regjistrin nga neni 15 i këtij ligji dhe shfrytëzues të tjere në kushte dhe mënyre të caktuara me këtë ligj.

(2) Shfrytëzuesit e mjeteve nga paragrafi (1) i këtij neni duhet t'i kenë shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj Ministrisë dhe Agjencisë.

(3) Kushtet nga paragrafi (2) i këtij neni më afërsisht do t'i përcaktoje Qeveria me propozim të ministrit.

(4) Shfrytëzuesit nga paragrafi (1) i këtij neni doemos duhet ta ruajnë dokumentacionin e plote dhe materialin deshmues për punën, vecanerisht në lidhje me plotësimin e kushteve për shfrytëzimin e mjeteve dhe dokumentacionit për shfrytëzimin e mbështetjes dhe/ose ndihmes financiare, së paku pesë vjet nga viti në të cilin është shfrytëzuar ndihma financiare.

Regjistri unik i ekonomive bujqësore

Neni 15

(1) Ministria mban regjister unik të ekonomive bujqësore (në tekstin e metejme: RUEB).

(2) Në regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni detyrimisht regjistrohen ekonomi bujqesore të cilat:

1) kerkojne realizimin e të drejtes për shfrytëzimin e mjeteve të masave në pajtim me kete ligj dhe

2) jane regjistruar në regjistrat e formuar në pajtim me ligjet nga sfera e bujqesise, veterinarise dhe shendetit dhe mbrojtjes së bimeve.

(3) Baze për mbajtjen e regjistrit nga paragrafi (1) i këtij neni dhe lidhja e tij me regjistra tjere eshte numri unik i identifikimit të ekonomise bujqesore (në tekstin e metejme: NRID).

(4) NRID caktohet gjate regjistrimit të ekonomise bujqesore në regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Perdorimi i NRID obligohet në të gjithë regjistrat, të formuar në pajtim me ligjin, të cilet lidhen me regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Bartesi i ekonomise bujqesore obligohet që çdo ndryshim të të dhenave ta paraqese në Ministri në afat prej 15 ditesh nga ndryshimi i bere.

(7) Vendi i banimit të bartesit dhe anetareve të ekonomise bujqesore familjare eshte i detyrueshem në të njëjten adrese të banimit.

(8) Ministri i percakton formen, permbajtjen, dokumentacionin e nevojshem dhe menyren e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi (1) i këtij neni.

Njoftimi i Qeverise

Neni 16

(1) Ministria e njofton Qeverine për zbatimin e programeve nga neni 7 i këtij ligji me raport vjetor për zbatim.

(2) Raporti vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni vecanerisht permban:

- analize rrjedhese të situatave të pergjithshme zhvillimore në fushen e bujqesise dhe mjediseve rurale,

- raport për arritjen e qellimeve të percaktuara nga strategjia nacionale dhe programi nacional,

- raport për zbatimin e programeve për mbeshtetje financiare, duke perfshire edhe ndihmen shteterore dhe rezultatet e arritura,

- aktivitete të ndermarra nga Ministria dhe Agjencia për avancimin e procedurave për zbatimin e programeve për mbeshtetje financiare dhe ndihme shteterore,

- raport nga kontrole të zbatuara dhe mbikeqyrje inspektuese dhe parregullsi të percaktuara gjate zbatimit të programeve për mbeshtetje financiare dhe ndihme shteterore dhe aktivitete të ndermarra dhe

- pershkrim i aktiviteteve të ndermarra të Ministrise dhe Agjencise për komunikim dhe publicitet të programeve për mbeshtetje financiare.

(3) Raportin vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni Ministria e dorezon më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhes për vitin paraprak.

Raporti bujqesor vjetor

Neni 17

(1) Ministria shpall Raport bujqesor vjetor.

(2) Raporti bujqesor vjetor shpallet një here në vit në ueb faqen e Ministrise, por jo më vone se 30 shtator në vitin rrjedhes për vitin paraprak.

(3) Raporti bujqesor vjetor vecanerisht permban analize të situatave në bujqesi dhe zhvillim rural dhe aktivitete të ndermarra për zbatimin e politikave në vitin paraprak, si dhe politikat rrjedhese për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural nga neni 3, paragrafi (2) të këtij ligji.

III. PARTNERITETI

Partneret sociale dhe ekonomike

Neni 18

(1) Për nevojat e planifikimit, ndjekjes dhe zbatimit të politikës bujqesore nacionale, Ministria vendos partneritet me partnere sociale dhe ekonomike nga fusha e bujqesise.

(2) Partneriteti nga paragrafi (1) i ketij neni realizohet nepermjet:

- Keshillit për bujqesi dhe zhvillim rural,
- grupeve të perhershme të nensektorit,
- Trupit ndermjet resoreve për zhvillim rural dhe
- Komitetit për ndjekjen e programit shumevjecar për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga instrumenti për ndihme paraaderuese për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural nga Unioni Evropian.

(3) Ministria teknikisht e perkrah punen e trupave nga paragrafi (2) i ketij neni dhe i bart harxhimet administrative dhe financiare për punen e tyre.

Keshilli për bujqesi dhe zhvillim rural

Neni 19

Qeveria, me propozim të ministrit, formon Keshillin për bujqesi dhe zhvillim rural (në tekstin e metejme: Keshilli) për shkak të realizimit të kompetencave në vijim:

- kryen pune të mekanizmit konsultativ për politika, plane dhe programe për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural dhe jep mendim në lidhje me rezultatet e arritura nga zbatimi i masave dhe instrumenteve për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural,

- siguron komunikim të vazhdueshem ndermjet Ministrise dhe partnereve sociale dhe ekonomike të cilet jane të perfshire në zbatimin e masave dhe instrumenteve për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural për shkak të arritjes së konsensusit për ceshtje të vecanta nga fusha e bujqesise dhe zhvillimit rural, ndersa vecanerisht nga fusha e rregullimit të tregjeve bujqesore,

- i shqyrton dhe miraton programet vjetore për punen e grupeve të perhershme të nensektoreve dhe programe operative për perkrahje teknike me interes të prodhimeve të vecanta bujqesore ose grup prodhimesh,

- t'i ndjeke analizat e situatave dhe rekomandimet e institucioneve arsimore dhe shkencore, analizat për zbatimin e politikave nga fusha e bujqesise dhe zhvillimit rural dhe

- kryen edhe pune të tjera në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e qellimeve për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimit rural.

Puna e Keshillit

Neni 20

(1) Keshilli miraton Rregullore të punes.

(2) Keshilli mban takime të rregullta së paku një here në vit.

Anetaresimi në Keshill

Neni 21

(1) Keshilli perbehet nga:

- kryetaret e grupeve të perhershme të nensektorit,
- nga një perfaqesues nga tre shoqatat më të medha nacionale të prodhuesve bujqesore sipas numrit të anetareve,
- nga një perfaqesues nga dy shoqatat më të medha të perpunuesve,
- nga një perfaqesues nga odat ekonomike,
- nga një perfaqesues nga institucionet e larta arsimore dhe shkencore nga fusha e bujqesise,
- një perfaqesues nga shoqata e konsumatoreve,

- një perfaqesues nga shoqata e njesive të vetadministrimit lokal dhe
- një perfaqesues nga shoqatat për mbrojtjen e mjedisit jetesor.

(2) Keshillin e udheheq Ministri.

(3) Anetaret e Keshillit nuk guxojne të jene nepunes shteterore dhe mandati i tyre eshte në kohezgjatje prej dy vitesh me të drejte të rizgjedhjes.

(4) Anetaret e Keshillit nga paragrafi (1), alinete 2 dhe 3 të ketij neni në detyrimisht jane perfaqesues nga shoqatat e evidentuara në Ministri në pajtim me nenin 24 të ketij ligji.

Grupet e perhershme të nensektorit

Neni 22

(1) Ministri formon grupe të perhershme të nensektorit për rregullimin e tregjeve bujqesore të prodhimeve të vecanta bujqesore ose grup prodhimesh.

(2) Grupet e perhershme të nensektorit i realizojne detyrat si vijon:

- japin mendime dhe qendrime për ceshtje të cilat dalin nga rregullimi i tregjeve bujqesore,
- kryen pune të mekanizmit konsultativ për krijimin e politikeve, planeve dhe programeve për zhvillimin e tregjeve bujqesore sipas prodhimeve të vecanta bujqesore ose grup prodhimesh,

- e perkrahin procesin e komunikimit të vazhdueshem ndermjet pjesemarresve në tregjet bujqesore të prodhimeve të vecanta bujqesore ose grupe prodhimsh në pikepamje të ofertes, kerkeses dhe cmimeve për prodhime bujqesore,

- promovojne harmonizim për ceshtjet që dalin nga rregullimi i tregjeve bujqesore për prodhime të vecanta bujqesore ose grupe prodhimesh,

- i percaktojne sasite e ofertes dhe kerkeses dhe shtrirjes së cmimeve të grumbullimit të prodhimeve bujqesore për vitin prodhues rrjedhes ose sezonit prodhues, duke i marre parasysh edhe porosite nga institucionet arsimore dhe shkencore, dhe ia dorezon Keshillit më së voni deri në prill të vitit kalendarik rrjedhes,

- propozojne zgjedhje për tejkalimin e situatave të caktuara tregtare në anen e ofertes, kerkeses ose situates së cmimeve dhe

- hartojne program operativ për perkrahje teknike me interes të produkteve të vecanta bujqesore ose grupeve të produkteve, më së voni deri më 30 shtator në vitin rrjedhes për realizim në vitin e ardhshem.

(3) Grupet punuese të nensektorit mendimet dhe qendrimet i deklarojne në forme të konkluzionit.

(4) Grupet e perhershme të nensektorit formohen për produktet bujqesore ose grupe të produkteve si vijojne:

- kultura drithore,
- duhan dhe kultura të tjera industriale,
- qumesht,
- mish (vici, derri, dhensh, dhie dhe shpendesh),
- klllocka dhe veze,
- rrush dhe vere,
- peme,
- perime,
- mjalte dhe
- lule dhe drunj zbukurues.

(5) Grupi i perhersehm i nensektorit për rrush dhe vere gjate percaktimit të sasive të ofertes dhe kerkeses së rrushit të veres, si dhe gjendjen e cmimeve do t'i kene parasysh llojet e preferuara dhe të miratuara të rrushit të veres në pajtim me Ligjin për vere me permbajtje të preferueshme të sheqerit për grupe të llojeve të rrushit dhe atë:

- 22 njesi të sheqerit për grupin e pare,
- 20 njesi të sheqerit për grupin e dyte,

- 18 njesi të sheqerit për grupin e trete dhe

- 16 njesi të sheqerit për grupin e katerte.

(6) Grupet e perhershme të nensektorit formohen edhe për prodhime tjera bujqesore ose grupe prodhimesh.

(7) Puna e grupeve të perhershme të nensektorit zbatohet nepermjet Programit vjetor për pune të grupeve të perhershme të nensektorit i cili hartohet më së voni deri më 30 nentor nga vitit rrjedhes për realizimin në vitin e ardhshem.

(8) Grupet e perhershme të nensektorit miratojne Rregullore të punes.

(9) Ministri e cakton formen dhe permbajtjen e programit vjetor për punen e grupeve të perhershme të nensektorit dhe të programit operativ për perkrahje teknike.

Anetaresimi në grupet e perhershme të nensektorit

Neni 23

(1) Grupi i perhershem i nensektorit perbehet nga anetare me të drejte vote dhe anetaret me rol keshilledhenes pa të drejte vote.

(2) Anetare me të drejte vote jane perfaqesues të emeruar të shoqates nga fusha e:

- prodhimit bujqesor,

- perpunimit të produkteve bujqesore dhe

- tregtise me produkte bujqesore.

(3) Anetare në rol keshilledhenes pa të drejte vote jane nga një perfaqesues i emeruar nga:

- institucionet e larta arsimore nga fusha perkatese e bujqesise,

- institucionet shkencore nga fusha perkatese e bujqesise,

- shoqata e konsumatoreve dhe

- Agjencia për nxitjen e zhvillimit të bujqesise.

(4) Anetaret e grupit të perhershem të nensektorit nga paragrafi (2) i ketij neni detyrimisht jane perfaqesues nga partneret ekonomike të evidentuar në Ministri në pajtim me nenin 24 të ketij ligji, nese së paku 200 anetare nga numri i anetareve nga neni 24, paragrafi (3), pika a), perkatesisht së paku tre anetare nga numri i anetareve nga neni 24, paragrafi (3), pikat b) dhe g) të ketij ligji kryesisht merren me prodhimin e produktit bujqesor perkates ose grupeve të prodhimeve për të cilat eshte formuar grup i perhershem i nensektorit.

(5) Një subjekt mund të emeroje më së shumti kater anetare në një grup të perhershem të nensektorit.

(6) Me grupin e perhershem të nensektorit udheheq kryetari.

(7) Kryetari zgjidhet nga radhet e anetareve të grupit të perhershem të nensektorit me të drejte vote dhe me mandat prej një viti pa të drejte të zgjedhjes së njepasnjeshme. Kryetar i grupit të perhershem të nensektorit nuk mund të zgjidhet person, i cili ka prejardhje nga sfera nga paragrafi (2) i ketij neni nga e cila ka pasur prejardhje kryetari paraprak.

(8) Sekretar i grupit të perhershem të nensektorit eshte anetari i grupit të perhershem të nensektorit me të drejte vote nga Ministria dhe eshte i emeruar nga ministri me aktvendim të vecante. Sekretari i cakton mbledhjet e grupit të perhershem të nensektorit sipas iniciatives personale ose me kerkese të kryetarit dhe kujdeset për zbatimin e konkluzioneve.

(9) Anetare të grupit të perhershem të nensektorit nuk mund të jene nepunesit shteterore, pervec sekretarit dhe perfaqesuesve të Agjencise për nxitjen e zhvillimit të bujqesise.

(10) Anetari i grupit të perhershem të nensektorit i cili eshte zgjedhur kryetar e mban të drejten e votes gjate kohezgjatjes së mandatit. Pas skadimit të mandatit kryetari vazhdon me anetaresimin në grupin e perhershem të nensektorit.

Evidenca e partnereve sociale dhe ekonomike

Neni 24

(1) Për partneret sociale dhe ekonomike me të cilet vendoset dhe realizohet partneritet Ministria mban evidence.

(2) Partnere sociale dhe ekonomike për të cilët mbahet evidence në Ministri janë:

a) partnere sociale - shoqata të qytetareve të cilat janë të themeluara për avancimin e interesit sociale nga fusha e:

- mbrojtjes së mjedisit jetesor, agroekologjise dhe agrobiodiverzitetit,
- mbrojtjes së trashëgimise natyrore, kulturore dhe tradicionale të mjediseve rurale,
- mbrojtjes së interesave dhe rolin e prodhuesve të rinj bujqesor, ose prodhuesve bujqesor gra,
- promovimit të rolit të gruas rurale për zhvillimin e bujqesise dhe mjediseve rurale,
- mbrojtjes së interesave të banoreve të mjediseve rurale për permiresimin e kualitetit të jetes së popullates rurale dhe

- mbrojtjes së interesave të punetoreve në prodhimtarine bujqesore.

b) partnere ekonomike - shoqata të qytetareve të cilat janë të themeluara për avancimin e interesave ekonomike të prodhuesve bujqesore, perpunimin e produkteve bujqesore ose tregtar me produkte bujqesore, kooperativa dhe lidhje kooperativiste nga fusha e prodhimtarise bujqesore dhe grupacione në kornizat e odave ekonomike nga fusha e veprimtarise bujqesore dhe perpunimit të prodhimeve bujqesore.

(3) Partneret ekonomike nga paragrafi (2), pika b) të ketij neni që të evidentohen në Ministri duhet t'i plotesojne kushtet plotesuese si vijon:

a) Për shoqata të prodhuesve bujqesore me numer të anetareve prej së paku 1000 ekonomive bujqesore të evidentuara në RUEB,

b) Për shoqata të perpunuesve ose tregtare me prodhime bujqesore me numer të anetareve së paku prej dhjete personave juridike me veprimtari kryesisht të perpunimit ose tregtise me produkte bujqesore,

v) Për kooperativa dhe lidhje të kooperativave nga fusha e prodhimtarise bujqesore të realizojne të ardhura vjetore nga shitja e prodhimeve bujqesore të anetareve të kooperatives së paku prej 600 000 denaresh në vit dhe

g) Për grupacionet në kornizat e odave ekonomike nga fusha e bujqesise me numer dhjete persona juridike të cilit merren me veprimtari bujqesore, perpunim ose tregti me prodhime bujqesore.

(4) Menyren për regjistrim dhe shlyerje nga evidenca nga paragrafi (1) i ketij neni dhe dokumentacionin e nevojshem e percakton ministri.

(5) Fushat nga paragrafi (2) i ketij neni në menyre të detyrueshme janë të theksuara në aktin themelues së shoqates, statutin si dhe aktet për pune.

Trupi ndermjet resoreve për zhvillim rural

Neni 25

(1) Për qellimet e krijimit të politikës integruese të zhvillimit rural, Qeveria, me propozim të ministrit formon Trup ndermjet resoreve për zhvillim rural.

(2) Me Trupin ndermjet resoreve për zhvillim rural udheheq sekretari shteteror i Ministrise.

(3) Në Trupin ndermjet resoreve për zhvillim rural merr pjese nga një perfaqesues i:

1) Ministrive të:

- Bujqesise, Pylltarise dhe Ekonomise së Ujerave,
- Financave,
- Ekonomise,
- Vetadministrimit Lokal,
- Kultures,
- Punes dhe Politikës Sociale,
- Arsimit dhe Shkences,
- Mjedisit Jetesor dhe Planifikimit Hapesinor dhe
- Transportit dhe Lidhjeve;

2) Sekretariatit për Ceshtje Evropiane dhe

3) Agjencia për:

- Perkrahe Financiare në Bujqesine dhe Zhvillimin Rural dhe
- Nxitjen e Zhvillimit të Bujqesise.

(4) Perfaqesuesit e organeve të administrimit shtetëror dhe agjencive nga paragrafi (3) i këtij neni janë sekretarë shtetëror dhe drejtore.

(5) Në punën e Trupit ndërmjet resoreve për zhvillim rural sipas nevojës mund të perfshihen edhe perfaqesues nga organe të tjera të administrimit shtetëror, agjenci, institucione ose partnerë sociale dhe ekonomike.

(6) Trupi ndërmjet resoreve për zhvillim rural i shqyrton dhe jep mendim për dokumentet strategjike dhe programet nga fusha e financave, ekonomisë, vetadministrimit lokal dhe zhvillimit rajonal, kultures, punës dhe politikës sociale, arsimit dhe shkencës, mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësor, transportit dhe lidhjeve nga aspekti i zhvillimit rural, identifikon çështje dhe probleme nga fusha e zhvillimit rural, propozon zgjidhje, siguron pjesëmarrje të koordinuar dhe ndërmerr aktivitete të tjera të lidhura me procesin e krijimit dhe koordinimit të politikës integruese të zhvillimit rural.

(7) Trupi ndërmjet resoreve për zhvillim rural miraton Rregulloren të punës.

(8) Trupi ndërmjet resoreve për zhvillim rural realizon mbledhje së paku dy here në vit dhe e informon Qeverinë për punën e vet së paku një here në vit më së voni deri më 31 dhjetor.

Komiteti për ndjekjen e programit shumëvjeçar për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga instrumenti për ndihme paraadruese për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural nga Unioni Evropian

Neni 26

(1) Për qëllimet e ndjekjes së efikasitetit dhe kualitetit të zbatimit të programit shumëvjeçar për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga instrumenti për ndihme paraadruese për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural nga Unioni Evropian, Qeveria me propozim të ministrit formon Komitetin për ndjekjen e programit shumëvjeçar për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga instrumenti për ndihme paraadruese për zhvillimin e bujqesise dhe zhvillimin rural.

(2) Dispozitat për përberjen dhe numrin e anëtarëve të Komitetit nga paragrafi (1) i këtij neni, rregullat dhe procedurat për punën e tij janë të percaktuara në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura për shfrytëzimin e mjeteve nga ndihma paraadruese e Unionit Evropian.

IV. POLITIKA PËR RREGULLIMIN DHE PERKRAHJEN E TREGJEVE ME PRODUKTE BUJQESORE

Politika për rregullimin dhe perkrahen e tregjeve me produkte bujqesore

Neni 27

(1) Politika për rregullimin dhe perkrahen e tregjeve me produkte bujqesore zbatohet nepermjet masave si vijon:

- rregullim i kushteve dhe mënyrës së kryerjes së tregtisë me produkte bujqesore me qëllim të ruajtjes së kushteve konkurruese dhe marrëdhënieve kontraktuese në procesin e vlerës së shtuar dhe

- perkrahe tregtare me qëllim të tejkalimit të crregullimeve të tregut dhe sigurimin e stabilitetit të të ardhurave të produkteve bujqesore.

(2) Masat e perkrahes tregtare nga paragrafi (1), alineja 2 të këtij neni janë:

- 1) masat investuese;
- 2) masat për nxitjen e konsumit dhe
- 3) masat për mbrojtjen e tregut.

Garancite financiare

Neni 28

(1) Subjektet me të cilat kane të bejne masat për rregullimin dhe perkrahjen e tregjeve me prodhime bujqesore nga pjesa IV e ketij ligji, me kerkese të Ministrise, mund të japin garanci financiare dhe lloj tjetër të garancive për plotesimin e kushteve të caktuara të lidhura me masat për rregullimin e tregjeve të produkteve bujqesore.

(2) Nese obligimi për shkak të të cilit eshte dhene garancia financiare dhe lloj tjetër i garancise nga paragrafi 1 i ketij neni plotesohet, depoziti kthehet.

(3) Llojin e garancise dhe lartesine e garancise financiare dhe llojit tjetër të garancise nga paragrafi 1 i ketij neni e percakton ministri.

1. Rregullimi i kushteve dhe menyra e kryerjes së tregtise me produkte bujqesore

Tregtia me produkte bujqesore

Neni 29

(1) Tregtia me produkte bujqesore kryhet në kushte dhe menyre nga nenet 30, 31, 32, 33, 34, 35 dhe 36 të ketij ligji.

(2) Për gjithcka që nuk eshte rregulluar me kete ligj vlejne dispozitat nga Ligji për tregti, Ligji për marredhenie obliguese dhe Ligji për dogana.

Shitja e produkteve bujqesore

Neni 30

(1) Shitja e produkteve bujqesore mund të kryhet drejtperdrejt nga ekonomia bujqesore, në tregjet me pakice dhe shumice, nga shitjet në tezge levizese, shitjet në panaiare, shitjet nepermjet internetit, shitjet në vende për grumbullim (në tekstin e metejme: qendra grumbullimi), shitjet në vendet e grumbullimit dhe shitjet në tregjet për bageti.

(2) Shitjen nga paragrafi (1) i ketij neni mund ta kryejne:

- ekonomite bujqesore,
- shoqerite tregtare me veprimtari paresore prodhim të produkteve bujqesore dhe tregti me produkte bujqesore,
- kooperativat bujqesore me veprimtari paresore prodhim të produkteve bujqesore,
- kooperativa bujqesore me veprimtari paresore tregti me produkte bujqesore dhe
- organizata të prodhuesve.

(3) Nga prona bujqesore mund të shiten produkte bujqesore të prodhuara nga ekonomia bujqesore dhe produkte nga veprimtaria plotesuese e ekonomise bujqesore të dedikuara për konsum të fundit.

(4) Shitjen e produkteve bujqesore nga prona bujqesore mund ta beje bartesi i ekonomise bujqesore ose personi i cili eshte anetar i ekonomise familjare bujqesore dhe i cili eshte i autorizuar nga bartesi i ekonomise bujqesore.

(5) Shitja nga ekonomia familjare bujqesore behet nën kushtet e percaktuara nga neni 83 i ketij ligji.

Grumbullimi i produkteve bujqesore

Neni 31

(1) Grumbullimi i produkteve bujqesore, pervec duhanit behet edhe në forme të tregtise me shumice, grumbullimit për perpunimin e produkteve bujqesore dhe grumbullimi për nevoja personale nese behet në vendin e grumbullimit në pajtim me dispozitat e ketij ligji, ndersa për gjithte atë që nuk eshte e rregulluar në kete ligj, në pajtim me Ligjin për tregti.

(2) Grumbullim të prodhimeve bujqesore mund të bejne vetem persona juridike të cilet jane të regjistruar për perpunimin e produkteve bujqesore dhe persona juridike të regjistruar në Regjistrat e grumbulluesve të produkteve bujqesore që mbahet në Ministri.

(3) Grumbullimi i produkteve bujqesore behet vetem në vendet e grumbullimit të caktuara nga grumbulluesi të cilat i plotesojne kushtet në pajtim me nenet 31, 32, 33 dhe 34 të ketij ligji dhe për të cilat e ka njoftuar Ministrine në afat së paku prej 30 ditesh para fillimit të grumbullimit në vendin e parapare të grumbullimit.

(4) Në çdo vend të grumbullimit detyrimisht theksohen cmime për çdo kategori të kualitetit të produkteve bujqesore të cilat jane lende e grumbullimit dhe atë së paku 10 dite para fillimit të grumbullimit të produkteve bujqesore.

(5) Grumbullimi behet me marreveshje me shkrim për vitin e prodhimit të lidhur për minimum 50% nga sasite e realizuara, së paku 45 dite para kryerjes së grumbullimit dhe marreveshje me shkrim të lidhur në vendin e grumbullimit për sasite e mbetura, në forme dhe permbajtje në pajtim me nenin 32 të ketij ligji.

(6) Krahas kushteve nga paragrafet (2), (3) dhe (4) të ketij neni grumbulluesit duhet t'i plotesojne edhe kushtet si vijojne:

- të kene madhesi perkatese të personit juridik dhe shifer të veprimtarise,
- të kene likuidim në kuptimin e mjeteve financiare në disponim për grumbullimin e produkteve bujqesore,
- solvence në kuptimin e obligimeve të shlyera për grumbullimin e produkteve bujqesore,
- të disponojne me objekte perkatese për ndermarrje, klasifikim, magazinim dhe ruajtje të produktit bujqesor dhe pajisjes dhe
- të kene lidhur marreveshje për tregeti me shumice të produkteve bujqesore të grumbulluara nese grumbullimin e kryejne persona juridike të cilet jane regjistruar për kryerje të tregtise me produkte bujqesore.

(7) Kushtet më të peraferta nga paragrafet (3) dhe (6) i ketij neni i percakton ministri.

(8) Grumbulluesi obligohet që më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhes, t'i dorezoje Minisstrise të dhena për sasite e planifikuara për grumbullimin e produkteve bujqesore deri më 31 mars të vitit të ardhshem, si dhe të dhena për grumbullimin e realizuar për vitin paraprak.

(9) Llojin e të dhenave nga paragrafi (8) i ketij neni, menyren e dorezimit, formen dhe formularin për dorezim i percakton ministri.

Forma dhe permbajtja e marreveshjes për grumbullimin e produkteve bujqesore

Neni 32

(1) Marreveshja për grumbullimin e produkteve bujqesore (në tekstin e metejme: marreveshja) lidhet në forme me shkrim.

(2) Marreveshjanga paragrafi (1) i ketij neni vecanerisht permban:

- llojin e produktit dhe kualitetit,
- cmimin dhe sasine e produkti,
- kohezgjatjen e marreveshjes,
- lokacionin dhe kohen e dorezimit të lendes së marreveshjes,
- menyren dhe afatin e pageses dhe
- dispozita për nderprerjen dhe prishjen e marreveshjes.

(3) Marreveshja ka të beje me një ose më shume produkte bujqesore.

(4) Pagesen e produkteve të grumbulluara bujqesore grumbulluesi obligohet që ta beje në afat prej 30 ditesh nga dita e grumbullimit, perkatesisht dorezimit të produktit bujqesor në qendrat e grumbullimit.

(5) Me perjashtim nga paragrafi (4) i ketij neni, marreveshja mund të parashikojë pagese avance me pagesen e mbetjes nga vlера e produktit më së voni deri 180 dite nga dita e blerjes ose pagese të mjeteve në lartesi deri 20% nga vlера e produktit në afat prej 20 ditesh nga dita e grumbullimit dhe afat të pageses së mbetjes së vleres jo më gjate se 180 dite nga dita e grumbullimit.

(6) Marreveshja perpilohet në pese ekzemplare nga të cilet një ekzemplar detyrimisht i dorezohet Ministrise nepermjet njesive territoriale të Ministrise në afat prej tete ditesh nga dita e lidhjes së marreveshjes.

(7) Grumbulluesi obligohet që ta njoftoje Ministrine për çdo ndryshim të dispozitave nga marreveshja në afat jo më të gjate se tete dite nga ndryshimi i bere.

(8) Ndryshim të marreveshjes nga paragrafi (1) i ketij neni palet e marreveshjes mund të bejne më së voni dhjete dite para dorezimit të produktit nga marreveshja.

(9) Prodhuesi nuk guxon të lidhe marreveshje për sasite e produktit të dhene bujqesor për të cilat ka lidhur marreveshje me grumbullues tjetër.

(10) Nese cmimi nga paragrafi (2) i ketij neni caktohet si shtrirje e cmimit minimal dhe maksimal, shuma e shtrirjes së cmimit të kontraktuar llogaritet si:

- 40% nga cmimi minimal për cmime minimale deri në 10 denare për njesi prodhimi,
- 30% nga cmimi minimal për cmime minimale nga 10 deri 20 denare për njesi prodhimi dhe
- 20% nga cmimi minimal për cmime minimale mbi 20 denare për njesi prodhimi.

(11) Shuma e sakte e cmimit nga paragrafi (10) i ketij neni percaktohet më së voni në ditën e grumbullimit të produkteve bujqesore në suaza të shtrirjes së kontraktuar duke pasur parasysh cmimin e tregut të produktit.

(12) Në rast kur cmimi i tregut eshte më i larte se cmimi maksimal në suazat e shtrirjes së kontraktuar, cmimi grumbullues eshte maksimal në shtrirjen e kontraktuar.

(13) Në rast kur cmimi i tregut eshte më i ulet se cmimi minimal në suazat e shtrirjes minimale, cmimi grumbullues eshte minimal në shtrirjen e kontraktuar.

(14) Cmimi i tregut eshte cmimi i produkteve bujqesore të tregjeve në Republikën e Maqedonise për të cilin mbahet evidence në Ministri në pajtim me sistemin informativ të tregut bujqesor.

Regjistrimi në Regjistrin e grumbulluesve

Neni 33

(1) Ministria vendos dhe mban Regjister të grumbulluesve të produkteve bujqesore, pervec duhanit.

(2) Për regjistrim në Regjistrin nga paragrafi (1) i ketij neni paraqitet kerkese për regjistrim në Ministri.

(3) Kerkesa nga paragrafi (2) i ketij neni parashtrohet në formular të percaktuar me dokumentacion të nevojshem shoqerues për deshmine e plotesimit të kushteve nga neni 31 i ketij ligji.

(4) Formularin e kerkeses dhe dokumentacionin e nevojshem shoqerues nga paragrafi (3) i ketij neni i percakton ministri.

(5) Në rast kur kerkesa nga paragrafi (1) i ketij neni eshte e paplote dhe e paqarte, kerkuesi në forme të shkruar njoftohet për parregullsitate dhe i percaktohet afat prej 15 ditesh për menjanimin e parregullsive.

(6) Nese në afatin e percaktuar nga paragrafi (5) i ketij neni, kerkuesi nuk i menjanon parregullsitate, kerkesa do të refuzohet.

(7) Pas percaktimit të plotesimit të kushteve nga neni 31 i ketij ligji, ministri miraton aktvendim për regjistrim në Regjistrin nga paragrafi (1) i ketij neni.

(8) Aktvendimi nga paragrafi (7) i ketij neni miratohet më së voni në afat prej 30 ditesh nga pranimi i kerkeses.

(9) Organi kompetent për mbikeqyrje inspektuese i ketij ligji, pas regjistrimit të grumbulluesve në Regjister, çdo vit në periudhën nga 1 deri 31 maj, e percakton plotesimin e kushteve nga neni 31 i ketij ligji nga ana e grumbulluesve të regjistruar.

Menyra e mbajtjes së Regjistrit të grumbulluesve të produkteve bujqesore

Neni 34

(1) Regjistri i grumbulluesve të produkteve bujqesore mbahet në forme elektronike dhe i permban të dhenat nga kërkesa për regjistrim nga nenet 31 dhe 33 të këtij ligji.

(2) Krahas të dhenave nga paragrafi (1) i këtij neni, në Regjister detyrimisht regjistrohen të gjitha ndryshimet e gjendjes së regjistruar.

(3) Për ndryshimet nga paragrafi (2) i këtij neni, grumbulluesit e regjistruar obligohen që ta njoftojne Ministrine në afat prej 15 ditësh nga dita e ndodhjes së ndryshimit.

Shlyerja nga Regjistri i grumbulluesve të produkteve bujqesore

Neni 35

(1) Ministri, me aktvendim i shlyen grumbulluesit e regjistruar nga Regjistri i nenit 33 të këtij ligji në rastet si vijojne:

- me kërkesen me shkrim nga organi menaxhues të grumbulluesit të regjistruar,
- gjate publikimit të likuidimit ose procedures së hapur të falimentimit,
- nese percaktohet se grumbulluesi eshte i regjistruar në baze të të dhenave të pasakta dhe
- kur do të pushoje së plotesuari kushtet nga neni 31 i këtij ligji.

(2) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni grumbulluesi ka të drejte ankese te Komisioni i shkalles së dyte në Qeverine e Republikës së Maqedonise kompetent për zgjidhjen puneve administrative të shkalles së dyte nga fusha e bujqesise, pylltarise dhe ekonomise bujqesore.

(3) Pas aktvendimit të plotfuqishem nga paragrafi (1) i këtij neni, grumbulluesi shlyhet nga Regjistri i grumbulluesve.

Regjistri i transportuesve të produkteve të vecanta bujqesore

Neni 36

(1) Personat juridike të cilet transportojne produkte të vecanta bujqesore (në tekstin e metejme: transportues) me qellim që t'i shesin në forme origjinare, të perpunuar në menyre plotesuese ose të perpunuar regjistrohen në regjistrin e transportuesve të produkteve të vecanta bujqesore.

(2) Kushtet për regjistrim në regjistrin e transportuesve të produkteve të vecanta bujqesore jane:

- të kene madhesi perkatese të personit juridik dhe shifer të veprimtarise,
- solvence në kuptim të obligimeve të shlyera për grumbullimin e produkteve bujqesore,
- të disponojne me objekte perkatese për ndermarrje, klasifikim, magazinim dhe ruajtje të produktit bujqesor dhe pajisjes dhe
- të kene marreveshje të lidhura për shitjen e produkteve bujqesore të transportuara nese nuk jane të dedikuara për perpunimin e vet.

(3) Më kërkesen e Ministrise, krahas kushteve nga paragrafi (2) i këtij neni, transportuesit e produkteve të vecanta bujqesore duhet të dorezojne deshmi për likuidim në pune në forme të garancive bankare.

(4) Kushtet nga paragrafet (2) dhe (3) të këtij neni më afersisht i percakton ministri.

(5) Procedura për regjistrim, menyre të evidentimit dhe shlyerjes nga regjistri i transportuesve të produkteve të vecanta bujqesore kryhet në pajtim me nenet 33, 34 dhe 35 të këtij ligji.

(6) Qeveria me propozim të ministrit i percakton produktet e vecanta bujqesore nga paragrafi (1) i këtij neni.

2. Masat për stabilizimin e tregjeve të produkteve bujqesore

Masat intervenuese

Neni 37

(1) Masat intervenuese janë të dedikuara për stabilizimin e tregjeve të produkteve bujqesore dhe mund të zbatohen kur ndodh crregullim ndermjet ofertes dhe kërkeses së tregut të vendit të produkteve bujqesore.

(2) Masat nga paragrafi (1) i këtij neni mund të realizohen nepermjet:

- grumbullimit intervenues dhe
- perkrahjes për magazinim.

(3) Masat nga paragrafi (2) i këtij neni kanë të bëjnë me grurin nga prodhimi vendor.

(4) Qeveria me propozimin e ministrit mund të caktojë edhe produkte tjera bujqesore me të cilat kanë të bëjnë masat nga paragrafi (2) i këtij neni.

Grumbullimi intervenues

Neni 38

(1) Për shkak stabilizimit dhe rregullimit të tregut me grure, ndërsa për nevojat e rezervave të mallrave, nën kushte dhe procedure të percaktuara me kete ligj behet grumbullim intervenues i grurit.

(2) Grumbullimi intervenues mund të behet vetem me grure i cili është i prodhuar në Republikën e Maqedonisë dhe që i ploteson kushtet dhe kriteret për grumbullim intervenues të percaktuara me kete ligj.

Organi kompetent

Neni 39

(1) Zbatimin e grumbullimit intervenues të grurit e bën ministria, nepermjet Agjencisë dhe Agjencisë për Rezerva të Mallrave.

(2) Agjencia e zbaton proceduren për zgjedhje të ofruesve të pranueshem, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Agjencia për Rezerva të Mallrave lidh marreveshje për blerje të grurit me ofruesit e zgjedhur nga paragrafi (2) i këtij neni.

Cmimi intervenues

Neni 40

(1) Furnizimi nga neni 39, paragrafi (3) i këtij ligji behet sipas cmimit intervenues.

(2) Qeveria, me propozimin e Ministrisë, e percakton lartesine e cmimit intervenues të grurit në suazat e shpenzimeve mesatare prodhuese për prodhim të një kilogram gruri për sezonin e dhene prodhues.

(3) Cmimi i tregut është cmim grumbullues mesatar mujor i grurit në tregjet në Republikën e Maqedonisë i cili rregullohet në pajtim me sistemin informativ të tregut bujqesor.

(4) Nese cmimi i tregut të grurit është më i larte se shpenzimet mesatare prodhuese, nuk behet grumbullim intervenues.

(5) Shpenzimet mesatare prodhuese percaktohen në baze të të dhenave nga rrjeti i të dhenave të kontabilitetit të ekonomive bujqesore.

(6) Dallimi ndermjet cmimit intervenues dhe cmimit të tregut për grurin e grumbulluar sigurohet me programet nga neni 7, paragrafi (3) i këtij ligji.

Shpalljet dhe ofertat për grumbullim intervenues

Neni 41

(1) Agjencia për Perkrahe Financiare të Zhvillimit Bujqesor dhe Rural, me kërkesen e Agjencise për Rezerva të Mallrave publikon shpallje për grumbullimin e ofertave për grumbullim intervenues të grurit.

(2) Shpallja publike detyrimisht permban:

- llojin dhe kualitetin e grurit,
- sasine grumbulluese të grurit i cili do të grumbullohet,
- kushte të cilat duhet t'i plotesojne ofruesit në lidhje me formen organizuese dhe madhesine e kapaciteteve prodhuese,
- kriteret për zgjedhje të ofruesve të pranueshem,
- vendin e magazinave,
- dokumentacionin e nevojshem,
- menyren dhe afatin e dorezimit të ofertes dhe
- të dhena tjera të nevojshme.

Kushtet

Neni 42

(1) Të drejte të pjesemarrjes në shpalljen nga neni 41 i ketij ligji kane ekonomite bujqesore të regjistruar në RUEB.

(2) Ekonomite bujqesore mund t'i ofrojne vetem sasite e grurit të prodhuar personal në siperfaqet e paraqitura në RUEB për sezonin e dhene prodhues.

(3) Sasia minimale e cila mund të ofrohet nga një ofrues eshte 10 000 kilogram, ndersa sasia maksimale eshte 50 000 kilogram grure.

(4) Kriter në baze të të cilit do të behet zgjedhja e ofruesve të pranueshem eshte koha e paraqitjes së ofertes së plote.

(5) Në rast të numrit më të madh të ofertave të pranueshme nga sasite e shpallura, zgjedhet oferta e ofruesve të cilet më pare kane paraqitur kerkese të plote në suaze të afatit për paraqitje.

Procedura për zgjedhje dhe njoftim për ofertat e grumbullimit intervenues

Neni 43

(1) Drejtori i Agjencise miraton aktvendim për zgjedhjen e ofruesve të pranueshem sipas shpalljes së konkursit publik.

(2) Aktvendimi nga paragrafi (1) i ketij neni detyrimisht permban emrin dhe mbiemrin e ofruesit, adresen e ofruesit dhe sasine e drithit për grumbullimin intervenues.

(3) Kunder aktvendimit të drejtorit të Agjencise, ofruesi i pakenaqur ka të drejte ankese te Komisioni i Qeverise së Republikes së Maqedonise për zgjidhje me procedure administrative në shkallen e dyte nga sfera e bujqesise, pylltarise dhe ekonomise së ujerave.

(4) Pas perfundimit të Aktvendimit nga paragrafi (1) i ketij neni, Agjencia për rezerva të mallrave lidh marreveshje për furnizimin e drithit me ofruesit e zgjedhur të drithit për grumbullimin intervenues.

Mbeshtetja për magazinim

Neni 44

(1) Mbeshtetje për magazinim domethene sigurim i cmimit më të ulet për magazinimin ose mbulimin e shpenzimeve për magazinimin e produkteve të caktuara bujqesore.

(2) Proceduren për ndarjen e ndihmes financiare nga paragrafi (1) i ketij neni dhe dokumentacionin e nevojshem, shfrytezuesit, lartesine e ndihmes, kushtet për magazinim dhe llojin dhe kualitetin e produkteve e percakton Qeveria me propozimin e Ministrise.

Masat për nxitjen e konsumit

Neni 45

(1) Masat për nxitjen e konsumit të pemeve dhe perimeve të fresketa, qumeshtit dhe produkteve të qumeshtit janë dedikuar për permiresimin e kualitetit të ushqimit të personave nën 18 vjet, personave të ekspozuar në rreziqe sociale për shendetin dhe rreziqe nga varferia, të perfshire në sistemin shtetëror arsimor, shendetësor dhe social.

(2) Masat për nxitjen e konsumit të pemeve dhe perimeve të fresketa dhe qumeshtit dhe produkteve të qumeshtit janë:

- grumbullimi i pemeve dhe perimeve të fresketa të prodhuara në Republikën e Maqedonise dhe

- paketimi dhe shperndarja e produkteve të grumbulluara.

(3) Për realizimin e qellimeve nga paragrafi (1) i ketij neni, Qeveria me propozim të ministrit, miraton program për nxitjen e konsumit të pemeve dhe perimeve të fresketa dhe qumeshtit dhe produkteve të qumeshtit.

(4) Programi nga paragrafi (3) i ketij neni permban:

- llojin dhe kualitetin e produktit,

- sasite e produktit,

- afatet për realizimin e masave nga paragrafi (2) i ketij neni,

- mjetet financiare të nevojshme për realizimin e masave nga paragrafi (2) i ketij neni dhe

- konsumatorët nga paragrafi (1) i ketij neni.

(5) Proceduren e grumbullimit, paketimit dhe shperndarjes së produkteve të grumbulluara e zbaton Agjencia, në pajtim me Ligjin për furnizim publik.

(6) Produktet e furnizuara në pajtim me paragrafin (5) të ketij ligji, pa kompensim, me marreveshje ua shperndan konsumatorëve të percaktuar në programin nga paragrafi (4) i ketij neni.

2. Masat për mbrojtjen e tregut

Masat e vecanta

Neni 46

(1) Gjate rrezikut nga crregullimet serioze të tregut me produkte bujqesore, të cilat mund t'i rrezikojne qellimet e politikës nacionale të bujqesise, Qeveria mund të zbatoje masa të vecanta për mbrojtjen e tregut në periudhen derisa nuk kalon crregullimi ose rreziku nga crregullimi i tregut.

(2) Masat e vecanta për mbrojtjen e tregut janë:

- percaktimi i detyrimeve importuese plotesuese mbi cmimin minimal në kufi dhe

- lidhja e sasive të produkteve të caktuara bujqesore gjate importit me grumbullimin e produkteve bujqesore të prodhuara në Republikën e Maqedonise.

(3) Cmimin minimal në kufi nga paragrafi (2), alineja 1 e ketij neni e percakton Qeveria, me propozimin e Ministrise së Financave për produktet e vecanta bujqesore në kushtet e crregullimit të tregut të brendshem .

(4) Qeveria me propozimin e ministrit i percakton produktet dhe relacionin e sasise nga paragrafi (2), alineja 2 e ketij neni.

V. POLITIKA E PAGESAVE TË DREJTPERDREJTA

Pagesat e drejtperdrejta

Neni 47

(1) Pagesat e drejtperdrejta janë mase për perkrahjen e të ardhurave të ekonomise bujqesore.

(2) Pagesat e drejtperdrejta u paguhen ekonomive bujqesore dhe atë për siperfaqen e tokes bujqesore, njesine e produktit bujqesor dhe koke kafshe.

(3) Lartesia e pagesave të drejtperdrejta nga paragrafi (2) i ketij neni percaktohet varesisht nga lloji i kultures, lloji, klasa dhe kualiteti i produktit bujqesor dhe lloji i kafshes.

(4) E drejta e pageses së drejtperdrejte mund të kufizohet me dispozicionin e siperfaqes minimale të tokes bujqesore dhe /ose numrit minimal të kokeve të kafsheve dhe/ose njesise minimale të produktit bujqesor nga ana e konsumatoreve nga neni 14 i ketij ligji.

(5) Shuma maksimale e pagesave të drejtperdrejta për konsumator mund të kufizohet varesisht nga madhesia e siperfaqes së tokes bujqesore, njesise së produktit bujqesor dhe numrit të kokeve të kafsheve me të cilat disponon konsumatori.

(6) Kriteret më të peraferta nga paragrafet (2), (3) dhe (4) të ketij neni, konsumatorët nga neni 14 i ketij ligji sipas masave të vecanta, shumat maksimale nga paragrafi (5) i ketij neni dhe menyren e pageses së drejtperdrejte, çdo vjet i percakton Qeveria me propozimin e ministrit.

Sistemi integrues për administrim dhe kontroll

Neni 48

(1) Zbatimi i masave të pageses së drejtperdrejte mund të kryhet nepermjet sistemit integrues të administrimit dhe kontrollit (në tekstin e metejme: (SIAK) i cili mundeson funksionim të harmonizuar dhe kembim të papengueshem të të dhenave ndermjet ketyre elementeve të sistemit:

- baze kompjuterike e të dhenave nga kerkesat për pagesat e drejtperdrejta të ekonomise bujqesore për vitin rrjedhes dhe së paku për kater vitet e meparshme,

- sistem për identifikimin e parcelave të tokes, i cili funksionon në nivelin e parces referente, të vendosur në baze të hartes, dokumenteve të kadastrit ose ndonje tjeter dokument hartografik, dhe perdorimi i të cilit mundesohet sipas teknologjise së sistemit të kompjuterizuar gjeografik informativ, duke perfshire ortoincizimet ajrore dhe hapesine me saktesi të homogjenizuar, standarde dhe të garantuar së paku ekuivalente me hartografine në permasa 1:10 000;

- sistem për identifikimin dhe regjistrimin e së drejtes të pageses së drejtperdrejte, i cili mundeson verifikimin e së drejtes të pageses së drejtperdrejte të ekonomise bujqesore dhe kontrole të kryqezuara me të dhenat nga kerkesa për pagesa të drejtperdrejte dhe nga sistemi për identifikimin e parces së tokes në vitin rrjedhes dhe së paku kater vitet e meparshme,

- sistem për identifikimin dhe regjistrimin e kafsheve, i cili mundeson të dhena për gjendjen e numrit të kafsheve sipas rasave dhe llojeve,

- kerkesa për pagesa të drejtperdrejta,

- sistem kontrollues për percaktimin e harmonizimit të të dhenave nga kerkesa me kushtet për shperndarjen e pagesave të drejtperdrejta dhe

- sistem unik për kontrollin e identitetit të çdo bartesi të ekonomise bujqesore i cili parashtron kerkese për pagesa të drejtperdrejta.

(2) Administrimi i masave të pagesave të drejtperdrejta perfshin procedura për:

- parashtrimin e kerkeses për pagesa të drejtperdrejta në pajtim me kushtet e caktuara,

- kontrole administrative dhe kontrole të të gjitha kerkesave për pagesa të drejtperdrejta, si dhe kontroll në vendin e ngjarjes i cili nxirret në ekzemplar in e ekonomise bujqesore në baze të planit zgjedhor,

- miratim të lejes për pagesa të drejtperdrejta,

- llogaritje të lartesisë së pagesave të drejtperdrejta dhe

- pagese dhe/ose kthim të pagesave të drejtperdrejta.

(3) Për zbatimin e pagesave të drejtperdrejta, varesisht nga lloji i masave zbatohen një ose më shume elemente të SIAK-ut.

(4) Menyren e funksionimit të SIAK-ut dhe kembimin e ndersjelle të të dhenave, si dhe formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së regjistrave dhe bazave të të dhenave perkatese i percakton ministri.

(5) Menyren e funksionimit të elementeve të SIAK-ut në kompetence të Agjencise i percakton drejtori i Agjencise.

(6) Elementet e SIAK-ut mund të shfrytezohen edhe për realizimin e masave tjera nga mbeshtetja politike e zhvillimit bujqësor dhe rural.

Pershtatja e kryqezuar për pagesat e drejtperdrejta

Neni 49

(1) Pagesat e drejtperdrejta mund të kushtezohen me plotesimin e kerkesave të detyrueshme ose me kushtet e lidhura me mbrojtjen e mjedisit jetesor, shendetin e njerezve, kafsheve dhe bimeve dhe mireqenien e kafsheve, si dhe me plotesimin e kushteve të vecanta minimale për praktike të mire bujqësore dhe mbrojtje të mjedisit jetesor të percaktuara në pajtim me ligjin (në tekstin e metejme: pershtatja e kryqezuar).

(2) Në baze të karakteristikave specifike në lidhje me kushtet tokesore dhe klimatike, sistemet ekzistuese të produktit bujqësor, shfrytezimin e tokes bujqësore, mbjelljet alternative të kulturave, praktiken e prodhimitarise bujqësore dhe strukturen e ekonomise bujqësore, ministri percakton dhe shpall listen e kushteve të vecanta minimale për praktike të mire bujqësore dhe mbrojtjen e mjedisit jetesor nga paragrafi (1) i ketij neni të cilat mund të kene të bejne në nivel nacional ose rajonal.

(3) Percaktimi i plotesimit të kerkesave ose kushteve të detyrueshme dhe kushteve të vecanta minimale nga paragrafi (1) i ketij neni kryhet nepermjet kontrolleve në vendin e ngjarjes me perdorimin e sistemeve administrative dhe kontrolluese nga neni 48 i ketij ligji.

Kerkesa për pagesa të drejtperdrejta

Neni 50

(1) Kerkesa për pagesa të drejtperdrejta parashtrohet çdo vit nga ana e bartesit të ekonomise bujqësore, dhe i permban grupet e të dhenave të nevojshme për vleresimin e pranimit të kerkeses nga aspekti i plotesimit të kushteve të percaktuara, si vijon:

- të dhena të pergjithshme për bartesin e ekonomise bujqësore dhe llojin e masave të pagesave të drejtperdrejta,

- identifikim për të gjitha parcelat e tokes dhe numrin e mbeltimeve shumevjecare me lokacionin e tyre hapesine në material grafik dhe shfrytezimin e tokes bujqësore,

- numrin dhe llojin e kafsheve dhe

- të dhena tjera që kerkohen me masat e pagesave të drejtperdrejta.

(2) Kerkesa për pagesa të drejtperdrejta mund të paraqese edhe pjese nga kerkesa e vetme me të cilen do të perfshihen edhe llojet tjera të mbeshtetjes së zhvillimit bujqësor dhe rural.

(3) Kerkesa për pagesa të drejtperdrejta në teresi ose pjese të saj mund të terhiqet, ndryshohet ose plotesohet sipas formes së shkruar nga ana e parashtruesit më së voni në afat prej 30 ditesh nga dorezimi, pervec nese bartesi i ekonomise bujqësore tani më eshte informuar nga ana e Agjencise për qellimin e kryerjes së kontrollit në vendin e ngjarjes, ose për ekzistimin e parregullise në kerkese.

Zvogelimi ose perjashtimi i pagesave të drejtperdrejta në rast të mosharmonizimit me kushtet e kerkeses

Neni 51

(1) Nese në proceduren nga neni 48, paragrafi (2) i ketij ligji konstatohet se ekonomia e bujqesise nuk eshte në harmonizim me kushtet e pergjithshme për pranimin e shperndarjes së pagesave të drejtperdrejta, ose nuk i ploteson kerkesat ose kushtet e detyrueshme dhe kushtet e vecanta minimale nga neni 49 i ketij ligji, shumen e plote ose një pjese të shumes së pagesave të drejtperdrejta që eshte paguar, ose që duhet të paguhet për ato masa ku jane plotesuar kushtet e nevojshme, eshte lende e zvogelimit deri në perjashtimin e pagesave të drejtperdrejta.

(2) Perqindja e zvogelimit deri në perjashtimin e plote të një ose disa llojeve të perkrahjes, për një ose me shume vite kalendarike, varet nga serioziteti, perseritja, vellimi dhe kohezgjtja e mosharmonizimit të konstatuar.

(3) Nese ekonomia bujqesore nuk i ploteson kushtet nga paragrafi (1) i ketij neni si rezultat i fuqise madhore ose rasteve të jashtezakonshme, ekonomia bujqesore ka të drejte të pagesave të drejtperdrejta për siperfaqe bujqesore të pranueshme në kohen kur ka ndodhur fuqia madhore ose rastet e jashtezakonshme.

(4) Të drejten e pagesave të drejtperdrejta nga paragrafi (3) i ketij neni, ekonomia bujqesore mund ta realizoje vetem nese e njofton me shkrim Agjencine për deshmitë e fuqise madhore ose të rasteve të jashtezakonshme në afat prej 15 ditësh nga dita e shkaktimit të fuqise madhore ose të rasteve të jashtezakonshme.

Llogaritja e lartesisë së pagesave të drejtperdrejta sipas siperfaqes së tokes bujqesore

Neni 52

Pagesat e drejtperdrejta sipas siperfaqes së tokes bujqesore llogariten në siperfaqet e tokes së shfrytezuar bujqesore të cilat ekonomia bujqesore i paraqet në kerkesen për pagesa të drejtperdrejta, në pajtim me kushtet dhe kerkesat e caktuara dhe nuk i tejkalon siperfaqet të percaktuara me kontrolle administrative ose me kontrolle në vendin e ngjarjes.

Zvogelimi ose perjashtimi i pagesave të drejtperdrejta sipas siperfaqes së tokes bujqesore

Neni 53

(1) Nese gjate kontrollit në vendin e ngjarjes konstatohet se madhesia e siperfaqes së tokes bujqesore eshte:

- më e madhe se madhesia e siperfaqes së theksuar në kerkesen për pagesa të drejtperdrejta, lartesia e pagesave të drejtperdrejta llogaritet në baze të madhesise së siperfaqes së theksuar në kerkese,

- me e vogel se 5 % nga madhesia e siperfaqes së theksuar në kerkesen për pagesat e drejtperdrejta, lartesia e pagesave të drejtperdrejta llogaritet në baze të siperfaqes së percaktuar gjate kontrollit e zvogeluar për shumën e dallimit të konstatuar,

- me e vogel ndermjet 5% - 30%, ose për dy hektar nga madhesia e siperfaqes së theksuar në kerkesen për pagesat e drejtperdrejta, lartesia e pagesave të drejtperdrejta llogaritet në baze të siperfaqes së konstatuar gjate kontrollit e zvogeluar për shumën e dallimit të konstatuar të zmadhuar për dy here dhe

- më e vogel prej 20% - 50 % nga madhesia e siperfaqes së theksuar në kerkese, ekonomia bujqesore teresisht perjashtohet nga shfrytezimi i pagesave të drejtperdrejta për vitin e dhene.

(2) Me zbatimin e zvogelimit nga paragrafi (1) i ketij neni, nese percaktohet dallim ndermjet sasise së fares së certifikuar të furnizuar në pajtim me kerkesen për pagesa të drejtperdrejta dhe fares së perdorur me të vrtete:

- ndermjet 2% - 5%, shumën e pagesave të drejtperdrejta për shfrytezimin e materialit të fares së certifikuar, zvogelohet për 50% dhe

- mbi 5%, shumën e pagesave të drejtperdrejta për konsumimin e materialit të fares së certifikuar nuk paguhet.

(3) Nese eshte parashtruar kerkesa për pagesat e drejtperdrejta për shfrytezimin ose prodhimin e materialit faror ose mbjelles i cili nuk eshte perdorur, prodhuar me të vrtete ose zyrtarisht i certifikuar, ekonomia bujqesore perjashtohet nga pagesat e drejtperdrejta të materialit faror ose materialit mbjelles si edhe nga pagesat e drejtperdrejta sipas siperfaqes në vitin e parashtrimit të kerkeses dhe në vitin e ardhshem.

Baza e llogaritjes së pagesave të drejtperdrejta për koke bagetie

Neni 54

(1) Pagesat e drejtperdrejta për koke bagetie llogariten për numër të kafsheve i cili nuk mund të jete më i madh se numri i paraqitur në kerkesen për pagesa të drejtperdrejta, në pajtim me kushtet dhe kerkesat e caktuara, dhe nuk e tejkalon numrin e konstatuar me kontroll administrativ ose në vendin e ngjarjes.

(2) Si baze për llogaritjen e pagesave të drejtperdrejta për koke bagetie mund të shfrytezohet edhe koke e kushtezuar në pajtim me koeficientin e caktuar.

(3) Pagesat e drejtperdrejta nga paragrafi (1) i ketij neni paguhen vetem për ekonomine bujqesore e cila e mban numrin e njejte të kokeve për të cilat ka parashtruar kerkese në periudhen e ruajtjes të detyrueshme të kafsheve nga paragrafi (7) i ketij neni.

(4) Ekonomia bujqesore e mban të drejten e pagesave të drejtperdrejta të numrit të kafsheve për të cilat ka parashtruar kerkese nese gjate periudhes të ruajtjes së detyrueshme të kafsheve nga paragrafi (3) i ketij neni bën zevendesimin e kafsheve pa zvogelimin e numrit të tyre, duke perfshire zevendesimin ndermjet dheneve dhe dhive nese për to eshte parapare shume e njejte e pagesave të drejtperdrejta.

(5) Zevendesimi nga paragrafi (4) i ketij neni duhet të kryhet në periudhe prej 20 ditesh nga ngjarja për shkak të së ciles eshte e domosdoshme të kryhet zevendesimi i kafsheve dhe të njejtat të futen në Sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafsheve jo më vonë se tre dite nga dita e zevendesimit. Ekonomia bujqesore e informon Agjencine për zevendesimin e kafsheve në afat prej dhjete ditesh nga zevendesimi i kryer.

(6) Nese ekonomia bujqesore nuk i ploteson kerkesat për periudhen e detyrueshme të ruajtjes së kafsheve si rezultat i fuqise madhore ose rasteve të jashtezakonshme, ekonomia bujqesore ka të drejte të pagesave të drejtperdrejta për numrin e kafsheve në kohen e ndodhjes së fuqise madhore ose të rastit të jashtezakonshem.

(7) Koeficientin e shnderrimit të numrit të kokeve reale në të kushtezuara nga paragrafi (2) i ketij neni dhe periudhen e caktuar të ruajtjes së detyruar të kafsheve nga paragrafi (3) i ketij neni i percakton Qeveria me aktin nga neni 47 i ketij ligji.

Zvogelimi dhe perjashtimi i pagesave të drejtperdrejta për koke bagetie

Neni 55

(1) Nese gjate kontrollit në vendin e ngjarjes konstatohet se numri i kokeve, perkatesisht numri i familjeve bletore eshte:

- më i madh se numri nga kerkesa për pagesa të drejtperdrejta, lartesia e pagesave të drejtperdrejta llogaritet në baze të numrit së kokeve, perkatesisht familjeve bletore të paraqitura në kerkese,

- më i vogel se numri i kokeve, perkatesisht familjeve bletore në kerkesen për pagesa të drejtperdrejta për më së shumti deri më 10% dallim, lartesia e pagesave të drejtperdrejta që duhet ta fitoje ekonomia bujqesore zvogelohet nga perqindja e jo rregullshmerise nga paragrafi (2) i ketij neni,

- më i vogel nga numri i kokeve, perkatesisht familjeve bletore në kerkesen për pagesa të drejtperdrejta prej 10 deri 20%, lartesia e pagesave të drejtperdrejta zvogelohet për perqindjen e pa rregullshmerise nga paragrafi (2) i ketij neni të zmadhuar për dy here dhe

- më i vogel nga numri i kokeve, perkatesisht familjeve bletore në kerkesen për pagese të drejtperdrejte prej 20 deri 30%, ekonomia bujqesore në teresi perjashtohet nga shfrytezimi i pagesave të drejtperdrejta për vitin e dhene.

(2) Perqindja e pa rregullshmerise llogaritet si lidhje ndermjet numrit të kokeve të zbuluara të parregullta dhe numrit të pergjithshem të kokeve të caktuar me kontrollet.

(3) Ulja dhe perjashtimi i pagesave të drejtperdrejta nga paragrafi (1) i ketij neni nuk do të zbatohet ne raste kur si rezultat i ndikimeve natyrore të konfirmuara nga sherbimet veterinare zyrtare siç jane: ngordhja e kafshes ose pasojat nga semundja, dhe ngordhja e kafshes si rezultat i fatkeqesise për të cilen nuk eshte pergjegjes bartesi i ekonomise bujqesore, i njeiti nuk eshte në gjendje t'i plotesoje kushtet për periudhen e detyrueshme të ruajtjes së kafsheve.

(4) Dispozitat nga paragrafi (3) i ketij neni zbatohen vetem nese ekonomia bujqesore në forme me shkrim e njofton Agjencine për zvogelimin e numrit të kafsheve më së voni në afat prej dhjete ditesh nga dita e zvogelimit.

Ulja dhe perjashtimi i pagesave të drejtperdrejta në rastin e mos-harmonizimit të qellimshem

Neni 56

Në rastin kur eshte konstatuar dallimi ndermjet të dhenave të konstatuara me kontrollin administrativ ose me kontrollin në vendin e ngjarjes dhe të dhenave të kerkeses të njerës ekonomie bujqesore për pagesa të drejtperdrejta dhe e njejtа eshte më e madhe prej 30%, ose mbi 1 000 000 denare, ekonomia bujqesore perjashtohet nga pagesat e drejtperdrejta për vitin rrjedhes dhe për tre vitet e ardhshme.

Ulja dhe perjashtimi i pagesave të drejtperdrejta për pershtatjen e kryqezuar

Neni 57

(1) Shuma e pergjithshme e pagesave të drejtperdrejta zvogelohet gjate mosperputhjes me kerkesat e detyrueshme ose me kushtet dhe me kushtet e vecanta minimale për pershtatjen e kryqezuar nga neni 49 i ketij ligji, në rast të:

- mosperputhjes për here të pare prej 1% deri 5%,
- mosperputhjes së perseritur deri në 15%, me çka vleresimi nga alineja 1 e ketij ligji nga mosperputhja e pare zmadhohet për tre here gjate seciles mosperputhje të ardhme deri më 15% kumulative maksimale pas së ciles kalohet në mosperputhje nga alineja 3 e ketij paragrafi,
- mos harmonizim me qellim në pajtim me kriteret e seriozitetit, perseritjes, vellimit dhe kohezgjatjes të mosperputhjes së evidentuar, mbi 20% jane në perjashtim të teresishem prej një ose më shume llojeve të mbeshtetjes për një ose më teper vitesh.

(2) Me perjashtim të paragrafit (1) të ketij neni, në rast të shmangies me vellim më të vogel që nuk paraqet rrezik për shendetin publik të njeriut ose kafsheve vleresimi sipas kriterëve të seriozitetit, perseritjes, vellimit dhe kohezgjatjes së mosharmonizimit të evidentuar, nuk do të kryhet ulja e shumes së pagesave të drejtperdrejta.

(3) Agjencia njofton ekonomine bujqesore për terheqjen e konfirmuar të pershtatjes së kryqezuar me vellim më të vogel, si dhe për obligimin e ndermarrjes së aktivitetëve për tejkalimin e tyre në afat jo më të gjate se 31 dhjetori i vitit rrjedhes në të cilin eshte percaktuar mospershtatja.

(4) Nese pas njoftimit nga paragrafi (3) i ketij neni ekonomia bujqesore nuk ndermerr aktivite për tejkalimin e mospershtatjes zbatohet ulja ose perjashtimi i pagesave të drejtperdrejta në pajtim me paragrafin (1), alineja 1 e ketij neni.

Perjashtimet nga zbatimi i uljes dhe perjashtimit të pagesave të drejtperdrejta

Neni 58

Ulja ose perjashtimi i pagesave të drejtperdrejta nuk do të zbatohet kur ekonomia bujqesore ka derguar të dhena të sakta ose kur do të deshmoje se nuk ka bere gabim.

Llogaritja e lartesisë të pagesave të drejtperdrejta për njesi produkti

Neni 59

(1) Pagesat e drejtperdrejta për njesi produkti llogariten sipas sasise së prodhuar dhe të shitur të produktit bujqesor të personave juridike të cilet merren me grumbullimin, perpunimin dhe tregtine e produkteve primare bujqesore, kushteve për therje dhe personave juridike për prodhimin e materialeve për prodhimtari bujqesore dhe jane të regjistruar në regjistrin perkates të Ministrise.

(2) Pagesat e drejtperdrejta nga paragrafi (1) i ketij neni llogariten në baze të të dhenave të krahasuara të dorezuara nga ekonomite bujqesore dhe personat juridike nga paragrafi (1) i ketij neni.

Dorezimi i të dhenave nga ana e personave juridike

Neni 60

(1) Kur për realizimin e të drejtes së ekonomive bujqesore për pagesa të drejtperdrejta janë të nevojshme të dhenat e personave juridike nga neni 59, paragrafi (1) i këtij ligji, të njejtet obligohen që t'i dorezojnë të dhenat në afatin e percaktuar në aktin nga neni 47, paragrafi (6) i këtij ligji.

(2) Nëse personat juridike nga paragrafi (1) i këtij neni me qëllim ose nga pakujdesia për here të dyte bëjnë parregullsi në paraqitjen e të dhenave të rrejshme, të njejtet do të perjashtohen nga dorezimi i të dhenave të nevojshme për pagesat e drejtperdrejta në periudhe prej një viti.

Pagimi i pagesave të drejtperdrejta

Neni 61

(1) Pagimi i pagesave të drejtperdrejta nuk mund të kryhet para konfirmimit se shfrytezuesi i ploteson kushtet për ndarjen e pagesave të drejtperdrejta.

(2) Pagimet i behen drejtperdrejte ekonomive bujqesore, gjate vitit kalendarik, ose në rast të mungesës së mjeteve financiare ose gjate zgjatjes së procedurave administrative për arsye objektive, më së voni deri më 30 qershor të vitit të ardhshem kalendarik.

(3) Agjencia obligohet që ta njoftoje ekonomine bujqesore për pagimin e kryer më së voni një muaj pas skadimit të afatit për realizimin e pagimeve nga paragrafi (2) i këtij neni.

VI. POLITIKA PËR ZHVILLIM RURAL

Parimet e pergjithshme

Neni 62

(1) Politika për zhvillim rural realizohet për arritjen e qëllimeve me prioritet për zgjidhjen e situatave zhvillimore në mjediset rurale dhe për nxitjen e mundesive dhe shfrytezimin e perpaesive për zhvillim rural.

(2) Nepermjet politikës për zhvillim rural realizohen keto prioritete:

- zmadhimi i aftesise konkurruese në sektorin e bujqesise dhe pylltarise,
- mbrojtja dhe avancimi i mjedisit jetesor dhe zonave rurale,
- permiresimi i kualitetit të jetes në mjediset rurale dhe nxitja e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike për zmadhimin e mundesive të punesimit në mjediset rurale dhe
- nxitja e zhvillimit lokal në mjediset rurale.

(3) Sferat me prioritet nga paragrafi (2) i këtij neni janë instrumente të politikës për zhvillim rural të cilat realizohen nepermjet zbatimit të masave nga nenet 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 86 dhe 87 të këtij ligji.

(4) Zbatimi i masave caktohet në pajtim me programin nacional nga neni 7 i këtij ligji.

(5) Masat nga paragrafi (3) i këtij neni realizohen nepermjet programit për mbeshtetje financiare të zhvillimit rural nga neni 7, paragrafi (3) i këtij ligji.

Mjediset rurale, bashkesite rurale dhe rajonet rurale

Neni 63

(1) Mjedisi rural është zone e komunes në Republikën e Maqedonisë në të cilën asnjë vend i banuar i komunes nuk ka më shumë se 30 000 banorë në pajtim me regjistrimin nacional të popullsisë dhe amviserisë në Republikën e Maqedonisë ose me dendesinë e popullatës më të vogël ose të barabartë me 150 banorë në kilometer katror në zonën e komunes.

(2) Në komunat ku një ose më shumë vende të banuara kanë më shumë se 30 000 banorë ose dendësia e popullatës është më e madhe se 150 banorë në kilometer katror, për mjedise rurale konsiderohen vetëm territoret e vendeve të banuara në komune që i plotesojnë kriteret nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Vendet e banuara në mjediset rurale nga paragrafet (1) dhe (2) të ketij neni janë bashkësi rurale.

(4) Bashkësitë rurale nga paragrafi (3) i ketij neni ndahen në keto kategori:

- bashkësitë rurale të paarritshme, në baze të largësisë nga qyteti i më i afërt i banuar,
- bashkësitë rurale të prapambetura, në baze të numrit të popullatës me aftësi punuese të angazhuar në veprimtarinë bujqësore, numrit të shoqërive tregtare aktive në raport me shoqëritë tregtare pasive ose papunësisë në lidhje me mesataren kombëtare dhe

- bashkësitë rurale jo të banuara ku numri i banorëve është më i vogël se 150 në pajtim me regjistrimin nacional të popullatës dhe të amviserisë në Republikën e Maqedonisë.

(5) Kriteret nga paragrafet (1), (2) dhe (4) të ketij neni më afërsisht i përcakton ministri dhe e shpall listen e mjediseve rurale dhe bashkësive rurale të Republikës së Maqedonisë, në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë. Një bashkësi rurale mund të kategorizohet në më tepër kategori në baze të paragrafit (4) të ketij neni.

(6) Nëse më shumë bashkësi rurale të cilat kufizohen ndërmjet veti dhe së bashku mund të formojnë një territor gjeografik me madhësi që nuk tejkalon 4% nga territori i përgjithshëm i Republikës së Maqedonisë karakterizohen më së paku në dy kategori nga paragrafi (4) i ketij neni, rajoni rural shpallet me ligj të posaçëm.

Zonat me mundësi të kufizuara për veprimtari bujqësore

Neni 64

(1) Zonat me mundësi të kufizuara për veprimtari bujqësore janë zona me jopershtatshmeri natyrore të cilat rrjedhin nga kushtet e pavolitshme klimatike, niveli i lartë i pjerrtësisë së tokës bujqësore, produktiviteti i ulet i truallit, ose për shkak të papershtatshmerive specifike që e zvogelojnë shfrytëzimin efikas të tokës bujqësore dhe kryerjen e veprimtarisë bujqësore.

(2) Në pajtim me llojin e papershtatshmerive nga paragrafi (1) i ketij neni, zonat me mundësi të kufizuara për veprimtari bujqësore ndahen në keto grupe:

- zonat malore,
- zonat me papershtatshmeri natyrore dhe
- zonat me papershtatshmeri specifike.

(3) Zonat malore të cilat ndodhen mbi 700 m lartësi mbidetare, ku papershtatshmerite natyrore janë shkaktuar nga kushtet e vecanta klimatike të lartësisë së madhe mbidetare dhe nga shkalla e lartë e pjerrtësisë së tokës.

(4) Zonat me papershtatshmeri natyrore janë zonat nën 700 m lartësi mbidetare, ku papershtatshmerite natyrore janë shkaktuar nga kushtet klimatike ose nga pjerrtësia e tokës bujqësore ose produktiviteti i ulet i tokës. Për zona me papershtatshmeri natyrore mund të konsiderohen edhe zonat erozive, zonat e nenshtuara me vërshime stinore dhe mocalet, kallamet dhe kenetat.

(5) Zonat me papershtatshmeri specifike janë bashkësitë rurale të pabanuara nga neni 63 i ketij ligji. Për zona me papershtatshmeri specifike konsiderohen zonat në të cilat kryerja e veprimtarisë bujqësore është e kufizuar në interes të mbrojtjes së mjedisit jetësor, natyrës dhe llojllojshmerisë biologjike në baze të ligjeve nga sfera e mbrojtjes dhe përparimit të mjedisit jetësor dhe natyrës.

(6) Zonat nga paragrafi (2), alinete 2 dhe 3 të ketij neni mund të definojnë me teresinë e tokës së përpunuar bujqësore të zonës së komunes. Zonat nga paragrafi (2) i ketij neni mund të definojnë me zonën e vendit të banuar.

(7) Toka bujqësore e ujitur nuk i përket kategorisë nga paragrafi (2), alinete 2 dhe 3 të ketij neni.

(8) Qeveria me propozim të ministrit i përcakton kriteret më të përafërta nga paragrafi (4) dhe paragrafi (5) i ketij neni për perkufizimin e zonave nga paragrafi (2), alinete 2 dhe 3 të ketij neni si dhe kushtet për përcaktimin e gjithë tokës bujqësore të përpunuar të zonës së komunes në kategoritë nga paragrafi (2), alinete 2 dhe 3 të ketij neni.

(9) Në baze të kritereve nga paragrafi (3) dhe (8) të ketij neni ministri shpall listen e rajoneve malore, zonave me papershtatshmeri natyrore dhe zonave me papershtatshmeri specifike në Republikën e Maqedonisë, në Gazeten zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

1. Zmadhimi i konkurrencës së prodhimitarise bujqesore

Politika për zmadhimin e konkurrencës së prodhimitarise bujqesore

Neni 65

(1) Politika për zmadhimin e konkurrencës së prodhimitarise bujqesore është e orientuar kah:

1) promovimi i njohurive dhe avancimi i potencialit të njeriut në mjediset rurale nepermjet ndihmes të dedikuar për:

- trajnim dhe informim të prodhuesve bujqesor,
- ndihme për bujqit e ri për nisme me veprimtari bujqesore,
- ndihme për lenien e veprimtarise bujqesore dhe
- sherbime keshilluese për zhvillimin e bujqesise;

2) restruktuirimi dhe zhvillimi i potencialit fizik dhe promovimi i praktikave inovative nepermjet mbeshtetjes të investimeve për:

- modernizimin e ekonomise bujqesore,
- rritjen e vleres ekonomike të pyjeve,
- perpunimin dhe marketingun e produkteve bujqesore dhe
- infrastrukturen e krijimit të parakushteve për zhvillimin e bujqesise dhe mbrojtjen nga papershtatshmerite natyrore dhe

3) permiresimi i kualitetit të produkteve bujqesore nepermjet mbeshtetjes të bashkimit ekonomik të ekonomise bujqesore për kryerjen e perbashket të -veprimtarise bujqesore për shkak të:

- zbatimit të praktikave të perbashketa prodhuese për harmonizimin me standardet e kualitetit të produktit bujqesor,
- prodhimit të produkteve bujqesore me kualitet më të larte,
- vendosjes së grupeve të prodhuesve dhe
- organizimit të aktiviteteve informative dhe perpunuese për produkte bujqesore.

Trajnimi dhe informimi i prodhuesve bujqesor

Neni 66

(1) Ndihma për trajnimin e prodhuesve bujqesore dedikohet për organizimin dhe mbajtjen e kurseve dhe sesioneve informative për perkryerjen dhe aftesimin e prodhuesve bujqesore vecanerisht për:

- 1) organizimin dhe udheheqjen e suksesshme të ekonomise bujqesore;
- 2) vendosjen e veprimtarive plotesuese në ekonomine bujqesore;
- 3) vendosjen dhe perdorimin e arritjeve teknologjike bashkekohore dhe praktikave inovative;
- 4) transferimin e njohurive për arritjen e rezultateve shkencore-hulumtuese;
- 5) shfrytezimin e teknologjise informative për prodhimitarine bujqesore;
- 6) zbatimin e standardeve të percaktuara në sferen e mbrojtjes së mjedisit jetesor, mbrojtjen dhe shendetin e njeriut, mbrojtjen dhe shendetin e bimeve, mbrojtjen e shendetit dhe mireqenien e kafsheve dhe zbatimin e praktikës higjienike;
- 7) zbatimin e masave për mbeshtetjen e realizimit të praktikave prodhuese bujqesore për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetesor dhe zonave rurale;
- 8) futjen e prodhimitarise bujqesore me zbatimin e standardeve për kualitet më të larte.

(2) Kurset të cilat janë lende e mbështetjes nga paragrafi (1) i këtij neni doemos duhet të jenë me kohezgjatje minimum prej 40 orë mesimore, por jo më shumë se 200 orë mesimore me cast një orë mesimore është me kohezgjatje prej 45 minutash. Kurset doemos duhet të përbehen nga pjesa teorike dhe praktike nga e cila pjesa praktike duhet të përbejë së paku 30% nga kohezgjatja e kursit.

(3) Ndiqma nga paragrafi (1) i këtij neni nuk është e dedikuar për kurset të cilat financohen në kuader të arsimit të rregullt dhe të cilat nuk dedikohen për bujqësi dhe pylltari.

(4) Mbeshtetja për informimin e prodhuesve bujqësorë është e dedikuar për organizimin dhe mbajtjen e sesioneve informative nepermjet seminareve, ligjeratave dhe punetorive për bartjen e njohurive nga njera prej sferave nga paragrafi (1) i këtij neni. Sekionet informative duhet të jenë me kohezgjatje minimum prej 6 orësh, por jo më shumë se 18 orë. Sesionet informative të cilat realizohen me perseritje në më shumë vende të banuara nuk guxojnë të tejkalojnë kohezgjatjen prej 500 oreve.

(5) Shfrytëzuesit e mbështetjes janë prodhuesit bujqësor të ekonomisë bujqësore të regjistruar në RUEB.

(6) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet nepermjet institucioneve publike nga sfera e shërbimeve keshilldhënëse dhe nga sfera e arsimit dhe punës shkencore-hulumtuese për bujqësi dhe pylltari dhe persona të tjerë juridike të cilët kryejnë veprimtari joekonomike nga sfera e shërbimeve konsultative, arsimore ose informative.

(7) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i këtij neni ndahet në lartësi deri më 100% nga vlera e shpenzimeve të pranueshme për përpunimin dhe botimin e programeve, materialeve arsimore, broshurave për sesionet informative, shpenzimet për organizimin dhe realizimin e kurseve ose sesioneve informative, kompensim për ligjeruesit dhe kompensim për shpenzimet ditore dhe rrugore të pjesëmarrësve.

(8) Vlera e përgjithshme e shpenzimeve të pranueshme definohet në pajtim me numrin e nxenesve të planifikuar në kurse ose në sesionet informative dhe paguhet me realizimin e pjesëmarrësve ose të teresishëm të kurseve ose të sesioneve informative në baze të numrit real të pjesëmarrësve.

(9) Llojet e aktiviteteve që janë lende e mbështetjes, kushtet për financim, përcaktimin e shfrytëzuesve, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për dhenien e mbështetjes, pasqyren e hollesishme të shpenzimeve të pranueshme dhe menyrën dhe rregullat për identitetin vizual të aktiviteteve i përcakton ministri.

(10) Menyrën e realizimit të mbështetjes nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton drejtori i Agjencisë me mendimin pozitiv të marrë nga Ministria.

Nisma me veprimtari bujqësore

Neni 67

(1) Ndiqma për nismën me veprimtari bujqësorë i ndahet bujkut të ri i cili për herë të parë fillon të merret me veprimtari bujqësorë nepermjet ndermarrjes së ekonomisë bujqësore ekzistuese ose me vendosjen e ekonomisë së re bujqësore.

(2) Kushtet për realizimin e mbështetjes nga paragrafi (1) i këtij neni janë:

- kërkesa për mbështetjen të jetë dorezuar jo më vonë se 18 muaj nga dita e regjistrimit të ndryshimit ose të ekonomisë së re bujqësore në RUEB nga neni 15 i këtij ligji,

- parashtruesi i kërkesës të ketë minimum arsim të mesëm nga sfera e bujqësisë ose ka kaluar trajnim për fitimin e kualifikimit për veprimtari bujqësorë përveç në rast kur plani afarist parashihet nevoja për trajnim,

- parashtruesi i kërkesës të jetë bartës i ekonomisë bujqësore dhe

- parashtruesi i kërkesës t'i respektojë praktikën e mira bujqësore dhe masat për mbrojtjen e natyrës dhe mireqenien e kafsheve.

(3) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i ketij neni realizohet me miratimin e planit afarist nga ana e Agjencise i cili duhet të parashoh aktivite investuese për modernizimin e ekonomise bujqesore në periudhe më së shumti prej 3 vjetesh nga dita e miratimit të mbeshtetjes.

(4) Plani afarist nga paragrafi (3) i ketij neni detyrimisht i permban keto elemente:

- pasqyren e kontrollit të gjendjes së ekonomise bujqesore,
- qellimin e zhvillimit dhe planin e zhvillimit të ekonomise bujqesore në suaze kohore për realizim në afate në periudhe jo më të gjate se tre vjet dhe
- planin e hollesishem të investimeve të domosdoshme, trajnim, nevoja për sherbime keshilledhenese dhe aktiviteve tjera për trajnimin dhe zhvillimin e ekonomise bujqesore.

(5) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i ketij neni ndahet në lartesi prej 600 000 denare për periudhen e realizimit të planit afarist dhe paguhet në nivel vjetor më së shumti në tre keste.

(6) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i ketij neni kushtezohet me plotesim të detyrueshem të aktiviteve të parapara me planin afarist nga paragrafi (4) i ketij neni.

Leshimi i kryerjes së veprimtarise bujqesore

Neni 68

(1) Mbeshtetja për leshimin e kryerjes së veprimtarise bujqesore dedikohet për nxitjen e ndryshimit të strukturave, perkatesisht gjeneratave në ekonomine bujqesore.

(2) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i ketij neni i ndahet bartesit të ekonomise familjare bujqesore i cili e leshon veprimtarine bujqesore me bartjen e të drejtes pronesore prodhuesit tjetër bujqesor dhe nese i ploteson keto kushte:

- ka statusin e të siguruarit - bujk individual,
- eshte me moshe prej 55 deri 63 vjet në ditën e parashtrimit të kerkeses për mbeshtetje,
- eshte marre me veprimtari bujqesore së paku dhjete vite para bartjes së pronesise dhe
- t'i leshoje të gjitha llojet e prodhimtarise bujqesore.

(3) Bartja e të drejtes së pronesise të ekonomise bujqesore nga paragrafi (2) i ketij neni nenkupton shitje të prones totale të ekonomise bujqesore në ekonomi tjetër bujqesore.

(4) Bartesi i ekonomise bujqesore i cili e ndermerr pronesine mbi ekonomine bujqesore duhet të:

- jete bujk i ri ose person juridik i cili me kete ndermarrje e zmadhon pronesine bujqesore të ekonomise bujqesore ekzistuese,
- obligohet se do ta perpunoje pronen bujqesore së paku pese vite dhe i njejti duhet të posedoje shkathtesi pune dhe kompetence për udheheqje të ekonomise,
- të jete marre me veprimtari bujqesore së paku pese vite para se të ndermarre pronesine dhe
- ndermerr të drejten e pronesise së ekonomise bujqesore me pronen gjithepershiresë bujqesore me veper juridike.

(5) Ekonomia bujqesore nga paragrafi (4) i ketij neni e cila eshte lende e bartjes të së drejtes pronesore eshte së paku me madhesine si vijon:

- toke bujqesore prej të gjitha kategorive të shfrytezimit me madhesi së paku prej 1,8 ha ose
- bageti, dhe atë së paku shtate lope ose 150 dhen ose 50 dhi.

(6) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i ketij neni jepet në lartesi prej 180 000 denaresh në nivel vjetor deri në plotesimin e kushteve për pension të moshes, por jo më shume se pese vite.

(7) Shfrytezuesi i mbeshtetjes nga paragrafi (1) i ketij neni nuk ka të drejte të realizoje mbeshtetje tjetër të parashikuar në perputhje me kete ligj dhe pas skadimit të afatit nga paragrafi (6) i ketij neni.

Sherbimet keshilledhenese për zhvillimin e bujqesise

Neni 69

(1) Mbeshtetja për sherbime keshilledhenese ndahet për:

- vendosjen e sistemit të sherbimeve keshilledhenese dhe

- shfrytezimin e sherbimeve keshilledhenese të ekonomive bujqesore.

(2) Shfrytezues të mbeshtetjes nga paragrafi (1), alineja 1 e ketij neni jane:

- institucionet publike nga fusha e arsimit dhe punes shkencore-hulumtuese për bujqesi dhe pylltari,

- shoqatat nacionale të prodhuesve bujqesor dhe pronareve privat të pyjeve dhe

- personat juridike të themeluar për kryerjen e veprimtarise nga sfera e sherbimeve keshilledhenese në bujqesi dhe pylltari.

(3) Mbeshtetja nga paragrafi (1), alineja 1 e ketij neni eshte e dedikuar për themelimin e personave juridike për kryerje të veprimtarise joekonomike nga fusha e sherbimeve keshilledhenese, konsultative dhe informative në bujqesi dhe pylltari dhe arritje të kualifikimeve adekuate të potencialit kadrovik, kapaciteteve administrative dhe teknike për kryerjen e sherbimeve, me perjashtim të investimeve në mjete themelore.

(4) Mbeshtetja nga paragrafi (1), alineja 1 e ketij neni ndahet në baze të planit të dorezuar afarist i cili eshte miratuar nga Ministria. Mbeshtetja paguhet nga viti i pare i themelimit në lartesi deri 80% për mbulim të shpenzimeve të pranueshme nga paragrafi (3) i ketij neni dhe zvogelohet në nivel vjetor së paku për 5% nga viti i kaluar, në periudhe jo më të gjate se gjashte vite prej dites së themelimit të shfrytezuesit nga paragrafi (2) i ketij neni.

(5) Vlera e pergjithshme e shpenzimeve të pranueshme perkufizohet në perputhje me numrin e planifikuar të shfrytezuesve të sherbimeve keshilledhenese dhe paguhet në nivel vjetor në baze të numrit real të shfrytezuesve të sherbimeve keshilledhenese.

(6) Shfrytezuesit e mbeshtetjes nga paragrafi (1), alineja 1 e ketij neni detyrimisht duhet të merren me veprimtarine për të cilen shfrytezon mbeshtetje në periudhe së paku prej pese vitesh nga pagimi i fundit i mbeshtetjes.

(7) Ministria mban evidencen e ofruesve të sherbimeve keshilledhenese.

(8) Menyren e regjistrimit të ofruesve të sherbimeve keshilledhenese në evidence dhe dokumentacionin e nevojshem për regjistrim në evidence si dhe menyren e mbajtjes së evidences nga paragrafi (7) i ketij neni i percakton ministri.

(9) Mbeshtetja nga paragrafi (1), alineja 2 e ketij neni eshte e dedikuar për bartesit e ekonomive bujqesore të cilet shfrytezojne sherbime keshilledhenese vecanerisht nga fushat si vijon:

1) organizim dhe menaxhim teknologjik dhe ekonomik i ekonomise bujqesore;

2) aplikim i praktikave bujqesore për mbrojtje të mjedisit jetesor;

3) ndihme gjate perpunimit të planeve afariste të ekonomive bujqesore;

4) ndihme gjate realizimit të masave për politike bujqesore dhe politike për zhvillim rural;

5) ndihme gjate bashkimit ekonomik të ekonomive bujqesore dhe keshillimit të vazhdueshem për menaxhim dhe organizim për aplikim të praktikave të perbashketa prodhuese dhe shfrytezim efikas të mjeteve që jane në dispozicion për pune;

6) njoftim dhe ndihme në aplikim të rregullatives ligjore nga fusha e bujqesise dhe rregulla të lidhura.

(10) Shfrytezues të ndihmes nga paragrafi (1), alineja 2 e ketij neni jane ekonomite bujqesore të cilat kane shfrytezuar sherbime keshilledhenese nga ofruesit e sherbimeve keshilledhenese të evidentuar në evidencen nga paragrafi (7) i ketij neni.

(11) Mbeshtetja nga paragrafi (1), alineja 2 e ketij neni eshte në lartesi deri në 80% prej shpenzimeve të pranueshme dhe të realizuara, por jo më shume se 70 000 për shfrytezues në nivel vjetor.

(12) Sherbimet keshilledhenese të cilat zbatohen nepermjet Agjencise për Nxitje të Zhvillimit të Bujqesise nuk do të jene lende e mbeshtetjes nga paragrafi (1) i ketij neni.

(13) Llojin dhe shtrirjen e aktiviteteve të cilat jane lende e mbeshtetjes, kushtet për financim, perkufizim të shfrytezuesve, kushtet e pergjithshme dhe të vecanta për ndarje të mbeshtetjes, shqyrtim të hollesishem të shpenzimeve të pranueshme, menyren dhe rregullat për identitet vizual të aktiviteteve i percakton ministri.

(14) Qeveria në propozim të ministrit miraton program vjetor për shërbime keshilledhenese me çka perkufizohet lloji dhe shtrirja e shërbimeve keshilledhenese të cilat zbatohen nepermjet Agjencise për Nxitje të Zhvillimit të Bujqesise në perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe mjetet financiare për zbatimin e tij.

(15) Pagimin e mjeteve për realizim të programit vjetor për shërbime keshilledhenese të Agjencise për nxitje të zhvillimit të bujqesise e kryen Agjencia pas raportit të miratuar dhe të derguar për aktivitete të realizuara të programit nga paragrafi (14) i ketij neni nga ana e Ministrise.

Investimet për modernizim të ekonomive bujqesore

Neni 70

(1) Mbeshtetja për investime për modernizim të ekonomive bujqesore realizohet nepermjet avancimit të potencialit fizik të ekonomise bujqesore për:

- permiresim të rezultateve të pergjithshme nga puna e ekonomise bujqesore dhe
- arritje të standardeve më të larta nga standardet minimale të percaktuar me ligjet nga fusha e bujqesise ose standarde të reja të instaluara nga fusha e bujqesise.

(2) Investimet nga paragrafi (1), alineja 1 e ketij neni jane dedikuar për rritje të efikasitetit të prodhimit nepermjet shpenzimeve të zvogeluara për prodhim bujqesor dhe permiresim të cilesise së prodhimit bujqesor. Potenciali fizik i ekonomise bujqesore e perfshin pronen e pergjithshme bujqesore.

(3) Investimet nga paragrafi (1), alineja 2 e ketij neni jane dedikuar për arritje të standardeve më të larta nga standardet minimale të percaktuara me ligj, ose për arritje të standardeve të reja të vendosura në perputhje me ligjin dhe atë vetem për ato investime të cilat konsiderohen si investime plotesuese për arritje të standardeve minimale dhe nuk kontribuojne në rritjen e sasise prodhuese.

(4) Standardet nga paragrafi (3) i ketij neni kane të bejne me mbrojtje dhe avancim të mjedisit jetesor, permiresim të kushteve higjienike dhe mireqenies së kafsheve të ekonomise bujqesore, shendet dhe mbrojtje të bimeve, shendetesi publike, mbrojtje gjate punes dhe standarde tjera të lidhura me investimin.

(5) Shfrytezues të mbeshtetjes nga paragrafi (1) i ketij neni jane ekonomite bujqesore të regjistruara në RUEB.

(6) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i ketij neni realizohet nepermjet të planit të miratuar afarist i cili parashikon aktivitete investuese për avancimin e potencialit fizik të ekonomise bujqesore për permiresimin e rezultateve të pergjithshme të punes së ekonomise bujqesore ose arritje të standardeve minimale të percaktuara me ligj dhe për periudhe së paku prej gjashte vitesh duke perfshire edhe rezultatet nga puna e ekonomise bujqesore nga viti rrjedhes.

(7) Plani afarist për avancim të potencialit fizik të ekonomise bujqesore për arritjen e standardeve të reja të vendosura për prodhim bujqesor dhe cilesi të produkteve bujqesore hartohet në periudhe prej tre vitesh më së shumti prej dites së vendosjes së standardit të percaktuar me rregullen adekuate, perderisa ndryshe nuk eshte percaktuar me ligjet ku jane rregulluar keto standarde.

(8) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i ketij neni nuk u ndahet ekonomive bujqesore në të cilat bartes eshte personi juridik i cili shfrytazon ndihme për shpetim dhe rikonstruktim në perputhje me Ligjin për ndihme shteterore.

(9) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i ketij neni nuk ndahet për:

- furnizim të të drejtave prodhuese, kafsheve dhe bimeve njevjecare,
- pajisje për mbjellje të bimeve njevjecare,
- pajisje për tharje dhe
- pajisje për ujitje, pervec në rast se investimi nuk mundeson kursim në shfrytezimin e ujit.

(10) Lartesia e mbeshtetjes nga paragrafi (1) i ketij neni eshte 50% nga shpenzimet e pranueshme dhe të kryera për realizim të investimit nga paragrafi (1) i ketij neni.

(11) Shuma më e larte e mbeshtetjes për shfrytëzues individual eshte më së shumti 30 000 000 denare në periudhe prej tre viteve nga viti i pageses së mjeteve për mbeshtetje nga paragrafi (1) i ketij neni.

(12) Me perjashtim nga paragrafi (11) i ketij neni, nese shfrytëzuesi eshte me seli në zone me mundesi të kufizuara për prodhim bujqësor, shuma më e larte e mbeshtetjes eshte më së shumti 45 000 000 në periudhe prej tre vitesh nga viti i pageses së mjeteve për mbeshtetje nga paragrafi (1) i ketij neni.

Investimet për rritje të vleres ekonomike të pyjeve

Neni 71

(1) Mbeshtetja për investime për rritjen e vleres ekonomike për pyjet ndahet për:

- ekonomizim të qendrushem me pyjet,
- perpunim primar të mases së drurit dhe perpunim të biomases së pyjeve dhe
- riprodhim të fidaneve pyjore.

(2) Mbeshtetja nga paragrafi (1) i ketij neni nuk ka të beje me investime për ripërteritje të fondit pyjor.

(3) Shfrytëzuesit e mbeshtetjes nga paragrafi (1), alineja 1 e ketij neni jane pronare private të pyjeve dhe/ose shoqata të pronareve private të pyjeve.

(4) Shfrytëzuesit e mbeshtetjes nga paragrafi (1), alineja 2 e ketij neni jane mikrondermarrje të cilat merren me perpunim të mases së drurit dhe biomases.

(5) Shfrytëzuesit e mbeshtetjes nga paragrafi (1), alineja 3 e ketij neni jane persona juridike të regjistruar për prodhim të fidaneve pyjor në perputhje me ligj.

(6) Mbeshtetja nga paragrafi (1), alineja 1 e ketij neni ndahet në perputhje me planin e hartuar dhe të miratuar për ekonomizim me pyjet, në perputhje me Ligjin për pyje.

(7) Lartesia e mbeshtetjes për investimet nga paragrafi (1) i ketij neni nuk mund të tejkaloje 50% të vleres së investimeve të pranueshme.

Investimet për riperpunim dhe marketing të produkteve bujqësore

Neni 72

(1) Mbeshtetja për investime për riperpunim dhe marketing të produkteve bujqësore eshte mbeshtetje e dedikuar për:

- permiresimin e rezultateve të pergjithshme nga puna e kapaciteteve të riperpunimit,
- zhvillimin e produkteve të reja dhe dizajnit, proceseve dhe teknologjive prodhuese për riperpunim si dhe investimet jomateriale për aktivitete pergatitese para se të shfrytëzohen produktet, proceset ose teknologjite e reja të zhvilluara për qellime tregtare dhe
- investimet në infrastrukturen tregtare për aktivitete pas vjelese ose aktivitetet për mbledhje dhe ruajtje të produkteve primare bujqësore për dedikimin e tyre të metejshem.

(2) Të drejten e mbeshtetjes nga paragrafi (1) i ketij neni e kane shoqatat tregtare dhe kooperativat të cilat i plotesojne kushtet për kryerjen e veprimtarise në perputhje me ligjin. Mbeshtetja nga paragrafi (1), alineja 3 e ketij neni mund të dedikohet për investime publike nga ana e subjekteve shteterore, partneritet publik privat ose njesi të vetadministrimit lokal.

(3) Lartesia e mbeshtetjes nga paragrafi (1) i ketij neni nuk mund të tejkaloje 50% të vleres së shpenzimeve të pranueshme dhe të kryera, pervec kur eshte e dedikuar për investime publike, kur lartesine e mbeshtetjes e percakton Qeveria.

(4) Me perjashtim nga paragrafi (3) i ketij neni, në rast kur shfrytëzues i ndihmes eshte ndermarrje e madhe, lartesia e mbeshtetjes nga paragrafi (1) i ketij neni nuk mund të tejkaloje 25% nga vlera e shpenzimeve të pranueshme dhe të kryera.

(5) Përvec mbështetjes nga paragrafi (1) i këtij neni, mbështetja mund të jepet edhe për investime në perpunimin dhe marketingun e produkteve bujqesore për arritje të standardeve më të larta nga standardet minimale të përcaktuara me ligj, ose për arritjen e standardeve të reja të vendosura në përputhje me ligjin, vetëm për mikro ndermarrje dhe ndermarrje të vogla apo mesatare në periudhe jo më të gjata se tre vite prej ditës së vendosjes së standardit me ligj.

(6) Mbështetja nga paragrafi (1) i këtij neni nuk ka të bëjë me peshq ose produkte të peshqve dhe frytet dhe produktet pyjore.

(7) Mbështetja nga paragrafi (1) i këtij neni nuk u ndahet personave juridike të cilet shfrytëzojnë ndihme për shpëtim dhe rikonstruktiv në përputhje me Ligjin për ndihme shtetërore.

Investimet në infrastrukturen për zhvillim të bujqesise, pylltarise dhe ekonomise së ujerave

Neni 73

(1) Mbështetja për investime në infrastrukture për krijimin e parakushteve për zhvillimin e bujqesise është e dedikuar për infrastrukture për qasje në token bujqesore dhe pyjet, konsolidimin e tokës bujqesore dhe permiresimin e tokës bujqesore, mbrojtjen e prodhimit bujqesor të demtuar nga katastrofat natyrore, furnizimin me energji elektrike dhe me ujë si dhe për ekonomine e ujerave.

(2) Të drejte për mbështetjen nga paragrafi (1) i këtij neni kanë ekonomite bujqesore, subjektet, njesite e vetadministrimit lokal, ndermarrjet e ekonomise së ujerave dhe bashkesive ujore.

(3) Lartesia e mbështetjes për investime joproduktive është deri në 100% nga shuma e shpenzimeve të pranueshme për aktivitete nga paragrafi (1) i këtij neni.

Bashkimi ekonomik i ekonomive bujqesore për kryerje të perbashket të veprimtarise bujqesore

Neni 74

(1) Në drejtim të realizimit të qellimeve dhe politikave nga ky ligj, ekonomite bujqesore në menyre vullnetare mund të bashkohen për shkak të realizimit të interesave ekonomike.

(2) Bashkimi për shkak të interesit ekonomik të ekonomive bujqesore duhet të jetë në drejtim të realizimit të qellimeve si vijon:

- rritje të efikasitetit të prodhimit bujqesor nepermjet të optimizimit të shpenzimeve prodhuese dhe furnizimit të perbashket ose prodhimit të materialeve për prodhim,

- permiresim të pozites tregtare të ekonomive bujqesore me instalimin e operacioneve të perbashketa për magazinim dhe marketing të produkteve bujqesore ose riperpunim, finalizim dhe shperndarje të produkteve bujqesore dhe

- instalim të aplikimit të perbashket të standardeve më të larta për cilesi të produkteve bujqesore.

(3) Mbështetja për bashkim ekonomik të ekonomive bujqesore për kryerjen e perbashket të veprimtarise bujqesore është e dedikuar për:

- ndihme për vendosje të formave organizative të bashkimit ekonomik të ekonomive bujqesore,

- investime për aplikim të praktikave të perbashketa prodhuese për harmonizim të standardeve për cilesi të produkteve bujqesore ose për prodhim të produkteve bujqesore me cilesi më të larte;

- vendosje të grupeve të prodhuesve dhe

- ndihme për organizim të aktiviteteve informative dhe promovuese për produktet bujqesore.

(4) Në pajtim me qellimet nga paragrafi (2) i këtij neni format organizative për bashkimin ekonomik të ekonomive bujqesore janë si vijon:

- kooperative ose person juridik me veprimtari kryesisht nga sfera e bujqesise dhe e themeluar nga bartes të ekonomive bujqesore të regjistruara në RUEB,

- kooperative ose person juridik me veprimtari kryesisht nga sfera e bujqesise dhe e themeluar nga bartes të ekonomive bujqesore të regjistruara në RUEB dhe kapacitete riperpunimi për riperpunim të produkteve ushqimore-bujqesore dhe

- person juridik nga sfera e bujqesise i formuar në shoqate të prodhuesve bujqesore.

(5) Ndhima nga paragrafi (3), alineja 1 e ketij neni e dedikuar për shpenzime për themelim të formes organizative nga paragrafi (4) i ketij neni, vendosje të kapaciteteve administrative dhe teknike, angazhim të personave profesionale për menaxhim me formen organizative, arritje të kualifikimeve adekuate të potencialit kuadrovik, me perjashtim të investimeve në mjete themelore.

(6) Lartesia e ndihmes nga paragrafi (4) i ketij neni nuk mund të tejkalojë 80% nga shpenzimet e pranueshme të pergjithshme për vitin e pare të themelimit. Mbeshtetja zvogelohet me shkalle të reduktimit prej 20% për çdo vit të ardhshem prej vitit të themelimit për periudhe jo më të gjate se pese vite.

(7) Mbeshtetja nga paragrafi (3), alineja 2 e ketij neni i ndahet formes organizative nga paragrafi (4) i ketij neni për investime, avancim të potencialit fizik të ekonomise bujqesore të cilet e kane themeluar formen organizative.

(8) Kushtet për dhenien e mbeshtetjes nga paragrafi (6) i ketij neni jane:

- zbatimi i metodave të vetme prodhuese me të cilat garantohet harmonizimi i procesit prodhues me kerkesat në pajtim me standardet e kualitetit,

- kryerja e perbashket e veprimtarise prodhuese të ekonomise bujqesore për zbatimin e standardeve të kualitetit bazohet në specifiken e produktit e cila eshte e verifikuar nga trupi i pavarur kompetent,

- produkti bujqesor i prodhuar në pajtim me standardin e kualitetit, të jete i dedikuar për konsum perfundimtar,

- standardi i zbatuar për kualitet eshte i hapur për të gjithë dhe siguron percjellje të produkteve dhe

- standardi i zbatuar për kualitet eshte në pajtim me kerkesat e tregut dhe me mundesite e tregut.

(9) Mbeshtetja nga paragrafi (6) i ketij neni ndahet në baze të planit afarist të miratuar në formen organizative me të cilin parashihen aktivitetet e investimeve për avancimin e potencialit fizik të themeluesve të ekonomise bujqesore në periudhe së paku prej pese vitesh duke perfshire edhe rezultatet nga puna e ekonomise bujqesore të vitit rrjedhes.

(10) Mbeshtetja nga paragrafi (6) i ketij neni ka të beje edhe për investimet e magazinimit, perpunimin dhe marketingun e produktit bujqesor në kuader të kapacitetit prodhues të themeluesve të formes organizative.

(11) Nese forma organizative eshte e themeluar për prodhimin e produkteve bujqesore me kualitet më të larte plani afarist duhet të parashikojë aktivite investuese për arritjen dhe zbatimin e standardeve më të larta të kualitetit nga paragrafi (12) i ketij neni dhe si të tilla të njihen në pajtim me kete ose tjeter ligj.

(12) Produktet bujqesore me kualitet më të larte jane produktet të cilat jane prodhuar me zbatimin e ketyre standardeve për:

- prodhim organik,

- vecori të garantuar tradicionale,

- mbrojtje të emrit gjeografik dhe etiketes së prejardhjes dhe

- vere me prejardhje gjeografike

(13) Ndhima nga paragrafi (3), alineja 4 ndahet për aktivite informative dhe promovuese të produkteve bujqesore të cilat i prodhon forma organizative nga paragrafi (4) i ketij neni dhe ka të beje me shpenzimet për panairë, manifestime, kampanja promovotive dhe shpenzimet tjera për organizimin e aktiviteve promovuese dhe informative.

Grupet e prodhuesve

Neni 75

(1) Perkraja për grupe prodhuesish është e dedikuar për vendosjen dhe punën e grupeve të prodhuesve.

(2) Perkraja nga paragrafi (1) i këtij neni i dedikohet investimeve për:

- adaptim të teknikave prodhuese dhe produkteve bujqesore të prodhuara nga ekonomite bujqesore anetare të grupeve të prodhuesve të nevojave të tregut,

- plasim të perbashket të produkteve bujqesore në treg duke përfshirë shitje dhe grumbullim me shumice dhe

- vendosje të rregullave për plasimin e informatave të perbashketa për shtrirje të prodhimit dhe periudhe kohore të vjeljes së produkteve bujqesore.

(3) Perkraja nga paragrafi (1) i këtij neni ndahet në baze të planit të lejuar për pranimin e grupit të prodhuesve, për periudhe jo më shumë se pesë vite nga dita e pranimin të grupit të prodhuesve.

(4) Perkraja paguhet në nivel vjetor si përqindje e vlerës së prodhimitarise vjetore të shitur dhe atë:

a) për vlerën e prodhimit të shitur vjetor në lartësi jo më shumë se 30 000 000 denare:

- 5% nga vlera e prodhimit të shitur vjetor për vitin e parë,

- 5% nga vlera e prodhimit të shitur vjetor për vitin e dytë,

- 4% nga vlera e prodhimit të shitur vjetor për vitin e tretë,

- 3% nga vlera e prodhimit të shitur vjetor për vitin e katërt dhe

- 2% nga vlera e prodhimit të shitur vjetor për vitin e pestë.

b) për vlerë të prodhimit të shitur vjetor në lartësi mbi 30 000 000 denare:

- 2,5% nga vlera e prodhimit të shitur vjetor për vitin e parë, por jo më shumë se 3 000 000 denare,

- 2,5% nga vlera e prodhimit të shitur vjetor për vitin e dytë, por jo më shumë se 3 000 000 denare,

- 2% nga vlera e prodhimit të shitur vjetor për vitin e tretë, por jo më shumë se 2 000 000 denare,

- 1,5% nga vlera e prodhimit të shitur vjetor për vitin e katërt, por jo më shumë se 1 500 000 denare dhe

- 1,5% nga vlera e prodhimit të shitur vjetor për vitin e pestë, por jo më shumë se 1 500 000 denare.

(5) Ndiqja nga paragrafi (4) ndahet në baze të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Agjencisë dhe personit përgjegjës të grupit të prodhuesve. Menyrën dhe procedurën për zbatimin e ndiqjes nga paragrafi (4) i këtij neni e përcakton drejtori i Agjencisë me mendimin pozitiv paraprak të ministrit.

2. Masat për Avancimin e mjedisit jetësor dhe zonave rurale

Nxitja e veprimtarise bujqesore për zhvillimin e mjedisit jetësor dhe zonave rurale

Neni 76

(1) Politika për nxitje të veprimtarise bujqesore e dobishme për mjedisin jetësor dhe rajonet rurale është e orientuar kah promovimi i praktikave bujqesore prodhuese për përdorim të qëndrueshëm të tokës bujqesore, mbrojtje dhe përpunim të mjedisit jetësor dhe rajoneve rurale me qëllim të ruajtjes së llojllojshmerise bimëre dhe shtazore dhe përpunimin e trullit, ujit dhe ajrit.

(2) Politika për nxitje të veprimtarise bujqesore e dobishme për mjedisin jetësor dhe rajonet rurale zbatohet nëpërmjet masave grupore të orientuara kah:

- 1) perdorimi i qendrueshem i tokes bujqesore nepermjet masave për ndihme për:
 - kryerje të veprimtarise bujqesore në zonat me mundesi të kufizuara për veprimtari bujqesore,
 - kryerje të veprimtarise bujqesore për mbrojtjen dhe perparimin e mjedisit jetesor dhe
 - arrijte të standardeve për mireqenien e kafsheve.
- 2) perdorimi i qendrueshem i tokes pyjore nepermjet masave për ndihme të:
 - pyllzimit të pare të tokes bujqesore dhe tokes jobujqesore,
 - kultivimit të pyjeve me zbatimin e standardeve më të larta për mbrojtje të mjedisit jetesor dhe
 - ripërteritjes së pyjeve dhe marrjes së masave për mbrojtje të pyjeve.

Ndihma për kryerjen e veprimtarise bujqesore në zonat me mundesi të kufizuara për veprimtari bujqesore

Neni 77

(1) Ndihma për kryerje të veprimtarise bujqesore në zonat me mundesi të kufizuara për veprimtari bujqesore u ndahet ekonomive bujqesore për kryerje të prodhimtarise bujqesore në zonat me mundesi të kufizuara për veprimtari bujqesore në forme të pagesave të drejtperdrejta për perkrahje të të hyrave të ekonomive bujqesore.

(2) Pagesat e drejtperdrejta u paguhen ekonomive bujqesore në forme të pagesave vjetore për siperfaqe të tokes së perpunuar bujqesore.

(3) Lartesia e pagesave të drejtperdrejta nga paragrafi (2) i ketij neni mund të percaktohet varesisht nga lloji i kultures, lloji, klasa dhe kualiteti i produktit bujqesor.

(4) Shuma maksimale e pagesave të drejtperdrejta për shfrytezues mund të kufizohet varesisht nga madhesia e siperfaqes së tokave të perpunuara bujqesore me të cilat disponon ekonomia bujqesore nga paragrafi (1) i ketij neni.

(5) Shuma e pergjithshme vjetore e pagesave të drejtperdrejta për kryerje të veprimtarise bujqesore në zonat me mundesi të kufizuara për veprimtari bujqesore nuk guxon të tejkaloje 30 000 denare për hektar të tokes së perpunuar bujqesore.

(6) Llojin e aktiviteteve të cilat jane objekt i perkrahjes, kushtet për financim, perkufizimin e shfrytezuesve, kushtet e pergjithshme dhe të vecanta për ndarje të perkrahjes dhe lartesine e pagesave të drejtperdrejta i percakton ministri.

(7) Menyren për realizim të perkrahjes nga paragrafi (2) i ketij neni e percakton drejtori i Agjencise pas marrjes së mendimit pozitiv nga Ministria.

(8) Me perjashtim, pagesat e drejtperdrejta nga paragrafi (1) i ketij neni mund të realizohen në forme të perkrahjes shtese financiare në lartesi deri më 15% për pagesat e drejtperdrejta për siperfaqe, koke bagetie apo njesi prodhimi për pronen bujqesore në rajonet me mundesi të kufizuara për prodhim.

Ndihma për kryerje të veprimtarise bujqesore për mbrojtjen dhe perparimin e mjedisit jetesor

Neni 78

(1) Ndihme për kryerje të veprimtarise bujqesore për mbrojtjen dhe perparimin e mjedisit jetesor ndahet për ndihme për:

- kryerjen e veprimtarise bujqesore në pajtim me parimet e praktikës së mire bujqesore dhe higjienike,
- ruajtjen e rajoneve rurale dhe karakteristikave të tyre tradicionale dhe
- ruajtjen e llojllojshmerise gjenetike të bimeve autoktone bujqesore dhe racave autoktone të kafsheve.

(2) Ndihma nga paragrafi (1), alineja 1 e ketij neni u ndahet ekonomive bujqesore bartesit e të cilave në baze vullnetare jane pajtuar që t'i zbatojne parimet e praktikës së mire bujqesore dhe higjienike në tere ekonomine bujqesore në periudhe prej pese deri më shtate vjet.

(3) Parimet e praktikës së mirë bujqësore dhe higjienike kryesisht i perkasin praktikave bujqësore prodhuese për mbrojtjen dhe perparimin e mjedisit jetesor. Për realizimin e ndihmes nga paragrafi (1), alineja 1 të këtij neni ministri shpall Kodeks për praktikën e mirë bujqësore dhe higjienike dhe udhëheqes për arritjen e parimeve për praktike të mirë bujqësore dhe higjienike të ekonomive bujqësore në "Gazeten zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(4) Ndihma nga paragrafi (1), alineja 3 e këtij neni mund t'u ndahet ekonomive bujqësore në formë të pagesave të drejtperdrejta për sipërfaqe të tokës së perpunuar bujqësore në të cilën kultivohen dhe shumohen bimët autoktone bujqësore dhe për shtim të një koke bagëtie nga racat autoktone të kafsheve.

(5) Lartësia e pagesave të drejtperdrejta nga paragrafi (4) i këtij neni mund të dallojë varesisht nga llojet autoktone të bimeve bujqësore ose lloji i racave autoktone të kafshes dhe nga shkalla e rrezikshmerisë së tyre.

(6) Për realizimin e ndihmes nga paragrafi (1), alineja 3 të këtij neni, ministri shpall listen e bimeve autoktone bujqësore dhe racave autoktone të kafsheve në pajtim me rregullat nga sfera e mbrojtjes së mjedisit jetesor dhe llojllojshmerisë biologjike.

(7) Në bazë të listes, ministri e percakton menyren e ndjekjes dhe analizimit të gjendjeve me llojet autoktone të bimeve bujqësore dhe racave autoktone të kafsheve në bazë të shkallës së rrezikshmerisë së tyre dhe percakton masa shtese për ruajtjen, grumbullimin dhe ruajtjen e rezervave obliguese gjenetike dhe perdorimin e tyre për prodhimtari bujqësore.

(8) Aktivitetet për ndjekje dhe analizim të gjendjeve me bimët autoktone bujqësore dhe racat autoktone të kafshëve dhe ruajtje dhe sigurim të rezervave obliguese gjenetike janë sherbim publik që ministri mund të ndajë në pajtim me dispozitat nga ligji për koncesione.

(9) Ndalohet shfarosja e llojeve autoktone të bimeve bujqësore dhe racave autoktone të kafsheve.

(10) Llojin e aktiviteteve që janë lende e perkrahjes, kushtet për financim, perkufizimin e shfrytëzuesve, kushtet e pergjithshme dhe të vecanta për ndarje të perkrahjes dhe lartësinë e pagesave të drejtperdrejta i percakton ministri.

(11) Menyren dhe procedurën për realizim të perkrahjes nga paragrafi (1) i këtij neni e percakton drejtori i Agjencisë pas marrjes së mendimit pozitiv nga Ministria.

Ndihma për arritjen e standardeve më të larta për mireqenien e kafsheve

Neni 79

(1) Ndihme për arritjen e standardeve më të larta për mireqenien e kafsheve u ndahet ekonomive bujqësore bartesit e të cilave në bazë vullnetare janë pajtuar të zbatojnë standarde më të larta për mireqenien e kafsheve nga minimumi i standardeve të percaktuara në pajtim me ligjin për mireqenien e kafsheve për tere ekonomine bujqësore në periudhë prej pese deri më shtate vjet.

(2) Standardet më të larta për mireqenien e kafsheve vecanerisht kane të bejne me:

- dhenien ujë dhe të ushqyerit në sasi e cila u pergjigjet nevojave natyrore të kafsheve,
- kushtet për vendosjen e kafsheve të cilat parashikojne hapësire, grazhd për pertypje dhe drite natyrore,
- leshimin e rregullt jashte nga vendstrehimi,
- nuk praktikohen aktivitete për shkurtimin e pjeseve të kafshes (brinjet, bishti etj.), izolimin e kafshes dhe lidhjen e pehershme dhe
- mbrojtjen nga organizmat patogjene nepermjet praktikave higjienike dhe sigurimit të kushteve të mira.

(3) Ndihma nga paragrafi (1), alineja 2 e këtij neni mund t'u ndahet ekonomive bujqësore në formë të pagesave të drejtperdrejta për koke bagëtie nese arrihen kushtet nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Llojin e aktiviteteve që janë lende e perkrahjes, kushtet për financim, perkufizimin e shfrytëzuesve, kushtet e pergjithshme dhe të vecanta për ndarje të perkrahjes dhe lartësine e pagesave të drejtperdrejta i percakton ministri.

(5) Menyren për realizim të perkrahjes nga paragrafi (3) i ketij neni e percakton drejtori i Agjencise pas marrjes së mendimit pozitiv nga Ministria.

3. Permiresimi i kualitetit të jetes në mjediset rurale dhe nxitja e ndryshimit të aktiviteteve ekonomike

Masat për permiresimin e kualitetit të jetes në mjediset rurale

Neni 80

Grupi i masave për permiresim të kualitetit të jetes në mjediset rurale dhe nxitja e diverzifikimit të aktiviteteve ekonomike në mjediset rurale janë masa për perkrahje të:

- diverzifikimit të aktiviteteve ekonomike,
- permiresimit të kualitetit të jetes në mjediset rurale,
- perkrahjes për trajnim dhe informim të personave fizike dhe juridike të cilet kryejne veprimtari në rajonet rurale dhe
- perkrahjes për nxenie të diturive dhe aftesive për pergatitje dhe realizim të strategjive për zhvillim lokal të mjediseve rurale.

Diverzifikimi i aktiviteteve ekonomike

Neni 81

(1) Grupi i masave për diverzifikimin e aktiviteteve ekonomike janë masa për perkrahje të:

- diverzifikimit të aktiviteteve ekonomike të ekonomive bujqesore jashte veprimtarise bujqesore,
- perkrahjes për vendosje dhe zhvillim të mikro ndermarrjeve, nxitje të praktikave të reja dhe veprimtari të reja ekonomike në mjediset rurale dhe
- nxitjes së zhvillimit të turizimit rural.

(2) Perkrahja nga paragrafi (1), alinete 1 dhe 3 të ketij neni i ndahet bartesit të ekonomise bujqesore familjare ose anetareve të ekonomise bujqesore familjare të cilet kryejne veprimtari shtese në pajtim me kushtet e parashikuara me nenet 82, 83 dhe 84 të ketij ligji.

(3) Perkrahja nga paragrafi (1), alineja 2 e ketij neni eshte e dedikuar për kryerje të veprimtarise zejtare në rajonet rurale.

(4) Të drejte të perkrahjes nga paragrafi (1), alineja 2 e ketij neni kane personat fizike dhe juridike të cilet i plotesojne kushtet për kryerje të veprimtarise zejtare në pajtim me ligjin.

(5) Lartësia e perkrahjes nga paragrafi (1) i ketij neni eshte 50% nga shpenzimet e pranueshme.

Veprimtaria plotesuese

Neni 82

(1) Veprimtaria plotesuese e ekonomise familjare bujqesore eshte veprimtari e lidhur me bujqesine, perkatesisht pylltarine, që kryhet në pronen bujqesore dhe mundeson shfrytëzim më të mire të mundesive të saj prodhuese dhe forces punuese të anetareve të familjes.

(2) Llojet e veprimtarive të cilat mund të kryhen si veprimtari plotesuese të ekonomive bujqesore familjare dhe shtrirjen e tyre i percakton Qeveria.

(3) Gjate caktimit të shtrirjes nga paragrafi (2) i ketij neni merren parasysh edhe kushtet dhe karakteristikat specifike të llojeve të vecanta të veprimtarise plotesuese.

Ushtruesi i veprimtarise plotesuese te ekonomise familjare bujqesore

Neni 83

(1) Ushtruesi i veprimtarise plotesuese nga neni 82 i ketij ligji eshte personi fizik i cili eshte bartes i ekonomise bujqesore familjare ose anetar i ekonomise bujqesore familjare i cili e shfrytezon pronen bujqesore dhe kryen veprimtari bujqesore, i autorizuar nga bartesi i ekonomise bujqesore familjare.

(2) Ushtruesi i veprimtarise plotesuese nga paragrafi 1 i ketij neni duhet te jete i aftesuar ne menyre perkatese dhe te kete pajisje teknike perkatese per kryerje te veprimtarise plotesuese.

(3) Aftesimin profesional te ushtruesve te veprimtarise plotesuese dhe pajisjen teknike perkatese nga paragrafi (2) i ketij neni i percakton ministri.

Leja per kryerje te veprimtarise plotesuese te ekonomise bujqesore familjare

Neni 84

(1) Ministri leshon aktvendim per kryerje te veprimtarise plotesuese me kerkese paraprake te parashtruar nga personat nga neni 83, paragrafi (1) i ketij ligji.

(2) Ministria mban evidence per ushtruesit e veprimtarise plotesuese nga neni 83 i ketij ligji.

(3) Formen dhe permbajtjen e formularit te kerkeses per kryerje te veprimtarise plotesuese, dhe dokumentacionin e nevojshem per deshmimin e plotesimit te kushteve per kryerje te veprimtarise plotesuese dhe menyren e mbajtjes se evidences nga paragrafi (2) i ketij neni i percakton ministri.

Pushimi i kryerjes se veprimtarise plotesuese te ekonomise bujqesore familjare

Neni 85

Ministri leshon aktvendim per pushim te kryerjes se veprimtarise plotesuese me kerkese te ushtruesit apo ne rast kur ushtruesi ka pushuar t'i plotesoje kushtet nga neni 83, paragrafi (2) i ketij ligji.

Permiresimi i kualitetit te jetes ne mjediset rurale

Neni 86

Grupi i masave per permiresim te kualitetit te jetes ne mjediset rurale jane masa per perkrahje te:

- vendosjes dhe zhvillimit te infrastruktures teknike dhe te telekomunikacionit per personat fizike dhe juridike te cilet kryejne veprimtari ne zonat rurale dhe banoret e zonave rurale,
- rindertimit dhe zhvillimit te fshatrave dhe
- ruajtjes dhe perparimit te vlerave tradicionale ne zonat rurale.

Nxitja e zhvillimit lokal te mjediseve rurale

Neni 87

Nxitja e zhvillimit lokal te mjediseve rurale zbatohet nepermjet masave te parapara per perkrahje te:

- realizimit te strategjive per zhvillim lokal te mjediseve rurale qe parashikojne zbatim te masave ne pajtim me kete ligj,
- realizimit te strategjive per zhvillim rural te njesive te vetadministrimit lokal me seli ne mjedisin rural dhe
- punes se Grupit Lokal Akcionar (ne tekstin e metejshem: GLA) per zhvillim te mjediseve rurale dhe per perfshirjen e banoreve te territorit te GLA-se per zhvillim te mjediseve rurale.

Strategjite për zhvillim lokal të mjediseve rurale

Neni 88

(1) Strategjite për zhvillim lokal të mjediseve rurale që janë lende e perkrahjes duhet t'i plotesojne së paku kushtet në vijim:

- të jete e pergatitur nga ana e GLA-së për zhvillimin e mjediseve rurale,
- të permbajne masa dhe menyre të zbatimit të tyre në pajtim me kete ligj.
- të jete e miratuar nga Ministria.

(2) Permbajtjen dhe metodologjine për pergatitje të strategjive nga paragrafi (1) i ketij neni, si dhe menyren për miratimin e tyre i percakton ministri.

Grupi Lokal Akcionar

Neni 89

(1) Grupi Lokal Akcionar për zhvillimin e zonave rurale themelohet si shoqeri, kooperative ose shoqate tregtare e qytetareve ose fondacion i themeluar për një teresi territoriale në një ose në më teper mjedise rurale ku jetojne jo më pak se 5.000 banore dhe jo më teper se 100 000 banore.

(2) Grupi Lokal Akcionar për zhvillimin e zonave rurale themelohet nepermjet:

- bashkimit të dy ose më teper bashkesive rurale të cilat në menyre kadastrale kufizohen ndermjet vete,

- bashkimit të dy ose më teper komunave që janë të perkufizuara si mjedise rurale dhe në menyre kadastrale kufizohen ndermjet vete dhe

- partneritetit publik-privat ndermjet komunave, personave fizike dhe juridike ose shoqatave të qytetareve me seli në zonat e komunave.

(3) Një subjekt nuk mund të jete anetar i më teper se një GLA-je pervec në rast të subjekteve të cilat, në pajtim me ligjin me të cilin janë themeluar, kane filiale të regjistruara me seli në territorin për të cilin eshte e formuar GLA.

(4) Shoqatat e qytetareve për mbrojtje të mjedisit rural, prodhuesve bujqesore, të rinjve dhe grave në mjediset rurale duhet të jene të perfaqesuar së paku 50% në GLA për zhvillimin e mjediseve rurale nga paragrafi (2), alineja 3 e ketij neni.

(5) Statusi i GLA-së fitohet me regjistrim në evidencen e GLA-së që mbahet në Ministri.

(6) Kushtet më të peraferta nga paragrafi (1) i ketij neni për regjistrim, proceduren për regjistrim, dokumentacionin e nevojshem dhe menyren e mbajtjes së evidences nga paragrafi (5) i ketij neni më afersisht i percakton ministri.

Kushtet plotesuese dhe shpenzimet e pranueshme

Neni 90

(1) Shfrytezuesit e perkrahjes nga masat për zhvillim rural varesisht nga lloji i masave duhet të jene të kushtezuar edhe me disponimin me kapacitete prodhuese perkatese.

(2) Shpenzimet e pranueshme për masat për zhvillim rural nga paragrafi (1) i ketij neni perfshijne:

- ndertimin ose permiresimin e prones së patundshme, pervec objekteve të dedikuara për banim,

- furnizimin ose lizingun e mekanizimit dhe pajisjes, duke i perfshire edhe softverin kompjuterik, pervec shpenzimeve për tatim, profit të dhenesit të lizingut, kamatave për refinancim dhe sigurim dhe

- shpenzimet e pergjithshme për kompensime për arkitekthe, inxhiniere dhe konsultante, studime fizibilitete, analiza dhe furnizime të patentave dhe licencave.

(3) Kushtet më të peraferta nga paragrafi (1) i ketij neni, shpenzimet e pranueshme nga paragrafi (2) i ketij neni si dhe lartesine e perkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytezues për mase individuale i percakton ministri.

Kriteret për zgjedhje të shfrytëzuesve

Neni 91

(1) Zgjedhja e shfrytëzuesve sipas masave për zhvillim rural kryhet varesisht nga dedikimi i investimit, lloji i parashtresit, lartësia e investimit, mosha dhe gjinia e bartesit të ekonomisë bujqësore ose personi përgjegjës i subjektit, vendi i investimit.

(2) Kriteret më të peraferta nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton ministri.

Perkrahja financiare për zhvillim rural

Neni 92

(1) Masat për zhvillim rural zbatohen nepermjet mekanizmave të perkrahjes si vijon:

- ndihme e pakompensueshme financiare për investime dhe
- pagesa të drejtperdrejta për zhvillim rural.

(2) Ndihma e pakompensueshme financiare për investime është perkrahja në forme të bashkefinansimit të vlerës së investimeve të ndermarra dhe të realizuara në mjete themelore dhe infrastrukture të cilat çojnë në rritjen e potencialit fizik ose perparimin e kualitetit të prodhimitarise bujqësore dhe investime joprodhuese për zhvillim në mjediset rurale.

(3) Ndihma e pakompensueshme financiare nga paragrafi (1), alineja 1 të këtij neni mund të ndahet edhe për investime jomateriale në pajtim me programi nga neni 7, paragrafi (3) i këtij ligji.

(4) Pagesat e drejtperdrejta për zhvillim rural janë pagese me kompensim për perkrahje të të hyrave e realizuar nga veprimtaria bujqësore si kompensim i humbjeve që janë shkaktuar për shkak të mosshfrytëzimit të potencialit prodhues për zbatimin e praktikave bujqësore prodhuese për mbrojtje të mjedisit jetësor ose për shkak shpenzimeve të rritura për zbatim të standardeve më të larta për mbrojtje të mjedisit jetësor.

(5) Pagesat e drejtperdrejta për zhvillim rural realizohen në pajtim me dispozitat nga neni 47 i këtij ligji.

(6) Ndihma e pakompensueshme financiare për investime realizohet nepermjet marreveshjes, ndërsa pagesat e drejtperdrejta për zhvillim rural nga paragrafi (1), alineja 2 e këtij neni nepermjet marreveshjes ose deklarates.

VII. NDIHMA SHTETERORE NË BUJQESI

Ndihma shteterore në bujqesi

Neni 93

Ndihme shteterore në bujqesi është secila ndihme e ndare nga Qeveria, organet e administrates shteterore ose njesite e vetadministrimit lokal për prodhimitari, perpunim dhe shitje të produkteve të caktuara bujqësore ose për kryerjen e shërbimeve të caktuara nga zona e bujqësisë, me të cilën mundësohet perkrahje plotësuese për subjekte të përcaktuara për perkrahjen e mundësuar me programet e këtij ligji.

Ndihme për investime në ekonomite bujqësore

Neni 94

(1) Ndihma shteterore për investime në ekonomite bujqësore është perkrahje plotësuese financiare e masës nga neni 70 i këtij ligji.

(2) Lartësia e ndihmes nga paragrafi (1) i këtij neni, duke e përfshirë edhe perkrahjen nga neni 70 i këtij ligji, arrin:

- 60% nga investimi në zonat me mundësi të kufizuara për prodhimitari bujqësore,
- 65% nga shpenzimet e pranueshme investuese në zonat me mundësi të kufizuara për prodhimitari bujqësore kur bartesi i investimit është bujk i ri,
- 55% në zonat tjera kur bartesi i investimit është bujk i ri,

- 75% nga shpenzimet e pranueshme investuese në bashkësi të paarritshme rurale dhe
- 60% nga shpenzimet e pranueshme investuese nëse investimi kontribuon për mbrojtjen dhe përpunimin e mjedisit jetësor, përmirësimin e kushteve higjienike dhe mirëqenien e kafsheve në ekonomitë bujqësore, përveç në rast kur investimi është në rajonet me mundësi të kufizuara për prodhimtari bujqësore kur ndihma është 75%.

(3) Ndihma për investime të këtij neni nuk u ndahet ekonomive bujqësore në të cilat bartes është personi juridik që shfrytëzon ndihme për shpëtim dhe rikonstruim në pajtim me Ligjin për ndihme shtetërore.

Ndihme për ruajtjen e zonës dhe arkitekture tradicionale

Neni 95

(1) Ndihme për ruajtjen e zonës dhe arkitekture tradicionale është ndihma e dedikuar për investime në ekonomitë bujqësore ose në mjediset rurale për ruajtjen e shënimeve tradicionale me karakteristika arkeologjike dhe historike të percaktuara me ligj ose akt të njëjtit të vetëadministrimit lokal ku gjendet prona bujqësore ose shënim i tradicional.

(2) Lartësia e ndihmes nga paragrafi (1) i këtij neni arrin:

- 100% nga shpenzimet e pranueshme të bera me investimin ose punët kapitale dhe shpenzimet operative për shënime tradicionale për dedikime joproduhëse, por më së shumti deri më 600 000 denare në vit,

- 60% nga shpenzimet e pranueshme të bera me investimin ose punët kapitale për shënime tradicionale të dedikuara për prodhimtari dhe

- 75% nga shpenzimet e pranueshme të bera me investimin ose punët kapitale për shënime tradicionale të dedikuara për prodhimtari në zonat me mundësi të kufizuara për prodhimtari bujqësore.

(3) Investimet nga paragrafi (2), alinetë 2 dhe 3 të këtij neni nuk duhet të çojnë në rritjen e kapacitetit prodhues të ekonomisë bujqësore.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni, në rast kur investimet nga paragrafi (2), alinetë 2 dhe 3 të këtij neni çojnë në rritjen e kapacitetit prodhues, ndihma plotësuese ndahet në lartësi deri më 100% edhe atë vetëm për shpenzimet plotësuese të bera për përdorimin e materialeve tradicionale të domosdoshme për ruajtjen e shënimeve tradicionale të objektit.

Ndihme për zhvendosje të objekteve nga prona bujqësore për realizim të interesit publik

Neni 96

(1) Ndihme për zhvendosje të objekteve nga prona bujqësore për realizim të interesit publik e percaktuar në pajtim me ligjin është ndihme për kompensim të shpenzimeve të bera për smontim, menjanim dhe rimontim të objektit.

(2) Ndihma nga paragrafi (1) i këtij neni është në lartësi deri më 100% nga shpenzimet e pranueshme të bera gjatë zhvendosjes.

Përjashtime për lartësinë e ndihmes

Neni 97

(1) Në rast kur me zhvendosjen rritet vlera për shkak të objekteve dhe pajisjeve më bashkëkohore, bartesi i ekonomisë bujqësore do të marrë pjesë së paku me 60% nga vlera e rritur e objektit ose 50% nga vlera e rritur në zonat me mundësi të kufizuara për prodhimtari bujqësore.

(2) Në rast kur bartesi i ekonomisë bujqësore është bujk i ri, pjesëmarrja nga paragrafi (1) i këtij neni do të jete së paku 55% nga vlera e rritur e objektit, ose 45% në zonat me mundësi të kufizuara për prodhimtari bujqësore.

(3) Në rast kur me zhvendosjen rritet kapaciteti prodhues, bartesi i ekonomise bujqesore do të marre pjese së paku me 60% nga shpenzimet që u perkasin rritjes së kapacitetit prodhues, ose 50% në rajonet me mundesi të kufizuara për prodhimtari bujqesore.

(4) Në rast kur bartesi i ekonomise bujqesore eshte bujk i ri, pjesemarrja nga paragrafi (3) i ketij neni do të jete së paku 55% nga shpenzimet që u perkasin rritjes së kapacitetit prodhues ose 45% në zonat me mundesi të kufizuara për prodhimtari bujqesore.

Ndihme për premitë për sigurim

Neni 98

(1) Ndhma për premitë për sigurim eshte kompensim i një pjese të shpenzimeve për sigurim të ekonomise bujqesore për prodhimin primar bujqesor nga fatkeqesite natyrore dhe ngjarjet e pavolitshme klimatike.

(2) Lartesia e ndihmes nuk do të tejkaloje 60% nga shpenzimi i premise për sigurim për kompensim të demit ndaj prodhimit primar bujqesor e shkaktuar si rezultat i ngjarjes së pavolitshme klimatike, mirepo jo më teper se 200 000 denare për ekonomi bujqesore.

Ndhma për humbjet e shkaktuara nga fatkeqesite natyrore dhe ngjarjet e pavolitshme klimatike

Neni 99

(1) Ndhma për humbjet e shkaktuara nga fatkeqesite natyrore dhe ngjarjet e pavolitshme klimatike eshte ndihme e ekonomive bujqesore për humbjet e bimeve bujqesore dhe kafsheve në pronen bujqesore, si dhe për demet e serave me qelq dhe serave me plastmase të shkaktuara nga ndodhite e pavolitshme kohore të cilet nuk kane trajtim të fatkeqesise elementare.

(2) Lartesia e ndihmes nga paragrafi (1) i ketij neni nuk do të tejkaloje 60%, dhe 80% në zonat me mundesi të kufizuara për prodhimtari bujqesore nga humbja e të hyrave nga shitja e produktit, ose demi i krijuar i seres me qelq respektivisht seres me plastmase, por jo më shume se 300 000 denare për ekonomi bujqesore.

(3) Menyren për percaktimin e ngjarjes së pavolitshme klimatike, demin e shkaktuar, për llogaritjen e humbjes së të hyrave, për llogaritjen e demit nga paragrafi (2) i ketij neni dhe proceduren për pagese të ndihmes i percakton Qeveria, me propozimin e Ministrise.

(4) Shuma maksimale e ndihmes nga paragrafi (2) i ketij neni do të zvogelohet për:

- shumen e fituar në suaza të marreveshjes për sigurim dhe
- lartesine e shpenzimeve që nuk jane shkaktuar si rezultat i ngjarjes së pavolitshme klimatike.

(5) Llogaritja e humbjes behet vecmas për çdo ekonomi bujqesore.

(6) Ndhma i paguhet në menyre të drejtpedrejte bartesit të ekonomise bujqesore apo organizates së prodhuesve në të cilen anetaresohet bartesi i ekonomise bujqesore.

(7) Kompensimi për humbjet e shkaktuara nga thatesia do t'u paguhet vetem ekonomive bujqesore të cilat e kane shlyer kompensimin për shfrytezim të ujit për ujitje.

(8) Krahas ndihmes së ndare në pajtim me paragrafet (1) dhe (2) të ketij neni, varesisht nga lartesia e demit të shkaktuar, ndihma mund të jete edhe në forme të zvogelimit, lirimit ose anulimit të obligimeve me para të ekonomive bujqesore ndaj Ministrise.

(9) Lartesine e demit të shkaktuar dhe formen e ndihmes nga paragrafi (8) i ketij neni e percakton Qeveria me propozimin e ministrit.

Ndhma për rritje dhe mbrojtje të tokes bujqesore

Neni 100

(1) Ndhma për rritje dhe mbrojtje të tokes bujqesore ndahet për mbulim të shpenzimeve juridike dhe administrative që dalin nga procedura për rritje të tokes bujqesore, si dhe procedurat për analize të cilesive fizike dhe kimike të truallit, të cilat realizohen nepermjet masave për perkrahje të bujqesise dhe zhvillimit rural.

(2) Lartesia e ndihmes nga paragrafi (1) i ketij neni mund të arrije deri më 100% nga shpenzimet e bera për rritje.

Ndihma për sigurim të perkrahjes teknike në bujqesi

Neni 101

(1) Ndihma për sigurim të perkrahjes teknike në bujqesi ndahet si kompensim deri më 100% për shpenzimet e pranueshme si vijon të dedikuara për:

- organizim të programeve për trajnim dhe shpenzime të rruges dhe shpenzime ditore të pjesemarrësve,
- kerkime dhe sherbime konsultuese për perpunim të projekt propozimeve, studimeve dhe dokumenteve strategjike,
- investime investuese që nuk perkrahen nepermjet masave të perkrahjes së bujqesise dhe zhvillimit rural për realizim të projekteve aplikative dhe projekteve bazike kerkimore-shkencore,
- aktivitete për funksionimin e shoqatave nacionale dhe rajonale të prodhuesve bujqesore në pajtim me programin vjetor për pune,
- shperblime, material propagandues, qira të hapësirave dhe promovim për organizim të manifestimeve dhe panairove,
- pjesemarrje, qira të hapësirave, shpenzime të rruges dhe shpenzime për vendosje dhe shpenzime për material propagandues për pjesemarrje të prodhuesve bujqesore në manifestime të panairove dhe panairove si ekspozitues,
- pergatitje dhe shpallje të materialeve dhe publikimeve edukative, informative, shkencore, propaganduese dhe profesionale,
- vendosje e zones treguese-demonstruese në baze të planit shumevjecar të dorezuar dhe të miratuar për realizim,
- udhezime juridike të ekonomive bujqesore gjate lidhjes së marreveshjeve dhe gjate ngritjes së kontestit për realizim të marreveshjes,
- organizim të panairove promovuese dhe takimeve ndermjet prodhuesve dhe bleresve dhe
- ndihme për marketing të prodhimeve bujqesore të shoqates së prodhuesve bujqesore.

(2) Ndihma nga paragrafi (1) i ketij neni ndahet varesisht nga:

- rezultatet reale dhe të zbatueshme me efekte të shpejta të orientuara kah realizimi i qellimeve perkufizuese strategjike për zhvillim të bujqesise dhe zhvillimit rural,
- ndikimi i drejtperdrejte dhe i terthorte i një numri më të madh të subjekteve në sferen e bujqesise,
- bashkim i shfrytezuesve të perkrahjes, partneritetit publik-privat ose formave tjera të partneritetit me numer më të madh të shfrytezuesve,
- qendrueshmeri për realizimin e perkrahjes,
- pervoje paraprake në realizimin e aktiviteteve me rendesi për grupin qellimor të shfrytezuesve perfundimtare të perkrahjes dhe
- pjesemarrje personale ose pjesemarrje nga burime të tjera të financimit.

(3) Kriteret më të peraferta nga paragrafi (2) i ketij neni, shumen maksimale të ndihmes, menyren për dhenien e ndihmes, subjektet që kane të drejte të pjesemarrjes në procedure, si dhe dokumentacionin e nevojshem i percakton ministri.

Ndihma për kategori të vecanta të bartesvete ekonomise bujqesore

Neni 102

(1) Ndihma për kategori të vecanta të bartesve të ekonomise bujqesore eshte ndihma plotesuese që u ndahet ekonomive bujqesore shfrytezues të pagesave të drejtperdrejta nga neni 47 i ketij ligji në shume më të madhe në raport me shfrytezuesit tjere për:

- 5% për personin juridik të regjistruar në RUEB si ekonomi bujqesore që eshte themeluar nga bartesi ose anetari i ekonomise familjare-bujqesore me tere pronen bujqesore të ekonomise familjare-bujqesore pervec objekteve për banim ose qendrim të prodhuesve bujqesore dhe

- 10% për kategorite e bujkut të ri ose grua bartese e ekonomise bujqesore.

(2) Ndhima nga paragrafi (1) i ketij neni jepet më së shumti për periudhe prej pese vitesh nga regjistrimi i ndryshimit në RUEB.

Ndhima në sektorin blegtoral

Neni 103

(1) Ndhima në sektorin blegtoral eshte ndihme e dedikuar për perkrahje, kultivim dhe perparim të kualitetit gjenetik të blegtorise.

(2) Ndhima nga paragrafi (1) i ketij neni ndahet në lartesi deri më:

- 100% për mbulim të shpenzimeve administrative për vendosje dhe mbajtje të kontabilitetit amë,

- 70% nga shpenzimet për analiza të kryera nga persona të trete ose në emer të personave të trete për percaktim të kualitetit gjenetik ose prodhimin në blegtori, me perjashtim të masave për kontroll të ndermarra nga pronari i kafsheve dhe kontroll rutinor të kualitetit të qumeshtit,

- 40% për zbatimin e teknikave ose praktikave të reja për kultivim të kafsheve në nivel të ekonomise me perjashtim të shpenzimeve në lidhje me zbatimin ose kryerjen e mbarsjes artificiale,

- 100% nga shpenzimet për menjaminin e kafsheve të ngordhura dhe deri më 75% nga shpenzimet për shkaterrimin e trupave të atyre kafsheve, ose ndihme alternative deri në shumen e njejte për shpenzimet e premive të paguara nga prodhuesit bujqesore që i mbulojne shpenzimet për menjaminin dhe shkaterrimin e kafsheve të ngordhura dhe

- 100% për shpenzimet për menjaminin dhe shkaterrimin e trupave, nese ndihma eshte e financuar nga honorare ose kontribute të detyrueshme të percaktuara për financim për shkaterrimin e atyre trupave, në kushte kur ato honorare ose kontribute jane të kufizuar në sektorin vendor dhe jane të dedikuara drejtperdrejte për atë sektor.

(3) Ndhima nuk mund të perfshije pagesa të drejtperdrejte të mjeteve financiare të prodhuesve bujqesore.

Ndhima në pylltari

Neni 104

(1) Ndhima për rritjen e vleres ekonomike të pyjeve eshte perkrahja financiare plotesuese e mases nga neni 71 i ketij ligji.

(2) Lartesia e ndihmes nga paragrafi (1) i ketij neni, duke perfshire edhe perkrahjen nga neni 71 i ketij ligji, arrin:

- 60% nga lartesia e shpenzimeve të pranueshme për investime në zonat malore dhe

- 85% nga lartesia e shpenzimeve të pranueshme për investime në mjediset e paarritshme rurale.

Ndhima për perpunim dhe marketing

Neni 105

(1) Ndhima për perpunim dhe marketing të prodhimeve bujqesore eshte perkrahje financiare plotesuese e mases nga neni 72 i ketij ligji.

(2) Lartesia e ndihmes nga paragrafi (1) i ketij neni, duke e perfshire edhe perkrahjen nga neni 72 i ketij ligji, arrin:

- 60% nga vlera e investimeve të pranueshme të bera në mjediset e paarritshme rurale,

- 65% nga vlera e investimeve të pranueshme në mjediset e prapambetura rurale dhe

- 75% nga vlera e investimeve të pranueshme në mjediset e depopulluara rurale.

Ndhima për vendosjen e standardeve më të larta të kualitetit

Neni 106

(1) Ndhime për vendosjen e standardeve më të larta të kualitetit të prodhimeve bujqesore eshte perkrahja financiare plotesuese e mases nga neni 72 i ketij ligji.

- (2) Ndhma nga paragrafi (1) i ketij neni mund të ndahet në forme të:
- plotesimeve deri më 30% të pagesave të drejtperdrejta nga neni 47 i ketij ligji,
 - deri më 1 denar për njesi prodhuese bujqesore e perdorur si lende e pare për produkte me kualitet më të larte në pajtim me ligjin dhe
 - ndihme financiare për kompensim të shpenzimeve për vendosjen ose për zbatimin e shenjave për kualitet në shumen maksimale deri më 300 000 denare ose 5% nga vlera e produkteve të shitura me shenja për kualitet mirepo jo më shume se 300 000 denare.

Ndhma De minimis

Neni 107

- (1) De minimis eshte ndihme që u ndahet ekonomive bujqesore familjare kur ajo u eshte e domosdoshme, ndersa nuk mund ta realizojne me asnje baze tjeter në pajtim me kete ligj.
- (2) Menyren e percaktimit të permbushjes së kushteve nga paragrafi (1) i ketij neni e percakton ministri.
- (3) Vendimin për dhenien e ndihmes nga paragrafi (1) i ketij neni e miraton Qeveria me propozimin e ministrit.
- (4) Shuma maksimale e ndihmes nga paragrafi (1) i ketij neni për ekonomi bujqesore nuk mund të tejkaloje shumen e pergjithshme prej 120 000 denare për tre vite të njepasnjeshme.
- (5) Nese nga gjykata kompetente ose organi kundervajtes në menyre plotesuese percaktohet se krijimi i gjendjes që e ka shkaktuar domosdoshmerine për ndihme nga paragrafi (1) i ketij neni eshte me faj ekskluziv të shfrytezuesit të ndihmes, i njejt obligohet që ta ktheje shumen e pergjithshme të ndihmes së ndare.

E drejta për ndihme shteterore

Neni 108

Shfrytezues të ndihmes shteterore mund të jene ekonomite bujqesore dhe subjektet që nuk kane obligim me para ndaj Ministrise dhe Agjencise.

Evidentimi i ndihmes shteterore

Neni 109

- (1) Ministria mban evidence të ndihmes së ndare shteterore në bujqesi dhe zhvillim rural.
- (2) Llojin e të dhenave, formen, permbajtjen dhe menyren e mbajtjes së evidences nga paragrafi (1) i ketij neni i percakton ministri.
- (3) Të gjitha organet shteterore dhe njesite e vetadministrimit lokal obligohen që me detyre zyrtare ta njoftojne Ministrine për ndarjen e ndihmes së pakthyeshme financiare të subjekteve.
- (4) Në baze të evidences nga paragrafi (1) i ketij neni dhe të dhenat nga paragrafi (3) i ketij neni, Ministria kujdeset për evitimin e financimit të dyfishte të ndihmes shteterore për qellim të njejte, si dhe tejkalimin e shumes maksimale të ndihmes në pajtim me kete ligj.

Transparenca dhe ndjekja

Neni 110

Për nevojat e publicitetit dhe transparences në procesin e ndarjes së ndihmes shteterore në bujqesi dhe zhvillimin rural, të gjitha të dhenat për vendosje dhe realizim të ndihmes shteterore shpallen në ueb faqen e Ministrise.

VIII. FORMAT E SHOQERIMIT

Qellimet dhe format e shoqerimit

Neni 111

- (1) Për realizim të qellimeve nga neni 3 i ketij ligji ekonomite bujqesore mund të bashkohen vullnetarisht si organizata të prodhuesve.

(2) Ekonomite bujqesore mund të shfrytezojne perkrahje financiare për shoqerim në pajtim me kete ligj.

Organizata e prodhuesve

Neni 112

Organizata e prodhuesve eshte kooperative e formuar nga ekonomite bujqesore për shkak të harmonizimit të prodhimit bujqesor dhe ofertes së produkteve bujqesore me kushtet e tregut, e cila i permbush kushtet e percaktuara në pajtim me kete ligj dhe eshte e regjistruar në Regjistrin e organizatave të prodhuesve në Ministri.

Qellimet e organizates së prodhuesve

Neni 113

Organizata e prodhuesve themelohet për realizimin e qellimeve si vijojne:

- planifikimin e prodhimit dhe harmonizimin e tij me nevojat e tregut në pikepamje të kerkeses dhe kualitetit,
- perqendrimin e ofertes dhe permiresimin e shitjes së pergjithshme të produkteve nga anetaret e organizates,
- arrijten e nivelit optimal të shpenzimeve prodhuese dhe stabilizimin e qellimeve prodhuese,
- perparimin e menyres së punes, perdorimin e teknikes dhe teknologjise bashkekohore, mbrojtjen e natyres dhe ujrave dhe kultivimin e llojllojshmerise biologjike,
- lehtesimin dhe thjeshtesimin e procesit për qasje te mjetet financiare dhe
- sigurimin e vetekontrollit në organizate dhe në prodhimtari, e vecanerisht të llojeve specifike të prodhimit dhe procedurat agroteknike të percaktuara me rregulla të vecanta.

Kushtet për fitimin e statusit të organizates së prodhuesve

Neni 114

(1) Për fitimin e statusit të organizates së prodhuesve, kooperativa nga neni 112 i ketij ligji duhet t'i permbush kushtet si vijojne:

- të jete e regjistruar si kooperative në pajtim me ligjin për kooperativat,
- të kete parakushte themelore për pune,
- të kete statut të miratuar me rregulla të posacme perkufizuese për pune për plotesimin e qellimeve nga neni 113 i ketij ligji,
- të kete së paku pese anetare,
- të realizoje vlere minimale të prodhimit vjetor të tregut prej 6 000 000 denare,
- të jene formuar për prodhim të caktuar, perkatesisht grup prodhimesh të pemeve ose perimeve,
- të posedoje fond operativ dhe të kete program operativ për pune të pergatitur dhe të miratuar ose të dorezuar për miratim dhe
- me punen e vet të mos e kufizojte konkurrencen e tregut të produktit të caktuar, perkatesisht grup produktesh të pemeve ose perimeve.

(2) Kooperativa nga paragrafi (1) i ketij neni, statusin e organizates së prodhuesve e fiton me ditën e regjistrimit në Regjistrin e organizatave të prodhuesve që mbahet në Ministri.

Anetaresimi në organizaten e prodhuesve

Neni 115

(1) Anetare të organizates së prodhuesve jane ekonomite bujqesore të regjistruara në RUEB nga neni 15 i ketij ligji.

(2) Anetare të organizates së prodhuesve, nuk mund të jene personat juridike në të cilat pjesemarrja e kapitalit shtetëror eshte më e madhe se 25% në kapitalin e pergjithshem të personit juridik.

(3) Afati minimal i anetaresimit në organizaten e prodhuesve eshte së paku një vjet.

Vlera e prodhimit të tregut

Neni 116

(1) Vlera e prodhimit të tregut të organizates së prodhuesve eshte vlera e prodhimit, e plasuar në treg, të anetaresimit të organizates së prodhuesve për të cilen eshte e njohur organizata.

(2) Llogaritja e vleres së prodhimit të tregut nga paragrafi (1) i ketij neni bazohet në vleren e prodhimit, të shitur nga vete organizata e prodhuesve, duke i perfshire edhe:

- vleren e prodhimit të anetaresimit të cilet e leshojne ose i bashkengjiten organizates së prodhuesve dhe

- vleren e prodhimeve dytesore dhe të perpunuara të organizates së prodhuesve.

(3) Llogaritja nga paragrafi (2) i ketij neni kryhet në baze të vleres së prodhimit ngarkesa franko nga organizata e prodhuesve, me perjashtim të TVSH-së dhe shpenzimeve të brendshme transportuese.

Parakushtet themelore për pune

Neni 117

Organizata e prodhuesve duhet të disponoje me personel perkates, infrastrukture dhe pajisje për arritjen e qellimeve për punen e tij, e vecanerisht:

- informatata për prodhim të anetaresimit të vet,
- kushte për klasifikimin, magazinimin dhe paketimin e prodhimeve të anetaresimit të vet,
- udheheqje komerciale dhe buxhetore dhe
- kontabilitet i centralizuar dhe sistem për faturim.

Statuti

Neni 118

(1) Statuti i organizates së prodhuesve në detyrimisht permban:

- rregulla në lidhje me njoftimin, prodhimin, marketingun dhe mbrojtjen e mjedisit jetesor,
- obligim për anetaresimit për perkatesi vetem në një organizate të prodhuesve për produktin adekuat,

- obligim për anetaresimit për shitjen e tere prodhimit të tyre nepermjet organizates së prodhuesve,
- obligim për anetaresimit për sigurim të informatave me kerkese të organizates së prodhuesve për qellime statistike, vecanerisht të dhenave për siperfaqe të mbjella, sasi të prodhuara, prodhime dhe shitje të drejtperdrejte,

- dispozita për kontribute financiare të anetaresimit për krijimin dhe plotesimin e fondit operativ dhe financimin e organizates së prodhuesve,

- procedura për miratimin, zbatimin dhe ndryshimin e rregullave të organizates së prodhuesve,
- sanksione për mosrespektimin e obligimeve në pajtim me statutin e organizates, vecanerisht për mosplotesimin e obligimeve për pagese të kontributeve financiare ose prishjen e rregullave të miratuara nga organizata e prodhuesve,

- rregulla për pranimin e anetaresimit të rinj, e vecanerisht minimum periudhe për anetaresimit,
- rregulla të kontabilitetit dhe buxhetore të domosdoshme për funksionimin e organizates së prodhuesve,

- dispozita për zgjedhjen, emerimin dhe punen e organeve udheheqese të organizates së prodhuesve,

- menyren dhe proceduren për miratim të vendimeve për shfrytezim të mjeteve nga fondi operativ dhe

- dispozita tjera me rendesi për pune të organizates së prodhuesve.

(2) Me perjashtim nga paragrafi (1), alineja 3 e ketij neni, statuti nga paragrafi (1) i ketij neni mund të permbaje dispozita me të cilat u jep mundesi anetaresimit të organizates së prodhuesve që të shesin:

- jo më teper se 10% nga prodhimi personal i produkteve ose grup produktesh për të cilat është formuar organizata e prodhuesve, në menyre të drejtperdrejte nga ekonomia bujqesore dhe/ose drejtpedrejte nga konsumatorët për konsumim final dhe

- prodhimin personal të produkteve të cilat për shkak të karakteristikave të tyre nuk janë perfshire në veprimtarine tregtare të organizates së prodhuesve në menyre të pavarur ose nepermjet organizates tjeter të prodhuesve nese është e propozuar nga organizata e prodhuesve në të cilën anetaresohet.

Procedura për regjistrim

Neni 119

(1) Procdura për regjistrim në Regjistrin e organizatave të prodhuesve ngritet me parashtrimin e kerkeses për regjistrim në Ministri.

(2) Kerkesa nga paragrafi (1) i ketij neni parashtrohet në formular të percaktuar me dokumentacionin e nevojshem shoqerues për deshëmim të permbushjes së kushteve nga neni 114 i ketij ligji.

(3) Formularin e kerkeses dhe dokumentacionin e nevojshem shoqerues nga paragrafi (2) i ketij neni i percakton ministri.

(4) Kerkesa për regjistrim të organizates së prodhuesve në Regjister nga neni 120 i ketij ligji parashtrohet deri më 15 shtator.

(5) Në rast kur kerkesa nga paragrafi (1) i ketij neni është e paplote ose e pakuptueshme, kerkuesi në forme me shkrim njoftohet për parregullesite dhe i percaktohet afat më së shumti prej 15 ditësh për menjanim të parregullsive.

(6) Nese në afatin e percaktuar për menjanim të parregullsive nga paragrafi (5) i ketij neni, kerkuesi nuk i menjanon parregullsitet, kerkesa nuk do të pranohet.

(7) Me konstatimin e permbushjes së kushteve nga neni 114 i ketij ligji, ministri miraton aktvendim për regjistrim në Regjistrin e organizatave të prodhuesve.

(8) Me perjashtim nga paragrafi (7) i ketij neni, nuk do të miratohet aktvendim për regjistrim në regjister para lejimit të programit operativ për pune nga neni 114, paragrafi (1), alineja 7 të ketij ligji.

(9) Aktvendimi nga paragrafi (7) i ketij neni miratohet më së voni në afat prej tre muajsh nga pranimi i kerkeses.

(10) Aktvendimi nga paragrafi (7) i ketij neni hyn në fuqi nga 1 janari i vitit të ardhshem nga viti në të cilin është parashtruar kerkesa.

Regjistri i organizatave të prodhuesve

Neni 120

(1) Regjistri i organizatave të prodhuesve mbahet në forme elektronike dhe i permban të dhenat nga kerkesa për regjistrim nga nenet 119 dhe 126 të ketij ligji.

(2) Krahas të dhenave nga paragrafi (1) i ketij neni, në Regjister detyrimisht shenohen të gjitha ndryshimet e gjendjes së regjistruar.

(3) Për ndryshimet nga paragrafi (2) i ketij neni, organizata e prodhuesve dhe grupi i prodhuesve obligohen që ta njoftojne Ministrine në afat prej 15 ditësh nga dita e berjes së ndryshimit.

Shlyerja nga regjistri

Neni 121

(1) Ministri me aktvendim e shlyen organizaten e regjistruar të prodhuesve nga Regjistri i nenit 120 të ketij ligji në rastet si vijon:

- pas kerkeses me shkrim nga organi i udheheqjes së organizates,
- në rast të pushimit të kooperatives,

- gjate shpalljes së likuidimit ose hapjes së procedurës falimentuese,
- nese konstatohet se organizata e prodhuesve është regjistruar në baze të informatave të pasakta,

- nese nuk e zbaton në teresi programin e miratuar operativ dhe
- kur do të pushoje t'i permbushë kushtet nga neni 114 i këtij ligji.

(2) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni ka të drejte ankese në komisionin e shkallës së dytë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë kompetent për zgjidhjen e punëve administrative të shkallës së dytë nga sfera e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave.

(3) Me plotfuqishmerine e aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, organizata e prodhuesve shlyhet nga Regjistri.

Grupet e prodhuesve

Neni 122

(1) Grupi i prodhuesve është kooperative e formuar nga ekonomite bujqësore për shkak të arritjes së statusit të organizatës së prodhuesve.

(2) Për fitimin e statusit të grupit të prodhuesve, kooperativa nga paragrafi (1) i këtij neni duhet t'i permbushë kushtet si vijojnë:

- të jete e regjistruar si kooperative në pajtim me Ligjin për kooperativat,
- të kete parakushte minimale për pune,
- të kete statut të miratuar me rregulla të posaçme të perkufizuara për pune për plotesimin e qëllimeve nga neni 113 i këtij ligji,
- të kete së paku pesë anetare,
- të realizojë të hyra të pergjithshme nga shitja e prodhimit vjetor së paku prej 3 500 000 denarësh,
- të jene formuar për produkt të caktuar, perkatesisht grup produktësh të pemeve ose perimeve,
- të kete pergatitur plan për fitim të statusit të organizatës së prodhuesve (në tekstin e metejme: plan për njohje), i cili në menyre të detyrueshme duhet të jete i miratuar nga Ministria dhe
- me punën e vet të mos e kufizojë konkurrencën e tregut të një produkti të caktuar, perkatesisht grup produktësh të pemeve ose perimeve.

(3) Kooperativa nga paragrafi (1) i këtij neni, statusin e grupit të prodhuesve e fiton me ditën e regjistrimit në Regjistrin e organizatave të prodhuesve.

Parakushtet minimale për pune

Neni 123

Kushtet minimale për pune nga neni 122, paragrafi (2), alineja 2 të këtij ligji janë si vijojnë:

- së paku dy të punësuar nga të cilët një menaxher dhe
- sigurim të kushteve të zyrës për pune.

Plani për njohje

Neni 124

(1) Plani për njohje nga neni 122, paragrafi (2), alineja 7 të këtij ligji permban masa dhe aktivitete për permbushjen e kushteve për fitimin e statusit të organizatës së prodhuesve.

(2) Plani për njohje nga paragrafi (1) i këtij neni pergatitet për periudhe kohore deri më pesë vite.

(3) Plani për njohje nga paragrafi (1) i këtij neni e permban së paku keto:

- pershkrimin e gjendjes fillestare në lidhje me numrin e anetareve të organizatës së prodhuesve me të dhenat për anetaret, prodhimin, të dhenat për vlerën e prodhimit të tregut, marketingun dhe infrastrukturen, duke e perfshire edhe infrastrukturen në pronesi të anetareve të kooperatives që shfrytëzohet nga kooperativa,

- daten e propozuar për fillim të realizimit të planit dhe periudhen e realizimit, së paku prej dy, por jo më shumë se pesë vitesh dhe
 - masat dhe aktivitetet të cilat duhet të merren që të fitojë status të organizates së prodhuesve.
- (4) Menyren e përgatitjes së planit për njohje e përcakton ministri.
- (5) Plani nga paragrafi (1) i këtij neni dorezohet për miratim në Ministri.

Procedura për miratim të planit për njohje

Neni 125

- (1) Për miratim të planit për njohje nga neni 124 i këtij ligji, ministri formon komision të përhershëm prej pesë anëtarëve nga nepunesit shtetërorë të Ministrisë, i cili i ka detyrat si vijon:
- të kontrollojë planin e dorëzuar për njohje,
 - të vërtetojë autenticitetin e të dhënave dhe informatave të dhëna në planin për njohje,
 - të vërtetojë përputhshmërinë e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin për njohje në pikepamje të marketingut dhe bazës teknike-teknologjike dhe
 - të vërtetojë sigurinë me mjete financiare për realizimin e tij.
- (2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni përgatit raport, vlerësim dhe propozim për miratim të planit për njohje.

Procedura për regjistrimin e grupeve të prodhuesve

Neni 126

- (1) Procedura për regjistrimin e grupeve të prodhuesve në Regjistrin e organizatave të prodhuesve ngritet me parashtrimin e kërkesës për regjistrim në Ministri.
- (2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet në formular të përcaktuar me dokumentacionin e nevojshëm shoqëruar për dëshmim të përmbushjes së kushteve nga neni 122 i këtij ligji.
- (3) Formularin e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm shoqëruar nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton ministri.
- (4) Kërkesa për regjistrim të grupit të prodhuesve parashtrohet deri më 15 shtator.
- (5) Në rast kur kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni është e paplote ose e pakuptueshme, kerkuesi në formë të shkruar njoftohet për parregullsitë dhe i përcaktohet afat më së shumti prej 15 ditësh për menjim të parregullsive.
- (6) Nëse në afatin e përcaktuar për menjim të parregullsive nga paragrafi (5) i këtij neni, kerkuesi nuk i menjon parregullsitë, kërkesa do të refuzohet.
- (7) Me konstatimin e përmbushjes së kushteve nga neni 122 i këtij ligji, ministri miraton aktvendim për regjistrim në Regjistrin e organizatave të prodhuesve.
- (8) Aktvendimi nga paragrafi (7) i këtij neni miratohet më së voni në afat prej tre muajsh nga pranimi i kërkesës.
- (9) Aktvendimi nga paragrafi (7) i këtij neni hyn në fuqi nga 1 janari i vitit të ardhshëm nga viti në të cilin është parashtruar kërkesa.

Ndjekja e përmbushjes së planit për njohje

Neni 127

- (1) Ministria kryen ndjekje të përhershme dhe vlerësim të përmbushjes së planit për njohje.
- (2) Grupi i prodhuesve, obligohet që të dorëzojë në Ministri raport për realizim të planit për njohje, i cili kryesisht përmban tregues financiar për punë në bazë të bilancit të gjendjes dhe bilancit të suksesit.
- (3) Raporti nga paragrafi (2) i këtij neni dorëzohet çdo vit, më së vonë se 31 marsi i vitit rrjedhës për vitin paraprak.

Shlyerja nga regjistri i grupeve të prodhuesve

Neni 128

(1) Grupin e regjistruar të prodhuesve ministri me aktvendim e shlyen nga Regjistri i nenit 120 të këtij ligji në rastet si vijojne:

- me kerkesen me shkrim nga organi udheheqes i grupit,
- në rast të pushimit të kooperatives,
- gjate shpalljes së likuidimit ose procedures së hapur falimentuese,
- nese konstathet se grupi i prodhuesve eshte i regjistruar në baze të informatave të pasakta,
- kur do të pushoje t'i permbush kushtet nga neni 122 i këtij ligji,
- grupi i prodhuesve më nuk i permbush kushtet dhe kriteret e percaktuara në pajtim me nenin 122 të këtij ligji,
- grupi i prodhuesve nuk e realizon planin për njohje,
- afati për çdo aktvendim të leshuar për regjistrim eshte i skaduar;
- me skadimin e pese viteve nga regjistrimi në Regjistrin e organizatave të prodhuesve.

(2) Me perjashtim nga paragrafi (1), alinete 6 dhe 7 të këtij neni, ministri nuk miraton aktvendim për shlyerje të grupit të prodhuesve, gjate shfaqjes së situatave të jashtezakonshme, fatkeqesive natyrore dhe ngjarjeve të pavolitshme klimatike të perkufizuara me kete ose me ligj tjetër.

(3) Me perjashtim nga paragrafi (1), alineja 7 të këtij ligji, ministri nuk miraton aktvendim për shlyerje të grupit të prodhuesve, nese jane konstatuar leshime minimale nga realizimi i planit për njohje dhe cakton afat perkates për tejkalimin e tyre.

(4) Nese grupi i prodhuesve nuk i tejkalon leshimet në afatin e percaktuar nga paragrafi (3) i këtij neni, ministri e miraton aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Afati i percaktuar nga paragrafi (3) i këtij neni nuk e prolongon afatin e fundit për realizim të planit për njohje.

(6) Kunder aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, grupi i prodhuesve ka të drejte ankese në komisionin e shkalles së dyte të Qeverise së Republikës së Maqedonise kompetent për zgjidhjen e puneve administrative të shkalles së dyte nga sfera e bujqesise, pylltarise dhe ekonomise së ujerave.

(7) Me plotfuqishmerine e aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, grupi i prodhuesve shlyhet nga Regjistri.

Ruajtja e dokumentacionit

Neni 129

Organizata e prodhuesve doemos duhet ta ruaje dokumentacionin e plote dhe materialin deshmues për pune, vecanerisht në lidhje me plotesimin e kushteve për njohje, të dhenat për anetaret, planin operativ dhe dokumentacionin për perkrahje të shfrytezuara financiare në kohen kur ka qene e njohur, së paku pese vite pas heqjes së njohjes.

Strategjia Nacionale e programeve operative për pune

Neni 130

(1) Qeveria me propozimin e ministrit miraton strategji nacionale për programe operative për pune të organizatave të prodhuesve për tregun e produkteve bujqesore.

(2) Strategjia nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet në periudhe prej pese vitesh për tregjet e pemeve dhe perimeve, për realizimin e qellimeve të paraqitura në nenet 3 dhe 113 të këtij ligji.

(3) Strategjia nga paragrafi (1) i këtij neni vecanerisht permban:

- 1) analizen e gjendjes rrjedhese, potencialin për zhvillim dhe menyren e realizimit, edhe atë:
 - a) analizen e gjendjes në sektor nepermjet të dhenave të kuantifikuara, perpaesive dhe dobesive të sektoreve, nevojave dhe mangesive dhe potencialit për zhvillimin e sektorit dhe organizatave të prodhuesve, duke perfshire edhe efekte mbi mjedisin jetesor nga zhvillimi i sektorit të pemeve dhe perimeve dhe

b) menyren e realizimit dhe pershkrimin e qellimeve të zgjedhura për programet operative dhe rezultatet e pritura dhe ndikimin e tyre në lidhje me gjendjen fillestare, duke perfshire edhe koherencen e brendshme të strategjise, plotesimin dhe konsistencen e aktiviteteve në suazat e strategjise dhe me programet tjera nacionale, ndersa vecanerisht në lidhje me aktivitetet dhe programet e caktuara në pajtim me të kete ligj.

2) qellimet e programeve operative, instrumentez për zbatim dhe indikatoret për realizim, dhe atë:

a) kritere dhe rregulla administrative për financimin e aktiviteteve dhe shmangie të financimit të dyfishte nepermjet masave tjera të politikës bujqesore dhe politikës për zhvillim rural dhe ndihmes shteterore në bujqesi;

b) informata specifike sipas llojeve të masave/aktiviteteve, vecanerisht investimeve të pranueshme për investim dhe kushte për pranueshmeri të masave dhe aktiviteteve të orientuara në:

- planifikimin e prodhimit,
- permiresimin dhe ruajtjen e kualitetit të produkteve,
- permiresimin e marketingut të produkteve,
- hulumtimin dhe prodhimin eksperimental,
- stervitjen dhe promovimin e qasjes në sherbimet keshilledhenese,
- ndalimin dhe menaxhimin me krizat dhe
- mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetesor dhe

v) shumat maksimale të mjeteve të cilat mund të shpenzohen në cfaredo mase individuale dhe/ose lloj aktiviteti dhe/ose shpenzimi, me qellim që të sigurohet balance perkatese ndermjet masave dhe aktiviteteve të ndryshme dhe

3) sisteme për ndjekje dhe vleresim, të bazuara mbi indikatorë të pergjithshem për realizimin, dhe atë:

a) vleresim të programeve operative dhe obligimeve për njoftim nga ana e organizatave të prodhuesve dhe

b) ndjekje dhe vleresim të strategjise nacionale.

(4) Organ kompetent për menaxhimin, ndjekjen dhe vleresimin e strategjise nga paragrafi (1) i ketij neni eshte Ministria.

Fondi operativ

Neni 131

(1) Organizatat e prodhuesve vendosin fond operativ, i cili financohet nga:

a) kontributet financiare të anetareve të organizates së prodhuesve në pajtim me statutin e organizates së prodhuesve nga neni 118 të ketij ligji dhe

b) mbeshtetja financiare e shtetit e cila u ndahet organizatave të prodhuesve në pajtim me nenin 132 të ketij ligji.

(2) Fondet operative perdoren vecanerisht për financimin e programeve operative të miratuara nga neni 136 i ketij ligji.

(3) Menaxhimin me fondet operative organizatat e prodhuesve obligohen që ta kryejne në menyre e cila u mundeson revizoreve të jashtem të pavarur, identifikim, kontrollim dhe konfirmim të shpenzimeve dhe të ardhurave vjetore.

Perkrahja financiare e organizatave të prodhuesve

Neni 132

(1) Për realizimin e aktiviteteve të veta organizatat e prodhuesve mund të shfrytezojne perkrahje financiare.

(2) Qeveria me propozimin e ministrit miraton program vjetor për perkrahje financiare të organizatave të prodhuesve.

(3) Programi nga paragrafi (2) i ketij neni permban mjete financiare për perkrahje të realizimit të programeve operative për pune të organizatave të prodhuesve.

(4) Lartesia e perkrahjes financiare nga paragrafi (1) i ketij neni për organizatat e prodhuesve eshte e kufizuar në 4,1% nga vlera e prodhimit të shitur të organizates së prodhuesve dhe shfrytëzohet për të mbuluar 50% të shpenzimeve të pranueshme të bera nga fondi operativ i organizates së prodhuesve për realizimin e programit operativ nga neni 134 të ketij ligji.

(5) Perkrahja financiare nga paragrafi (4) i ketij neni paguhet një here dhe atë më së voni deri më 15 tetor në vitin që vijon pas vitit të implementimit të programit operativ.

(6) Lartesia e perkrahjes financiare për grupe të prodhuesve dhe menyra e financimit të planeve për njohje realizohet në pajtim me nenin 75 të ketij ligji.

Qellimet dhe kushtet e programit operativ

Nenin 133

(1) Programi operativ permban së paku dy nga qellimet e paraqitura në nenin 113 të ketij ligji ose nga qellimet si vijojne:

- planifikimi i prodhimit,
- permiresimi i kualitetit të produktit,
- rritja e vleres tregtare të produkteve,
- promovimi i produkteve, qofte edhe nese jane në gjendje të fresket ose në gjendje të perpunuar,
- masat për mbrojtje të mjedisit jetesor dhe metodat për prodhim të cilat kontribuojne për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetesor, duke perfshire edhe prodhimin organik dhe
- parandalimi dhe menaxhimi me krizat.

(2) Programi operativ doemos duhet të plotesoje së paku një prej kushteve si vijojne:

- të perfshijne dy ose më shume aktivitete për mbrojtjen e mjedisit jetesore, të cilat jane të orientuara në nxitjen dhe perkrahjen e praktikave prodhuese për mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetesor dhe jane në pajtim me nenin 76 të ketij ligji ose
- së paku 10% nga shpenzimet e programit operativ t'i mbulojne aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit jetesor.

(3) Perkrahja e aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit jetesor nga paragrafi (2) i ketij neni eshte për kompensimin e shpenzimeve plotesuese dhe për të ardhurat e humbura të shkaktuara si rezultat i realizimit të aktiviteteve.

Permbajtja e programit operativ

Neni 134

(1) Programet operative nga neni 133 i ketij ligji permbajne së paku:

a) pershkrimin e gjendjes fillestare, në baze të indikatoreve themelore të parapare në strategjine nacionale për programe operative nga neni 130 i ketij ligji;

b) qellime të programit, duke pershire edhe:

- sqarimin e kontributit në, dhe harmonizimin me, strategjine nacionale nga neni 130 i ketij ligji,

- balancen e aktiviteteve në suazat e programit operativ dhe

- pershkrimin e qellimeve dhe matjen e tyre në pajtim me qellimet dhe indikatorët të perkufizuara në strategjine nacionale nga neni 130 i ketij ligji;

v) pershkrimin e hollesishem të masave, duke perfshire edhe mjete për realizimin e masave në çdo vit nga realizimi i programit. Pershkrimi duhet ta paraqese shkallen në të cilen masat e ndryshme të propozuara:

- plotesohen dhe jane në pajtim me masat tjera të cilat financohen ose jane të pranueshme për financim nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonise, vecanerisht me masat për perkrahjen e zhvillimit rural dhe

- nuk paraqesin rrezik për financimin e dyfishte nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë;

g) kornize kohore për realizimin e aktiviteteve të programit operativ dhe

d) aspekte financiare të programit operativ, vecanerisht:

- metoden e llogaritjes dhe nivelin e pjesëmartjes financiare,

- proceduren për financimin e fondit operativ dhe

- buxhetin dhe kornizen kohore për realizimin e aktiviteteve dhe masave për çdo vit nga realizimi i programit.

(2) Lende e perkrahjes financiare janë aktivitetet nga programet operative të parapara për financim në pajtim me strategjinë nacionale nga neni 130 i këtij ligji.

(3) Lende e perkrahjes financiare janë vetëm masat dhe aktivitetet e programit operativ të cilet janë të orientuara në produktet për të cilat organizata e prodhuesve është e regjistruar dhe ku mbi 50% e vlerës së produktit rrjedh nga anetaret e organizatës së prodhuesve.

Miratimi i programit operativ dhe perkrahjes financiare

Neni 135

(1) Kooperativa nga neni 114 i këtij ligji dhe organizatat e prodhuesve i parashtrojnë Ministrisë kerkese për miratimin dhe propozimin e programit operativ.

(2) Me kerkesen për miratimin dhe propozimin e programit operativ nga paragrafi (1) i këtij neni dorezohet edhe:

- deshmi për vendosjen e fondit operativ të organizatës së prodhuesve,

- vlerësim i shumës së fondit operativ për çdo vit,

- lartësia e shpenzimeve për vitin rrjedhës dhe paraprak,

- vlerësimi për vëllimin e prodhimit në vitin a ardhshëm dhe

- deklarata e kooperatives dhe organizatës nga paragrafi (1) i këtij neni se nuk ka pasur dhe nuk do të ketë financim tjetër nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, në lidhje me shpenzimet dhe aktivitetet të cilet janë të pranueshme për financim në pajtim me nenin 132 të këtij ligji.

(3) Kërkesa për miratim nga paragrafi (1) i këtij neni mund të parashtrohet njëkohësisht me parashtrimin e kerkeses për njohje të organizatës së prodhuesve nga neni 114 i këtij ligji.

(4) Kërkesa për miratimin dhe propozimin e programit nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrohet më së voni deri më 15 shtator në vitin i cili i paraprin vitit në të cilin ato do të zbatohen.

(5) Për vlerësimin e programit operativ të organizatës së prodhuesve, Komisioni nga neni 125 i këtij ligji:

- e kontrollon programin e dorezuar operativ të organizatës së prodhuesve dhe dokumentacionin shoqerues,

- verteton autenticitetin e të dhenave dhe informatave të caktuara në programin operativ dhe dokumentacionit shoqerues të organizatës së prodhuesve,

- verteton perputhjen e masave të parapara dhe aktiviteteve në programin operativ të organizatës së prodhuesve në lidhje me strategjinë nacionale për programe të qëndrueshme operative të organizatës së prodhuesve nga neni 130 i këtij ligji dhe

- verteton sigurinë me mjete financiare për realizimin e tij.

(6) Komisioni nga paragrafi (5) i këtij neni përgatit raport, vlerësim të programit operativ dhe mendim për miratimin, ndryshimin ose refuzimin e programit operativ të organizatës së prodhuesve.

(7) Në baze të procedurës nga paragrafi (5) i këtij neni dhe mendimit nga paragrafi (6) i këtij neni ministri me aktvendim:

- e miraton programin operativ të organizatës së prodhuesve,

- e kthen programin operativ për ndryshime dhe plotesime në afat prej 15 ditesh nga ana e parashtruesit dhe

- e refuzon programin operativ.

(8) Aktvendimi nga paragrafi (7), alinete 1 dhe 3 të këtij neni miratohet më së voni deri më 15 dhjetor në vitin në të cilin është parshtruar kërkesa për miratimin e programit operativ, ndërsa vendimi nga paragrafi (7), alineja 2 e këtij neni në afat prej 30 ditesh nga dita e parashtrimit të kërkesës për miratim.

Miratimi dhe pagesa e perkrahjes financiare për programin operativ

Neni 136

(1) Organizatat e prodhuesve nga neni 112 i këtij ligji parashtrojnë kërkesë për perkrahje financiare në Agjencinë e programit operativ të miratuar më së voni deri më 15 shkurt në vitin pas vitit për të cilin kërkohej perkrahja.

(2) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni dorezohet edhe:

- aktvendimi për t'u regjistruar në Regjister të organizatave të prodhuesve,
- aktvendimi për miratimin e programit operativ nga neni 135 i këtij ligji,
- të dhëna për perkrahjen e cila kërkohej,
- të dhëna për vlerësimin e prodhimit të realizuar,
- të dhëna për kontributet financiare nga anëtarët e organizatës së prodhuesve dhe nga vete organizata e prodhuesve në fondin operativ,
- të dhëna për shpenzimet e bera në lidhje me programin operativ dhe
- deklarate nga organizata e prodhuesve se nuk ka pranuar financim tjetër nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonise në lidhje me shpenzimet për aktivitetet të cilat janë të pranueshme për financim në pajtim me nenin 132 të këtij ligji.

(3) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni mund të përfshijë edhe shpenzime të cilat janë të programuara, por nuk janë të realizuara, nëse deshmohet se:

- aktivitetet perkatese nuk kanë mundur të realizohen më së voni deri më 31 dhjetor në vitin e zbatimit të programit operativ për shkaqe të cilat janë jashtë kontrollit të organizatës perkatese të prodhuesve,
- aktivitetet mund të realizohen më së voni deri 30 prill vitin e ardhshëm dhe
- janë rezervuar mjete perkatese për realizimin e këtyre aktiviteteve në fondin operativ të organizatës së prodhuesve.

(4) Atje ku kërkesat janë parashtruar pas datës së shënuar në paragrafin (1) të këtij neni, perkrahja zvogelohet për 1% për çdo ditë vonese.

(5) Agjencia e njofton organizatën e prodhuesve për shumën e vlerësuar të perkrahjes financiare në pajtim me nenin 132 të këtij ligji, më së voni deri më 15 maj në vitin pas vitit për të cilin kërkohej perkrahja.

(6) Agjencia e paguan perkrahjen financiare për organizatat e prodhuesve në baze të shpenzimeve të pranueshme të bera në mënyrë reale nga fondi operativ i organizatës së prodhuesve në pajtim me nenin 132 të këtij ligji, për realizimin e masave dhe aktiviteteve të programeve operative të organizatave të prodhuesve të miratuara në pajtim me nenin 135 të këtij ligji.

(7) Perkrahja financiare për shpenzimet nga paragrafi (3) i këtij neni paguhet vetëm nëse sigurohet deshmë se shpenzimi është realizuar më së voni deri më 30 prill në vitin pas vitit në të cilin shpenzimi programor ka qenë i programuar.

(8) Agjencia e paguan perkrahjen financiare të organizatës të prodhuesve më së voni deri më 15 tetor në vitin pas vitit të realizimit të programit operativ, i miratuar në pajtim me nenin 135 të këtij ligji.

Zvogelimi i pageses së perkrahjes financiare për programin operativ

Neni 137

(1) Nese gjate perpunimit të kerkeses për pagese Agjencia percakton se ndermjet shumes së kerkuar për më shume se 3% e tejkalon shumen e pranueshme, lartesia e perkrahjes e cila do t'i paguhet organizates së prodhuesve do të zvogelohet.

(2) Lartesia e perkrahjes nga paragrafi (1) i ketij neni llogaritet me refuzimin e shumes së pranueshme të dallimit nga shuma kerkuar dhe e pranueshme.

(3) Nese percaktohet se organizata e prodhuesve me qellim ka dhene deklarate të gabuar, aktiviteti perkates do të perjashtohet nga perkrahja e programit operativ, ndersa mjetet e paguara për aktivitetin e tille do të kthehen.

(4) Organizata e prodhuesve nga paragrafi (3) i ketij neni, do të perjashtohet nga fitimi i perkrahjes permes programit operativ për aktivitetin e tille edhe vitin e ardhshem.

Kthimi i perkrahjes financiare për programin operativ

Neni 138

(1) Organizata e prodhuesve obligohet që ta ktheje perkrahjen financiare të paguar sipas programit operativ rrjedhes me kamatevonese në rast kur organizata e prodhuesve shlyhet nga Regjistri i organizatave të prodhuesve në pajtim me nenin 121 të ketij ligji.

(2) Procedura për kthimin e mjeteve të paguara në menyre jo të rregullt behet në pajtim me dispozitat e Ligjit për themelimin e Agjencise për perkrahje financiare në bujqesi dhe në zhvillimin rural.

(3) Obligimi për pagesen e kamates së vonuar fillon nga momenti i dorezimit të aktvendimit për kthimin e perkrahjes financiare.

Raportet për zbatimin e programit operativ

Neni 139

(1) Organizatat e prodhuesve obligohen që t'i dorezojne Ministrise dhe Agjencise raport vjetor për zbatimin e programit operativ nga neni 136 i ketij ligji.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i ketij neni vecanerisht permбан:

- programin operativ i cili eshte zbatuar në vitin paraprak,
- ndryshime dhe plotesime të rendesishme të programit operativ dhe
- dallim ndermjet perkrahjes financiare të realizuar dhe perkrahjes financiare e cila kerkohet.

(3) Për çdo program operativ të zbatuar raporti vjetor duhet të tregoje:

- arritjet dhe rezultatet nga programi operativ të bazuara në indikatorë të percaktuar me strategjine nacionale nga neni 130 i ketij ligji dhe
- kontroll të problemeve kryesore të cilet paraqiten gjate menaxhimit të programit operativ dhe çdo mase të ndermarre për sigurine e kualitetit dhe efektivitetit në zbatimin e programit operativ.

(4) Në vitin e fundit nga zbatimi i programit operativ, organizata e prodhuesve në vend të raportit vjetor dorezon raportin perfundimtar për zbatimin e programit operativ.

(5) Raporti perfundimtar nga paragrafi (4) i ketij neni permбан të dhena për:

- shkallen e realizimit të qellimeve të percaktuara në programet operative dhe
- ndryshimet e aktiviteteve dhe/ose metodave, dhe faktoret të cilet kane kontribuar për suksesin ose deshtimin e zbatimit të programit operativ të cilat do të merren parasysh gjate pergatitjes së programeve vijuese, ose kur programet operative rrjedhese do të ndryshohen.

(6) Nese organizata e prodhuesve nuk vepron në pajtim me dispozitat nga paragrafet (1), (2), (3), (4) dhe (5) të ketij neni dhe nuk i dorezon raportet e kerkuara ose ato percaktohen si të papershtatshme, Agjencia nuk do ta beje pagesen e programit operativ për vitin e ardhshem.

Ndjekja dhe vleresimi i programeve operative

Neni 140

(1) Për ndjekjen dhe vleresimin e programeve operative nga neni 136 i këtij ligji nepermjet indikatorëve të strategjise nacionale nga neni 130 i këtij ligji, organizatat e prodhuesve vendosin sistem për grumbullimin, evidentimin dhe ruajtjen e informatave të nevojshme për ndjekjen e indikatorëve.

(2) Ndjekja është për vleresimin e progresit të bërë për realizimin e qëllimeve specifike të caktuara për programin operativ dhe zbatohet në baze të indikatorëve financiare, indikatorëve për realizim dhe indikatorëve të rezultateve.

(3) Rezultatet nga ndjekja e programit operativ shfrytezohen për:

- verifikimin e kualitetit të zbatimit të programit,
- identifikimin e nevojave për pershtatje ose ndryshime të programit operativ të orientuara në realizimin e qëllimeve të programit ose permiresimin e menaxhimit të programit, duke përfshirë edhe menaxhimin financiar dhe

- plotesimin e kërkesave për njoftim në lidhje me zbatimin e programit operativ.

(4) Informatat për rezultatet e aktiviteteve për ndjekje do të përfshihen në çdo raport vjetor nga neni 139 i këtij ligji.

(5) Vleresimi i programit operativ nga neni 136 i këtij ligji behet si raport i vecante afatmesem për vleresim, i orientuar në përcaktimin e shkallës së shfrytezimit të mjeteve financiare, efikasitetin dhe efektivitetin e programit operativ, si dhe vleresimin e progresit në lidhje me qëllimet e përgjithshme të programit.

(6) Vleresimi përgatitet nepermjet indikatorëve të përgjithshëm të cilët kanë të bëjnë me gjendjen themelore, rezultatet dhe ndikimin, dhe rezultatet nga i njëjti do të shfrytezohen për:

- permiresimin e kualitetit të programit operativ të menaxhuar nga ana e organizatës së prodhuesve,

- identifikimin e ndryshimeve të mundshme ose të rëndësishme të programeve operative,

- plotesimin e kërkesave për njoftim në lidhje me zbatimin e programit operativ dhe

- nxjerrjen e leksioneve të dobishme për permiresimin e kualitetit, efikasitetit dhe efektivitetit për programet e ardhshme operative të menaxhuara nga ana e organizatave të prodhuesve.

(7) Raporti afatmesem për vleresim do të zbatohet gjatë zbatimit të programit operativ, në kohë e cila lejon që rezultatet e tij të merren parasysh në përgatitjen e programeve operative vijuese.

(8) Raporti afatmesem për vleresim do të shtohet në raportin perkates vjetor nga neni 139, paragrafi (1) i këtij ligji.

Ndjekja dhe vleresimi i strategjise nacionale

Neni 141

(1) Për ndjekjen dhe vleresimin e strategjise nacionale nga neni 130 i këtij ligji, në pajtim me indikatorët e caktuar në të, Ministria vendos sistem për grumbullim, evidentim dhe ruajtje të informatave në formë të kompjuterizuar të nevojshme për ndjekje të indikatorëve.

(2) Sistemi për grumbullim, evidentim dhe ruajtje të informatave nga paragrafi (1) i këtij neni paraqet permiresim të informatave të dorezuara nga ana e organizatave të prodhuesve në lidhje me ndjekjen dhe vleresimin e programit operativ në pajtim me nenin 140 të këtij ligji.

(3) Ndjekja behet për vleresimin e progresit të bërë për realizimin e qëllimeve specifike të përcaktuara në strategjinë nacionale nga neni 130 i këtij ligji dhe zbatohet në baze të indikatorëve financiare, indikatorëve për realizim dhe indikatorëve për rezultatet me përdorim të informatave të siguruar në raportet vjetore të dorezuara nga ana e organizatave të prodhuesve në pajtim me nenin 139 dhe 140 të këtij ligji.

(4) Rezultatet nga ndjekja e strategjise nacionale shfrytezohen për:

- verifikimin e kualitetit të zbatimit të programit operativ,

- identifikimin e nevojave për pershtatje ose ndryshim të strategjise nacionale të orientuara në realizimin e qellimeve të strategjise ose permiresimin e menaxhimit me zbatimin e strategjise, duke perfshire edhe menaxhimin financiar të programeve operative dhe

- plotesimin e kerkeses për njoftim në lidhje me zbatimin e strategjise nacionale, në pajtim me nenin 130 të ketij ligji.

(5) Ministria pergatit raport vjetor për ndjekjen e strategjise nacionale nga neni 130 i ketij ligji dhe të njejtin e dorezon për miratim në Qeverine e Republikes së Maqedonise.

(6) Për percaktimin e progresit të bere për realizimin e qellimeve të pergjithshme nga Strategjia nacionale nga neni 130 i ketij ligji, zbatohet vleresimi i strategjise. Vleresimi behet në baze të informatave të siguruara nga vleresimi afatmesem i programeve operative, raporteve vjetore të progresit dhe raportit perfundimtar të dorezuar nga ana e organizatave të prodhuesve në pajtim me nenin 139 të ketij ligji.

(7) Rezultatet nga vleresimi i Strategjise nacionale shfrytezohen për:

- permiresimin e kualitetit të strategjise,
- identifikimin e cfaredo nevojave për ndryshime të konsiderueshme të strategjise dhe
- plotesimin e kerkesave për njoftim në lidhje me zbatimin e Strategjise nacionale, në pajtim me nenin 130 të ketij ligji.

(8) Vleresimi i Strategjise nacionale nga neni 130 i ketij ligji fillon në vitin e trete nga miratimi i saj, në kohen e cila lejon perfshirjen e rezultateve në një raport të vecante për vleresim i cili do të jete shtojce, në vitin e njejte, të raportit vjetor të shenuar në paragrafin (5) të ketij neni.

(9) Raporti nga paragrafi (8) i ketij neni, vecanerisht permban:

- shkallen e shfrytezimit të mjeteve buxhetore,
- efikasitetin dhe efektivitetin e programeve operative të zbatuara dhe efektet dhe ndikimin e programeve operative, në lidhje me qellimet dhe drejtimet e percaktuara në strategjine nacionale nga neni 130 i ketij ligji dhe, nese eshte perkatese, qellimet tjera nga neni 3 i ketij ligji dhe
- njohurite e dobishme për permiresimin e kualitetit për strategjite e ardhshme nacionale, vecanerisht në identifikimin e mangesive të mundshme në percaktimin e qellimeve, drejtimeve dhe masave të cilat jane të pranueshme për perkrahje, ose nevojave për percaktimin e instrumenteve të reja.

Organizatrat ndermjet degeve të prodhuesve

Neni 142

(1) Organizatat ndermjet degeve të prodhuesve jane forme më larte e shoqerise së organizatave me shoqerite tregtare dhe persona tjere juridike të cilet merren me perpunimin dhe/ose tregetine e produkteve bujqesore nga neni 112 i ketij ligji.

(2) Organizatat nga paragrafi (1) i ketij neni organizohen në pajtim me Ligjin për shoqeri tregtare ose Ligjin për kooperativa.

IX. KONTROLLI

Kontrolli i pagesave të drejtperdrejta

Neni 143

(1) Kontrolli administrativ dhe kontrolli në vendin e ngjarjes ushtrohet për shkak të percaktimit të harmonizimit të të dhenave nga kerkesa për pagesat e drejtperdrejta me kushtet e percaktuara për ndarjen e pagesave të drejtperdrejta, si dhe me kerkesat dhe standardet relevante për perputhshmeri të kryqezuar për ndarjen e pagesave të drejtperdrejta nga nenet 48 dhe 49 të ketij ligji.

(2) Nese shfrytezuesi refuzon ose pamundeson të kryhet kontrolli në vendin e punes, kerkesa për pagese të drejtperdrejte refuzohet.

Kontrolli administrativ

Neni 144

Kontrolli administrativ mund të kryhet me perdorimin e bazave të të dhënave, regjistrave dhe sistemeve të SIAK-ut për shkak të percaktimit të pranueshmerise së kerkeses dhe zbulimit të parregullsive me kontroll krahasues të të dhënave të deklaruara:

- për parcelat tokesore me parcelat referente nga Sistemi për identifikimin e parcelave tokesore për shkak të percaktimit të pranueshmerise për pagesa të drejtperdrejta për ato siperfaqe,
- për kafshet me të dhëna nga Regjistri për identifikim dhe regjistrim të kafsheve për shkak të percaktimit të pranueshmerise për pagesa të drejtperdrejta për ato kafshe,
- për sasi të produkteve me të dhënat e sasive të dorezuara të produkteve dhe/ose të dhënat për sasite e blera të produkteve të siguruar nga bleseri ose perpunuesi i produkteve bujqesore,
- për njohje të organizatave të prodhuesve ose grupe të prodhuesve me të dhënat nga Regjistri i organizatave të prodhuesve,
- për perdorimin ose prodhimin e materialit të certifikuar faror dhe mbjelles me të dhënat për furnizimin, grumbullimin dhe shitjen e materialit ose permbarimin e marreveshjes për bashkepunim tekniko-teknologjik me prodhuesin e autorizuar dhe
- dhe të dhëna të tjera nga dokumentacioni, marreveshjet, deklaratat me shkrim dhe deshmite tjera të deponuara, të percaktuara për prodhimin, dorezimin ose shitjen e produkteve bujqesore.

Kontrolli në vendin e ngjarjes

Neni 145

(1) Me kontroll në vendin e ngjarjes gjate vitit duhet të perfshihen së paku:

- 5% nga ekonomite bujqesore të cilet kane parashtruar kerkese për pagesa të drejtperdrejta për siperfaqe,
- 10% nga ekonomite bujqesore të cilet kane parashtruar kerkese për pagesa të drejtperdrejta për koke bagetie duke perfshire së paku 5% nga numri i pergjithshem i kokeve për të cilet eshte parashtruar kerkesa,
- 2% nga ekonomite bujqesore të cilet kane parashtruar kerkesa për pagesa të drejtperdrejta për njesi të produktit bujqesor me origjine shtazore dhe
- 5% nga ekonomia bujqesore të cilet kane parashtruar kerkese për pagesa të drejtperdrejta për njesi të prodhimit bujqesor me origjine bimore.

(2) Kontrolli në vendin e ngjarjes për pagesa të drejtperdrejta për koke bagetie të dorezuara në thertore behet për ekzemplar së paku prej 30% nga të gjitha thertoret të cilet zgjidhen në baze të analizes së rrezikut, me çka kontrollohet ekzemplar nga 5% e numrit të pergjithshem të kafsheve të therura në çdo thertore në periudhe prej 12 muajsh para kontrollit.

(3) Kontrolli në vendin e ngjarjes për pagesa të drejtperdrejta për njesi të produktit bujqesor në kapacitete grumbulluese dhe perpunuese perfshin kontroll së paku të 30% nga të gjitha subjektet të cilatet bejne grumbullimin dhe perpunimin e produkteve bujqesore të zgjedhura në baze të analizes së rrezikut.

(4) Kur me kontrollin në vendin e ngjarjes zbulohen parregullsi te një mase e caktuar e pagesave të drejtperdrejta, rajonit, ose pjese të rajonit, numri i kontrolleve në vendin e ngjarjes në vitin rrjedhes, si dhe perqindja e ekonomive bujqesore të cilat do të perfshihen gjate kontrolleve vitin e ardhshem rritet.

(5) Kontrolli në vendin e ngjarjes kryhet në baze të ekzemplarit reprezentativ të zgjedhur në baze të kriterëve nga neni 146 i ketij ligji.

(6) Nese gjate kontrollit të ekzemplarit zbulohen parregullsi, vellimi dhe perfshirja e ekzemplarit duhet të jete e zmadhuar në menyre perkatese.

(7) Kontrolli i pagesave të drejteperdrejta në vendin e ngjarjes për siperfaqe behet edhe me perdorimin e metodave të kontrollit nga larg nepermjet fotointerpretimit të fotografive satelitore ose ajrore në të gjitha parcelat tokesore nga kerkesa për pagesa të drejtperdrejta, e cila eshte lende e kontrollit me qellim të njohjes së perdorimit të tokes dhe matjes së siperfaqes.

Kryerja e kontrollit në vendin e ngjarjes

Neni 146

- (1) Kontrolli në vendin e ngjarjes kryhet pa njoftim paraprak.
- (2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, kontrolli mund të kryhet me njoftim paraprak në periudhe jo më gjatë se 48 orë para kryerjes së kontrollit, vetëm nëse me atë nuk vihet në pikëpyetje qëllimi i kontrollit.
- (3) Kontrolli në vendin e ngjarjes mund të kryhet së bashku me kontrollet tjera ose mbikeqyrjet inspektuese.

Zgjedhja e ekzemplarit për kontroll

Neni 147

- (1) Ekzemplari i ekonomive bujqesore të cilat do të jenë lende e kontrollit në vendin e ngjarjes zgjidhet në bazë të analizës së rrezikut, dhe përfaqësimit të kërkesave të paraqitura për pagesa të drejtperdrejta.
- (2) Me qëllim të sigurimit të përfaqësimit 20-25% të ekonomive bujqesore të cilat janë lende e kontrollit në vendin e ngjarjes zgjidhen në bazë të zgjedhjes së rastësishme.
- (3) Efikasiteti i analizës së rrezikut vlerësohet çdo vit duke kontrolluar rëndesinë e secilit prej faktorëve të rrezikut, si dhe me krahasimin e rezultateve të kontrolleve të bazuara në analizen e rrezikut me kontrollet e kryera në bazë të zgjedhjes së rastësishme.
- (4) Gjatë analizës së rrezikut vecanerisht merren parasysh faktorët si vijojnë:
 - lartësia e perkrahjes së kërkuar,
 - numri i parcelave të kadastrit dhe i sipërfaqes për të cilën është parashtruar kërkesa për pagesa të drejtperdrejta,
 - numri i kokeve të bagetisë,
 - ndryshimet në lidhje me vitin paraprak,
 - rezultati i kontrollit të percaktuar i ushtruar në vitin paraprak dhe
 - shfrytëzuesit të cilët kanë të drejtë të kufizuar të shfrytëzimit të kapaciteteve të paraqitura.

Procesverbali i kontrollit në vendin e ngjarjes

Neni 148

- (1) Pas çdo kontrolli në vendin e ngjarjes përpilohet procesverbal.
- (2) Bartersi i ekonomisë bujqesore e nënshkruan procesverbalin me të cilin konfirmon praninë e tij dhe i plotëson vërejtjet e tij nëse ka.
- (3) Nëse me kontrollin e kryer përcaktohen parregullsi, bartersit të ekonomisë bujqesore i jepet kopje e procesverbalit.
- (4) Formën, përmbajtjen dhe të dhënat të cilat i përmban procesverbali nga paragrafi (1) i këtij neni dhe të procesverbalit nga kontrolli në vendin e ngjarjes për përputhshmeri të kryqezuar i përcakton ministri.

Elemente të kontrollit të pagesave të drejteperdrejta në vendin e ngjarjes për sipërfaqe të tokës bujqesore

Neni 149

- (1) Kontrolli pagesave të drejteperdrejta në vendin e ngjarjes për sipërfaqe të tokës bujqesore përfshin së paku gjysmën e parcelave tokësore për të cilat ekonomia bujqesore kërkon pagesa të drejtperdrejta.
- (2) Ekzemplari nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të sigurojë nivel reprezentativ dhe real të kontrollit në lidhje me sipërfaqen e kontrolluar dhe perkrahjen e kërkuar.
- (3) Nëse me kontrollin nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen parregullsi, ekzemplari i parcelave tokësore të cilat duhet të kontrollohen rritet.

(4) Siperfaqja e parcelave tokesore percaktohet në menyre e cila duhet të siguroje kualitet të matjes që është e pershtatshme së paku me nivelin që kerkohet me standardin teknik të zbatueshem në Republikën e Maqedonise.

(5) Në rast kur menyra tradicionale e demarkacionit fizik të parcelave tokesore njihet si pjese e kushteve për praktike të mire bujqesore dhe mbrojtje të mjedisit, kjo siperfaqe e demarkacionit, në gjeresi maksimale deri në dy metra konsiderohet si pjese e tokes bujqesore të shfrytëzuar.

Elementet e kontrollit të pagesave të drejtperdrejta në vendin e ngjarjes për koke bagetie

Neni 150

(1) Kontrolli i pagesave të drejtperdrejta në vendin e ngjarjes për koke bagetie i perfshin të gjitha koket për të cilat është parashtruar kerkese për perkrahje dhe i njëjti kryhet në periudhen e ruajtjes së detyrueshme të kafsheve.

(2) Kontrolli i pagesave të drejtperdrejta në vendin e ngjarjes për koke bagetie perfshin kontrollet vijuese se:

- kafshet të cilet janë të pranishme në ekonomine bujqesore ruhen në periudhen e detyrueshme dhe i plotesojne kushtet në pajtim me kerkesen e parashtruar për pagesa të drejtperdrejta,

- perputhen të dhenat për numrin dhe llojin e kafsheve të ekonomise bujqesore për të cilat është parashtruar kerkese për numrin dhe llojin e kafsheve nga Sistemi për identifikimin dhe regjistrimin e kafsheve dhe

- perputhen të dhenat në Sistemin për identifikimin dhe regjistrimin e kafsheve në lidhje me dokumentet shoqeruese me të cilet percaktohet gjendja numerike e kafsheve, siç janë deshmite për blerjen dhe shitjen e kafsheve, certifikatat për therje, certifikatat veterinare dhe pasaportat e kafsheve me afat prej gjashte muajsh para kryerjes së kontrollit.

(3) Kontrolli në vendin e ngjarjes në thertore perfshin kontroll të dokumentacionit të thertores dhe krahasim të të dhenave nga sistemi për identifikimin dhe regjistrimin e kafsheve, si dhe kontroll të procedurave për therje dhe harmonizim të peshes trupore në momentin e kontrollit me kriteret për pagesa të drejtperdrejta.

(4) Kontrolli në vendin e ngjarjes në kapacitetet grumbulluese dhe perpunuese kryhet nepermjet kontrollit të rendesise së të dhenave për prodhimet grumbulluese bujqesore, të fituara nga grumbulluesit dhe objektet perpunuese me të dhenat e fituara nga ekonomite bujqesore në lidhje me sasine dhe cilesine e produkteve bujqesore.

Kontrolli i kerkesave dhe standardeve të rendesishme për perputhshmeri të kryqezuar

Neni 151

(1) Kontrolli i kerkesave dhe standardeve të rendesishme për perputhshmeri të kryqezuar për pagesa të drejtperdrejta kryhet nepermjet subjekteve të autorizuar në pajtim me ligjet nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetesor, shendetit të njerezve, kafsheve dhe bimeve dhe mireqenien e kafsheve.

(2) Kontrollin nga paragrafi (1) i ketij neni mund ta kryeje edhe organi kompetent për kontroll, nese i ploteson minimum kushtet e percaktuara për kryerjen e kontrollit të tille në ligjet nga paragrafi (1) i ketij neni.

(3) Kontrolli administrativ i kerkesave dhe standardeve të rendesishme për perputhshmeri të kryqezuar mund të kryhet nepermjet sistemeve të kontrollit të cilat tashme janë të vendosura në lidhje me kriteret, standardet dhe aktet për perputhshmeri të kryqezuar.

(4) Kontrollet në vendin e ngjarjes në lidhje me plotesimin e kerkesave dhe standardeve për perputhshmeri të kryqezuar kryhen së paku në 1% nga ekonomite bujqesore të cilet kane parashtruar kerkesa për pagesa të drejtperdrejta të perllogaritura në nivel të subjektit nga paragrafi (1) i ketij neni, ose në nivel të çdo akti, ose standardi, ose grup standardesh.

(5) Me perjashtim nga paragrafi (4) i ketij neni mund të zbatohet edhe shkalle më e larte, nese me dispoziten me të cilen është vendosur standardi është percaktuar shkalle e tille.

(6) Nese me kontrollin në vendin e ngjarjes zbulohet një nivel i larte i mosharmonizimit me rregulloret dhe standardet adekuate, numri i kontrolleve në vendin e ngjarjes për kontroll të plotesimit të kushteve ose standardeve rritet në periudhen vijuese të kontrollit.

(7) Ekzemplari i ekonomive bujqesore të cilat do të jene lende e kontrollit në vendin e ngjarjes zgjidhet në baze të analizes së rrezikut, ose analizes së rrezikut të kerkesave dhe standardeve në nivel individual të ekonomise bujqesore, llojeve të ekonomive bujqesore ose rajoneve gjeografike.

(8) Me qellim të sigurimit të perfaqesimit 20% - 25% të ekonomive bujqesore nga paragrafi (4) i ketij neni zgjidhen në baze të zgjedhjes së rastesishme.

(9) Ekzemplari për kontroll në vendin e ngjarjes për kontroll të kerkesave dhe standardeve të rendesishme për perputhshmeri të kryqezuar për pagesa të drejtperdrejta zgjidhet nga:

- ekonomite bujqesore të perzgjedhura me të cilat kane të bejne kerkesat dhe standardet për harmonizim të kryqezuar,

- popullata e pergjithshme e ekonomive të cilet kane paraqitur kerkesa për pagesa të drejtperdrejta dhe të cilat obligohen që t'i respektojne kerkesat ose standardet e rendesishme, në ç'rast për shkak të efikasitetit më të madh analiza e rrezikut mund të realizohet edhe në nivel të thertoreve, tregtareve ose bleresve dhe

- kombinimi i procedurave nga alinete 1 dhe 2 të ketij paragrafi, nese në atë menyre rritet efikasiteti i sistemit kontrollues.

(10) Kontrolli në vendin e ngjarjes kryhet mbi token e pergjithshme bujqesore të ekonomise bujqesore nepermjet ekzemplarit reprezentativ së paku nga gjysma e parcelave tokesore për të cilat kerkohet plotesimi i kerkesave dhe standardeve. Në rast të evidentimit të mosplotesimit të kerkesave dhe standardeve numri i parcelave të cilet jane subjekt të kontrollit rritet.

(11) Kontrolli në vendin e ngjarjes i ekonomise bujqesore mund të zevendesohet me kontrolle administrative ose kontrolle në vendin e ngjarjes të thertoreve, tregtareve ose bleresive të cilet jane pjese e sistemeve të certifikimit të kerkesave ose standardeve të rendesishme, nese me siguri mund të percaktohen faktet të cilet percaktohen me kontroll në vendin e ngjarjes.

(12) Kontrollet në vendin e ngjarjes duhet të kryhen në vitin e njejte kalendarik kur jane parashtruar kerkesat për pagesa të drejtperdrejta.

(13) Në rast të mosharmonizimit me kerkesat dhe standardet, Agjencia e informon ekonomine bujqesore në afat prej tre muajsh nga kontrolli në vendin e ngjarjes, me qellim të ndermarrjes së aktiviteteve për tejkalimin e tyre.

Kontrollet e kerkesave për perkrahje financiare për organizata të prodhuesve

Neni 152

(1) Me kontrolle të kerkesave për perkrahje financiare të organizatave të prodhuesve nenkuptohet kontroll administrativ dhe kontroll në vendin e ngjarjes.

(2) Kontrollet nga paragrafi (1) i ketij neni kryhen për shkak të percaktimit të harmonizimit të dhenave nga kerkesa me kushtet nga neni 136 i ketij ligji për dhenie të perkrahjes financiare për organizata të prodhuesve.

(3) Kerkesa për ndihme do të refuzohet nese organizata e prodhuesve, anetari i saj ose perfaqesuesi perkates pengon kryerjen e kontrollit në vendin e ngjarjes.

Kontrollet administrative të kerkesave për perkrahje financiare për organizata të prodhuesve

Neni 153

(1) Kontrolle administrative kryhen mbi gjitha kerkesat për perkrahje dhe pagese të mjeteve financiare dhe i perfshijne të gjitha elementet e mundshme dhe perkatese të cilat mund të kontrollohen me mjete administrative.

(2) Aktivitetet e ndermarra, rezultatet dhe masat e ndermarra në lidhje me shmangiet gjate kryerjes së kontrollit administrativ nga paragrafi (1) i ketij neni do të jene të evidentuara dhe të dokumentuara në menyre perkatese.

Kontrollet në vendin e ngjarjes ikerkesave për perkrahe financiare për organizata të prodhuesve

Neni 154

(1) Pas çdo kontrolli në vendin ngjarjes perpilohet procesverbal i cili vecanerisht permban të dhena për:

- ndihmen dhe kerkesen e kontrolluar,
- personat të cilet kane qene të pranishem,
- aktivitetet, masat dhe dokumentet e kontrolluara dhe
- rezultatet nga kontrolli.

(2) Personi pergjegjes i organizatave të prodhuesve e nenshkruan procesverbalin me çka e verteton pranine e tij dhe i ploteson verejtjet e tij nese ka.

(3) Nese me kontrollin e kryer percaktohen parregullsi, organizates së prodhuesve i jepet kopje nga procesverbali.

(4) Për qellimin e kryrjes së kontrollit në vendin e ngjarjes mund të njoftohet paraprakisht organizata e prodhuesve, me kusht që të mos rrezikohet qellimi i kontrollit. Njoftimi paraprak do të kufizohet në periudhe jo më gjate se 48 orë para kryerjes së kontrollit.

(5) Kontrollet në vendin e ngjarjes të ketij neni dhe kontrollet tjera në vendin e ngjarjes të paraqitura në kete ligj mund të kryhen njekohesisht.

(6) Formularin e procesverbalit nga paragrafi (1) i ketij neni e percakton ministri.

Kontrollet për fitimin e statusit të organizatave të prodhuesve dhe miratimin e programeve operative

Neni 155

(1) Para fitimit të statusit të organizates së prodhuesve në pajtim me nenin 119 të ketij ligji, Ministria kryen kontroll administrativ në vendin e ngjarjes që të percaktohet plotesimi i kushteve për njohje nga neni 114 i ketij ligji.

(2) Para miratimit të programit operativ në pajtim me nenin 135 të ketij ligji, Ministria kryen kontroll administrativ në vendin e ngjarjes të organizates së prodhuesve në menyre që të percaktohet:

- saktesia e të dhenave të siguruara në pajtim me nenin 134 të ketij ligji,
- harmonizimi me qellimet dhe programet nga nenet 3 dhe 7 të ketij ligji dhe me strategjine nacionale nga neni 130 i ketij ligji,
- pranueshmeria e aktiviteteve dhe shpenzimeve të propozuara,
- konsistenca dhe kualiteti teknik i programeve, perputhja e vleresimeve për ndihme financiare dhe
- harmonizimi i aktiviteteve nga programi operativ vecanerisht me ligjet nga fusha e furnizimeve publike, ndihma shtetore dhe standardet tjera perkatese me aktivitetet për të cilat kerkohet ndihme financiare.

Kontrollet e kerkesave për perkrahe financiare për programe operative

Neni 156

(1) Kontrollet e kerkesave për perkrahe financiare për programe operative kryhet nepermjet kontrolleve administrative të kerkesave për ndihme dhe kontrolleve në vendin e ngjarjes të organizatave të prodhuesve vecanerisht lidhur me:

- harmonizimin me kushtet për njohje për vitin perkates dhe

- perdorimin e fondeve operative në vitin perkates, duke perfshire edhe shpenzimet e deklaruar.

(2) Kontrolllet administrative të kerkesave për ndihme vecanerisht perfshijne verifikim të:

- raportit vjetor ose, atje ku eshte e mundshme, raportit perfundimtar të dorezuar bashke me kerkesen për ndihme financiare për programin operativ;

- vleres së prodhimit të realizuar, kontributeve në fondin operativ dhe shpenzimeve të bera,

- dorezimit të produkteve dhe sherbimeve dhe autenticitetit të shpenzimeve të kerkuara,

- harmonizimit të aktiviteteve të realizuara me ato të miratuara në kuader të programit operativ dhe

- respektimit të kufizimeve perkatese financiare ose tjera.

(3) Pagesat e financuara nga programi operativ jane të dokumentuara me fatura dhe dokumente tjera në emer të organizates së prodhuesve, të cilet vertetojne se pagesa eshte kryer.

(4) Për nevojat e verifikimit të kerkeses për perkrahje financiare nga neni 136 i ketij ligji, Agjencia kryen kontrole në vendin e ngjarjes të organizatave të prodhuesve me qellim që ta percaktoje harmonizimin me kushtet për miratimin e kerkesave ose për pjesen e mbetur të saj për vitin perkates.

(5) Kontrolllet nga paragrafi (1) i ketij neni ushtrohen mbi ekzemplar in reprezentativ të kerkesave çdo vit. Ekzemplari reprezentativ perfshin së paku 30% nga shuma e pergjithshme, duke mbajtur konsiderate që çdo organizate e prodhuesve të vizitohet së paku një here në periudhe brenda tre vitesh dhe të kryhet së paku një kontroll në çdo organizate të prodhuesve para pageses së ndihmes për vitin e fundit të programit operativ të organizates.

(6) Nese me kontrollet nga paragrafi (1) i ketij neni percaktohen parregullsi kryhen kontrole plotesuese gjate vitit të njejte dhe rritet perqindja e kerkesave të cilat do të kontrollohen vitin e ardhshem.

(7) Agjencia i zgjedh organizatat e prodhuesve të cilet do të kontrollohen në baze të analizes së rrezikut, e cila vecanerisht merr parasysh:

- shumen e ndihmes,

- rezultatet e kontroleve në vitet paraprake,

- zgjedhjet e rastesishme dhe

- parametrat tjera.

Kontrollet në vendin e punes për masa dhe aktivite të programeve operative

Neni 157

(1) Agjencia, nepermjet kontrollit në vendin e ngjarjes të masave dhe aktiviteteve të programeve operative, percakton vecanerisht:

- zbatimin e masave dhe aktiviteteve të perfshira në programin operativ,

- se zbatimi ose qellimi për zbatimin e aktivitetit eshte në pajtim me pershkrimin e miratuar në programin operativ,

- se shpenzimi i bere mund të mbeshtetet me dokumente të kontabilitetit ose dokumente tjera dhe i njejt pershtatet me specifikat e miratuara dhe

- vleren e prodhimit të realizuar.

(2) Vlera e prodhimit të realizuar percaktohet në baze të të dhenave të sistemit të kontabilitetit i cili eshte i i detyrueshem në pajtim me ligjin.

(3) Përvec rasteve të vecanta, kontrolli në vendin e ngjarjes perfshin edhe vizite të aktivitetit ose, nese aktiviteti eshte i karakterit jomaterial, vizite të kryeresit të aktivitetit.

(4) Kontrolli në vendin e punes nga paragrafi (1) i ketij neni i perfshin të gjitha percaktimet dhe obligimet e organizates së prodhuesve ose anetaret e tyre të cilet mund të kontrollohen gjate kohes së vizites.

(5) Vetem kontrollet të cilat i plotesojne të gjitha kerkesat nga ky nen mund të merren parasysh në plotesimin e shkalles së kontroleve të paraqitur në nenin 156, paragrafi (6) i ketij ligji.

Kontrollet para miratimit të planit për njohje të grupeve të prodhuesve

Neni 158

Para miratimit të planit për njohje të grupeve të prodhuesve, në pajtim me nenin 125 të këtij ligji, Ministria kryen kontroll në vendin e ngjarjes në kooperative nga neni 122, paragrafi (2), alineja 1 e këtij ligji në menyre që të percaktohet:

- saktësia e informatave të paraqitura në planin për njohje,
- konsistenca dhe kualiteti teknik, perputhja e vleresimeve dhe plani për zbatimin e tij,
- pranueshmëria e aktiviteteve dhe shpenzimet e propozuara dhe
- harmonizimi i aktiviteteve të planit vecanerisht nga fusha e furnizimeve publike, ndihma shtetërore dhe standardet tjera adekuate me aktivitetet tjera për të cilët kërkohej ndihme financiare.

Kontrollet e kërkesave për perkrahje financiare të grupeve të prodhuesve

Neni 159

(1) Para miratimit të pageses, Agjencia kryen kontrole administrative të të gjitha kërkesave për ndihme të grupeve të prodhuesve dhe kontrole në vendin e ngjarjes.

(2) Para realizimit të perkrahjes së grupit të prodhuesve, Agjencia do të kryejë kontroll në vendin e ngjarjes të grupeve të prodhuesve në menyre që të percaktohet harmonizimi me kushtet nga neni 75 i këtij ligji për miratimin dhe pagesen e perkrahjes.

(3) Kontrolli nga paragrafi (2) i këtij neni vecanerisht do të kete të beje me:

- harmonizimin me kriteret për njohje për vitin perkates dhe
- vleren e prodhimit të realizuar si dhe zbatimin e masave të perfshira në planin për njohje dhe shpenzimet e bera.

(4) Kontrollet nga paragrafi (2) i këtij neni kryhen në ekzemplar reprezentativ të kërkesave çdo vit i cili paraqet së paku 30% të shumës së pergjithshme të ndihmes, duke pasur parasysh që të gjitha grupet e prodhuesve të jene subjekt i kontrollit së paku një here në çdo pese vjet.

X. MBIKEQYRJA

Mbikeqyrja e ligjshmerise dhe mbikeqyrja inspektuese

Neni 160

(1) Mbikeqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në baze të tij, e kryen Ministria.

(2) Mbikeqyrjen inspektuese e kryen Inspektorati Shtetëror për Bujqesi nepermjet inspektoreve shtetërore për bujqesi (në tekstin e metejme: Inspektoret).

(3) Subjektet obligohen që t'u mundesoje inspektoreve kryerjen pa pengese të mbikeqyrjes inspektuese.

Autorizimet e Inspektorit Shtetëror për Bujqesi

Neni 161

Inspektori shtetëror për bujqesi, krahas autorizimeve të cilat i ka në baze të Ligjit për inspektoratin shtetëror për bujqesi, ka edhe autorizimet dhe kompetencat si vijojne:

- kontrollon hapësira afariste dhe prodhuese, objekte, instalime, sende, produkte, dokumentacion të organeve shtetërore, si dhe personat fizike dhe juridike të cilët kryejne veprimtari bujqesore, veprimtari plotesuese të pronave bujqesore ose veprimtari tjera, nese behet fjale për zbatimin e masave nga politika bujqesore,
- kontrollon ndertesa banesore dhe hapësira ndihmese në të cilët kryhet veprimtari bujqesore ose plotesuese perkatesisht veprimtari tjera, nese behet fjale për zbatimin e masave të politikës bujqesore,

- konstaton fitim joligjor perkatesisht shfrytezim të mjeteve të padestinuara sipas ketij ligji,
- kryen mbikeqyrjen e zbatimit të marreveshjeve për grumbullimin e prodhimeve bujqesore;
- kryen mbikeqyrjen e zbatimit të grumbullimit të prodhimeve bujqesore,
- i kontrollon bazat e të dhenave të cilet jane të nevojshme për kryerjen e mbikeqyrjes dhe
- kryen mbikeqyrjen e plotesimit të kushteve për kryerjen e veprimtarise plotesuese të ekonomise bujqesore familjare.

Masat e Inspektorit Shteteror për bujqesi

Neni 162

Inspektori Shteteror për bujqesi gjate kryerjes së mbikeqyrjes inspektuese, pervec masave të percaktuara në pajtim me Ligjin për inspektoratin shteteror për bujqesi mund t'i ndermarre edhe masat si vijojne:

- pjeserisht ose plotesisht të ndaloje të drejten perkatesisht zbatimin e masave sipas ketij ligji, nese konstaton shkelje të rregullave,
- percakton që masat për parregullsitate dhe mangesite sipas ketij ligji dhe rregullave të nxjerra në baze të tij, të terhiqen në afat të cilin e ka caktuar,
- heq dokumentacionin perkatesisht lende për percaktimin e gjendjes së vertete në lidhje me dyshimin e konstatuar për kundervajtjen e bere,
- percakton masa tjera dhe kryen pune për të cilat eshte i autorizuar me ligj, rregullore ose akt tjetër,
- perckaton masa, që parregullsitate dhe paplotesite sipas ketij ligji dhe rregullave të nxjerra në baze të tij, të hiqen në afat të cilin e ka caktuar dhe
- mund të ndaloje kryerjen e veprimtarise plotesuese dhe të kerkoje heqje të lejes dhe shlyerjen e asaj veprimtarie nga evidenca për veprimtari plotesuese deri në aktvendimin e organit kompetent.

XI. PROCEDURA PËR KUNDERVAJTJE, PROCEDURA PËR BARAZIM DHE NDERMJETESIM

Procedura për kundervajtje

Neni 163

(1) Proceduren për kundervajtje për kundervajtjet e parapara me kete Ligj e udheheq komisioni për kundervajtje i formuar në pajtim me Ligjin për Inspektoratin Shteteror të Bujqesise.

(2) Para parashtrimit të kerkeses për procedure për kunderajtje për kundervajtje të parapara me kete ligj, personi i autorizuar zyrtar për kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese në pajtim me kete ligj, mban procedure për barazim në pajtim me Ligjin për Inspektoratin Shteteror të Bujqesise.

Dispozitat për kundervajtje

Neni 164

(1) Gjobe me shume prej 3 000 deri 5 000 euro me kundervlere në denare, do t'i shqiptohet për kundervajtje personit juridik, nese:

- nuk e paraqet ndryshimin në pajtim me nenin 15, paragrafin (6) të ketij ligji,
- nuk i dorezon të dhenat në pajtim me nenin 60, paragrafin (1) të ketij ligji,
- nuk e paraqet ndryshimin në pajtim me nenin 120, paragrafin (3) i ketij ligji,
- nuk dorezon raport për realizimin e planit të pranimit në pajtim me nenin 127, paragrafet (2) dhe (3) të ketij ligji,
- nuk e ruan dokumentacionin dhe materialin deshmues për punen në pajtim me nenin 129 të ketij ligji,

- i shfrytezon mjetet nga fondi operativ në kundërshtim me nenin 131, paragrafi (2) i këtij ligji,

- menaxhon me fondin operativ në mënyrë që nuk u mundëson revizoreve të jashtëm të pavarur, identifikim, kontrollim dhe konfirmim të shpenzimeve dhe të ardhurave vjetore (neni 131, paragrafi (3)) dhe

- nuk dorëzon raport vjetor për zbatimin e programit operativ (neni 139).

(2) Gjohet prej 1 500 deri 2 000 euro me kundërvlerë në denare do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personi juridik, për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç gjobes së personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë së vecante në afat prej gjashtë muajsh deri në një vit.

Neni 165

(1) Gjohet me shumë prej 5 000 deri 8 000 eurosh me kundërvlerë në denare, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- bën grumbullimin e produkteve bujqësore duke mos qenë i regjistruar në Regjistrin e grumbulluesve (neni 31, paragrafi (2)),

- bën grumbullimin në vendin grumbullues në kundërshtim me nenin 31, paragrafet (3) dhe (4) të këtij ligji,

- bën grumbullimin e produkteve bujqësore në kundërshtim me nenin 31, paragrafet (5) dhe (6) të këtij ligji,

- nuk i dorëzohen të dhënat në pajtim me nenin 31, paragrafi (8) të këtij ligji,

- nuk bën pagesë të produkteve të grumbulluara bujqësore në pajtim me nenin 32, paragrafet (4) dhe (5) të këtij ligji,

- nuk e dorëzon marrëveshjen për grumbullim në Ministri (neni 32, paragrafi (6)),

- bën ndryshimin e marrëveshjes për grumbullimin e produkteve bujqësore në kundërshtim me nenin 32, paragrafin (7) i këtij ligji,

- lidh marrëveshje për grumbullimin e produkteve bujqësore në kundërshtim me nenin 32, paragrafin (8) i këtij ligji,

- nuk e paraqet ndryshimin në pajtim me nenin 34, paragrafin (3) i këtij ligji dhe

- importon produkte bujqësore duke mos qenë i regjistruar në Regjistrin e importuesve të produkteve të vecanta bujqësore (neni 36, paragrafi (1)).

(2) Gjohet prej 2 000 deri 4 000 euro me kundërvlerë në denare do t'i shqiptohet personit përgjegjës të personi juridik, për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç gjobes së personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë së vecante në afat prej gjashtë muajsh deri në një vit.

Neni 166

Gjohet prej 1 000 euro deri në 1 500 euro me kundërvlerë në denare do t'i shqiptohet edhe personit fizik për kundërvajtje të kryer, nëse:

- nuk e paraqet ndryshimin në pajtim me nenin 15, paragrafin (6) të këtij ligji dhe

- bën grumbullimin e produkteve bujqësore (neni 31, paragrafi (2)).

XII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

Dispozita më të përafërta

Neni 167

(1) Dispozitat më të përafërta në këto ligje do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni, do të zbatohen dispozitat ekzistuese.

Formimi i Keshillit të Bujqesise dhe Zhvillimit Rural

Neni 168

Keshilli i Bujqesise dhe Zhvillimit Rural do të formohet më së voni në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Procedurat e filluara

Neni 169

Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë në pajtim me Ligjin për bujqesi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 134/2007).

Pushimi i vlefshmerise

Neni 170

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për bujqesi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 134/2007).

Hyrja në fuqi

Neni 171

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten zyrtare të Republikës së Maqedonisë".